

## PËRMBAJTJA



**3** Milazim Krasniqi:  
DEBAKLI I NOJDEKUT



**6** Intervistë me  
Agron Mustafën



**25** Muhamed Jusufi-Kajolli:  
Ai ishte aty ku nevojitej



**29** Ramadan Zaplluzha  
Mysafiri i Paqes



**36** "Gomorra" rrëmben  
çmimet kryesore

Lajme .....	2
Milazim Krasniqi: DEBAKLI I NOJDEKUT	3
Sead Ujkani: Doganat në gjashtëpikëshin e Ban Ki Moon-it	4
Intervistë me Agron Mustafën	6, 7, 8
Gëzim Qerimi: Universiteti i Prishtinës me hapa të guximshëm drejt Procesit të Bolonjës	9
Emine A. Vezaj: Aty ku punohet, nuk mungon suksesi!	10, 11
Ditëlind Reshiti: Fondacioni "Atmosfera" hapi zyrën në Prishtinë	11
Avni Avdiu: Çka po ndodh në BFIM?!	12-13
Ferid Selimi: Shteti nuk është kombi	14-15
Dafina Buçinca: Gjithnjë kam pasur identitet	15
Sabri Halili: "Sëmundja kancerogjene" zgjeron metastazat	16, 17
Abdurrahim Maxhuni: Për një qasje më ndryshe ndaj sistemit arsimor	17
Fatos Shala: Zgjohet e bie me shpresën për një ditë më të mirë	18
Hekuran Avdyli: Serbët më të privilegjuarit	19
Demir Reshiti: Asnjë njohje në muajin nëntor	20-21
Muhamed Jusufi-Kajolli: Ebu Bekri Kalif	22, 23
Ne dhe Ju le të puqemi në dashurinë për zotin	24, 25
Muhamed Jusufi-Kajolli: Ai ishte aty ku nevojitej	25, 26, 27
Mirsad Kuteli: Martesa obligim jetësor	28
D. Reshiti: Njeriu që iu përkushtua karikaturës mbi gjysmë shekulli	29
Feti Mehdiu: Pse kufizohen studimet Master në UP?	30
Mimoza Sinani: Esenca e artit Islam (2)	31, 32
Vitrina e Librit,	32
Flamur Maloku: Neutraliteti i poezisë	33
Naile Demiri: Vetë elita prodhon mall të lirë për shitje	34
Poezi	35
Genta Hoxha: "Gomorra" rrëmben çmimet kryesore	36
Mexhid Yveysi: Prejardhja e alfabetit latin	37?
Artan Bejta: HIV/AIDS epidemia që po trondit botën	38-39
Fjalëkryqi	40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,  
KULTURË, ARSIM, ETIKË  
Viti III / Nr. 25  
19 dhjetor 2008 -  
19 janar 2009  
Botues  
**Zëri Ynë**  
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor  
**Muhamed Jusufi - KAJOLLI**  
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës  
**Demir RESHITI**  
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës  
**Flamur MALOKU**  
flamurmalko@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika  
**Osman D. GASHI**  
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore  
**Mimoza SINANI**

e-mail:  
revistapaqja@gmail.com  
revistapaqja@hotmail.com  
http://www.zeri-yne.org

Adresa:  
**Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,**  
**përballë teatrit Dodona,**  
**Prishtinë, Kosovë**

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

## Prishtinë

9 dhjetor 2008

### Nis punën EULEX-i

Misioni Evropian për Drejtësi dhe Polici, EULEX, ka filluar shtrirjen e tij në gjithë territorin e Kosovës më 9 dhjetor.

Autoritetet në Prishtinë e kanë përshëndetur vendosjen e EULEX-it dhe kanë kërkuar zbatimin e mandatit të tij në përputhje me planin Ahtisaari.

Misioni i EULEX-it, që po zëvendëson atë të OKB-së, pas nëntë vitesh administrimi, u vendos në Kosovë pas disa muaj shtyrjesh.

Ai u mundësua me miratimin e një Deklarate Presidenciale të KS të OKB-së, i cili miratoi një raport të sekretarit të përgjithshëm Ban Ki Moon. Në të, përfshihet edhe një marrëveshje gjashtëpikëshe me Beogradin, që u ofron serbëve të Kosovës, në veçanti veriut të saj, autonomi të gjerë në fushën e drejtësisë, policisë e doganave.

Marrëveshja u kundërshtua nga autoritetet në Prishtinë që paraqitën një përgjigje katërpikëshe, e cila u përfshi në raportin e kreut të OKB-së.

Misioni i EULEX-it, thotë se do ta përqendrojë punën e tij në fushën e drejtësisë, policisë e doganave dhe do të ketë rolin e këshillëdhënësit dhe mbikëqyrësit të institucioneve në këto fusha dhe se do të jetë i pranishëm në gjithë Kosovën. Ai do të numërojë 1900 pjesëtarë, kryesisht policë, prokurorë e gjykatës.



## Prishtinë

9 dhjetor 2008

### UNDP-ja i percepton gjykatat si më të korruptuarat në Kosovë

Prishtinë - Në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit, një raport i UNDP-së me perceptimet e qytetarëve thekson se gjykatat, KEK-u, Prokuroria, Agjencia Kosovare e Privatizimit, spitalet dhe qeveria janë më të infektuarat me korrupsion, ndërsa sipas raporteve të disa institucioneve e organizatave ndërkombëtare, korrupsioni rrezikon të shndërrohet në një pengesë të madhe të zhvillimit të vendit.

Qeveria e Kosovës ka theksuar disa herë tolerancën zero ndaj korrupsionit, por ajo ftohet të ndër marrë hapa konkretë në luftë kundër kësaj dukurie negative. Ndërkaq 70 deri në 90 për qind e të anketuarve të UNDP-së theksojnë se niveli i korrupsionit i institucioneve të lartcekura është më i madh se ai mesatar.

Raporti i perceptimit të korrupsionit në Kosovë i UNDP-së është i përgatitur nga Instituti "Rinvest" me 1.297 të anketuar.



## Prishtinë

10 dhjetor 2008

### Sheremet Ahmeti emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Policisë

Me datë 10.12.2008, në mbështetje të nenit 94.6 dhe 128.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 37 të Ligjit për Policinë dhe në përputhje me rekomandimin e Ministrit të Punëve të Brendshme për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës, Kryeministri i Republikës së Kosovës mori vendim që Sheremet Ahmeti të emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë emërohet për një periudhë 3 vjeçare.

Sheremet Ahmeti është i lindur më 1953, në fshatin Radishevë të komunës së Skenderajt. Shkollën e mesme të policisë e ka kryer në Kamenicë të Sremit (Vojvodinë), shkollën e lartë për punë të brendshme në Beograd, ndërsa fakultetin e Sigurimit në Shkup. Në vitin 2000 është emëruar Këshilltar i Komisionarit të Policisë për çështjet që kanë të bëjnë me SHPK-së. Në këtë pozitë ka vazhduar së punuari me 4 Komisionarë të Policisë.



# Debakli i Nojdekut

Edhe pse ky është debakël moral i vetë Rupert Nojdekut, i shkaktuar nga infektimi i tij (shpresojmë kalimtar) nga ideologjia kronike antishqiptare e Der Shpigelit, ai diçka na mëson. Na mëson se shteti/atdheu dhe kauza e tij, është më i vlefshëm se sa miqtë



Milazim KRASNIQI

**R**eagimi i Rupert Nojdeku ndaj qeverisë së Kosovës, lidhur me arrestimin e tre pjesëtarëve të shërbimit sekret gjerman në Prishtinë, e vë seriozisht në sprovë dashamirësinë e tij të mëhershme ndaj Kosovës. Pohimi se arrestimi është bërë “pa pasur asnjë argument, duke vepruar ashtu me egërsi”, e ka tonin tipik të patronit nervoz dhe arrogant. Nojdeku pozicionohet si autoriteti që e di krejt të vërtetën. Merr përsipër rolin e gjykatësit, duke u dhënë pafajësinë bashkëkombësve të vet dhe rolin e prokurorit ndaj qeverisë së Kosovës, duke e fyer dhe akuzuar me fjalët më të rënda.

Pozicionimi kaq agresiv i Rupert Nojdekut, megjithatë, mund të na shërbejë për të mirë. Pasioni me të cilin ai e mbron interesin gjerman, madje edhe të palarat e mundshme gjermane, duhet të na mësojë se nuk pështyhet mbi fytyrën e shtetit, as kur mbi të rëndon ndonjë gabim. Nojdeku ka dëshmuar se është atdhetar i flaktë gjerman, deri në masën sa rrezikon të këmbëjë “miqësinë e dëshmuar” me urrejtje të hapët, kur i preket teli i atdhetarizmit. Miqësinë për Kosovën, kësaj here e ka përmendur sa për sy e faqe, por esencialisht e ka sakrifikuar për interesin e shtetit të vet. Por, ky atdhetarizëm i flakët gjerman, vërtet e ka vënë në një pozitë të sikletshme morale: mbrojtja me aq pasion e tre pjesëtarëve të shërbimit sekret, për secilin që mban epitelin e humanistit, vetvetiu është problem. Ku e di humanisti se çka bëjnë pjesëtarët e shërbimit sekret, kur veprojnë ilegalisht në një vend të huaj? Edhe po të jetë vetë anëtar i atij shërbimi, nuk ka si ta dijë se çfarë bëjnë kolegët e tij. Në fund të

fundit, natyra e punëve të shërbimeve sekrete dhe e pjesëtarëve të tyre është shumë e komplikuar, për ta kuptuar një “humanist i njohur gjerman”. Bile edhe po të ishte shefi i tyre nominal, ai mund të mos e dinte se çfarë bëjnë pjesëtarët e BDN- së në Kosovë. Merreni me mend: presidenti amerikan, Xhorxh Bushi, tash në fund të mandatit të vet e ka pranuar se shërbimet sekrete amerikane e kanë vënë në lajthitje lidhur me Irakun. Pra, edhe pse ka qenë epror i tyre, ata e kanë vënë në lajthitje vetë presidentin amerikan.

Edhe në rastin e shërbimit gjerman, ekziston mundësia të ketë pasur ndonjë segment të politikës ose të biznesit, i cili ka qenë i interesuar për aktivitetet problematike të tyre pjesëtarëve të BND-së në Kosovë. Fjala vjen, ish kancelari gjerman, Gerhard Shreder, është shprehur haptas si kundërshtar i pavarësisë së Kosovës. Në shtator të këtij viti, pas agresionit rus kundër Gjeorgjisë, Shrederi ka deklaruar për Putinin se është “një demokrat i pastër si kristali”. E pra, partia e Shrederit, i cili vetë është hiç më pak se president i Këshillit Mbikëqyrës të gazsjellësit gjermano-rus në Baltik, është pjesë e koalicionit qeveritar në qeverinë federale gjermane. Pse të mos mendohet që aktivitetet e pjesëtarëve të arrestuar në Kosovë, kanë qenë nën urdhrat e Shrederit, ose të ithtarëve të politikave të tij pro-ruse? Po të lejoheshin hetimet e pavarura dhe një gjykim i pavarur, do të mund të vërtetohej ose pafajësia ose implikimi i tyre. Në të dyja rastet do të ishte më mirë për vetë Gjermaninë. Kështu si ndodhi lirimi i tyre, nën presionin e qeverisë gjermane, ka mbetur pezull dyshimi se ata vërtet kanë kryer veprën për të cilën janë arrestuar. Lirimi i tyre, edhe përkundër shqiptimit të masës së arrestit njëmu-jor, është shkelje e ligjeve të këtij vendi. Mbetet dyshimi se ata janë marrë me urgjencë në Gjermani, për të fshehur të vërtetën e aktiviteteve ilegale në Ko-

sovë. Ky vërtet është shembull i keq i ndikimit arrogant të politikës gjermane mbi drejtësinë kosovare.

Në reagimin e firmosur nga Rupert Nojdeku, mbetet i pamotivuar krahasimi që i bën ndihmës amerikane për Kosovën, me ndihmën gjermane. Që të dyja janë ndihma të rëndësishme, për të cilat populli i Kosovës u është shumë mirënjohës edhe SHBA-ve edhe Gjermanisë. Megjithatë, ndihma amerikane për çlirim dhe për pavarësinë e Kosovës, mbetet e pakonkurrencë. Sidoqoftë, nëse ndihma kujtohet në raste si ky i aktiviteteve të dyshimta të agentëve, kjo shndërrohet në mjet presioni dhe shantazhi, për të të mbajtur gojëmbyllur. Minimumi është që këtë



gjë nuk duhet të na e kërkojnë “miqtë e dëshmuar”. Nëse ata vazhdojnë të kërkojnë po këtë gjë, rrezikojnë të sil- len si “gazdallarë”, e jo si miq.

Meqë Nojdeku e ka hapur temën e miqësisë në kontekstin e arrestimeve të shkelësve të ligjit, pashmangshëm imponohet edhe një lloj reciprociteti edhe në këtë temë. Përvojat e arrestimit të shqiptarëve të Kosovës në Gjermani janë shumë më të mëdha dhe nuk mund të krahasohen me arrestimin e tre gjermanëve në Kosovë. Por, qeveria e Kosovës dhe populli i Kosovës nuk ka shprehur as dyshime e as armiqësi ndaj Gjermanisë në aso rastesh. Madje edhe kur figura të shquara shqiptare janë vrarë në truallin gjerman, si Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla, e kurrë nuk janë zënë vrasësit, njerëzit e Kosovës nuk e kanë akuzuar qeverinë gjermane me akuza si këto të “mikut të shquar të Kosovës”.

Përfundimisht, ne shqiptarët vërtet duhet të mësojmë nga kjo përvojë e re, të cilën na e serviri Rupert Nojdeku me tekstin “Debakli i Prishtinës”. Edhe pse ky është debakël moral i vetë Rupert Nojdekut, i shkaktuar nga infektimi i tij, (shpresojmë kalimtar) nga



ideologjia kronike antishqiptare e Der Shpigelit, ai diçka na mëson. Na mëson se shteti/atdheu dhe kauza e tij, është më i vlefshëm se sa miqtë. Madje edhe se sa ata që thonë se janë “miq të dëshmuar”.

P.S.

Mehmet Kraja, i bërë së fundi edhe akademik, duket që ka vuajtur shumë këto ditë, për shkak të këtij reagimi ndaj Nojdekut. Ka firmosur te gazeta Express, një fletërrufe të fortë të tipit kooperativist, ku ka gërmuar nëpër zorrë, për të zbuluar motive të fshehta politike e fetare(!), që më paskërkan shtyrë ta denoncoj ashtu Nojdekun. Mehmeti si Mehmeti! Është njeri që nuk ka lënë institucion e personalitet shqiptar pa e fyer, por të huajt nuk ka dëshirë t'ia ngucë askush. Helbete, kësaj here mos i duhet ndonjë vizë në Ambasadën Gjermane, për vete a për njerëzit e vet. Tjetër arsye nuk ka të mbrojtë mbrojtësin e spiunëve, e të fyejë me fjalë prej rrugaçi, një kolegun e vet. Nëse Nojdeku paskësh shkelur anekënd fshatrave të Kosovës, kjo nuk i jep të drejtë të fyejë një qeveri të zgjedhur në mënyrë demokratike, për të shpërlarë nga turpi një grup spiunësh, që janë zënë në flagrancë.

Sa u përket ndërtimeve të shtëpive nga “Cap Anamur”, Nojdeku nuk i ka bërë ato ndërtime me paratë e veta e as të babait të vet. Përkundrazi, është paguar për punën që ka bërë. Me kesi kriteri, edhe mijëra ndërtimtarë shqiptarë të Kosovës, që kanë ngritur mijëra objekte në Gjermani, rezultojnë të jenë humanistë. Edhe ata kanë shkuar në aso vendesh, të cilat intelektualët gjermanë mund të mos i gjejnë në hartë.

Përfundimisht, me këto prirje sadiste, i posafuturi me yrysh në gjirin e Akademisë së sklerotizuar të Kosovës, Mehmet Kraja, është një shembull i dhimbshëm i atij soji intelektual, që përfiton favore, duke pështyrë me kënaqësi perverse mbi fytyrën e vendit të vet dhe të kolegëve të vet. Nga kush ta ketë mësuar këtë strategji, sipas të cilës avancimi është i sigurt, nëse i fyen vetëm shqiptarët? Apo mos është ky një kompleks faji, për të cilin vetëm ai është në dijeni?

15 dhjetor 2008

# Doganat në



Sead UJKANI

**T**ë gjithë jemi dëshmitar të asaj që ndodhi në lidhje me planin gjashtëpikësh të propozuar nga Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki Moon. Tërë ai konfuzitet i krijuar rreth tij, në lidhje me përmbajtjen e tij dhe euforinë e treguar nga ana e udhëheqësve të shtetit tonë karshi tij, tërë ato kundërshtime dhe demonstrata të organizuara nga përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Tërë ajo fushatë mediale e bërë në lidhje me to, nuk e pati efektin e vet sepse prapëseprapë ky plan u miratua në Këshillin e Sigurimit dhe si i tillë hyri në zbatim.

Ajo çka mbetet tash të shihet është fakti se cili do jetë ndikimi i këtij plani në stabilitetin dhe prosperitetin e vazhdueshëm të shtetit më të ri në botë.

Plani gjashtëpikësh edhe pse, në realitet, me një përmbajtje të shkurtër, ndërhyr drejtpërdrejtë me rekomandime në disa nga elementet themelore të shtetit tonë, përkatësisht në sferën e sigurisë, ekonomisë dhe drejtësisë, të cilat përgjithësisht janë pikat kyçe të funksionimit të një shteti. Në një nga pikat përmbajtjesore të tij, respektivisht në pikën e dytë të këtij plani, jepen rekomandimet për funksionimin e do-



# gjashtëpikëshin e Ban Ki Moon-it

ganave.

Sipas tij, Kosova do të vazhdojë të funksionojë si një rajon i vetëm doganor ndërsa oficerët ndërkombëtarë të doganave, të emëruar në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999), do të rikthehen në portat 1 dhe 31. Në këto dy pika do të aplikohen procedurat në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, përfshirë këtu edhe Protokollin ndërmjet administratës tatimore të Republikës së Serbisë, që vepron për Ministrinë e Financave dhe Shërbimit të Doganave të UNMIK-ut, si dhe do të aplikohen tarifatat, të cilat janë në përputhje me kodin e doganave të rregullores 2004/1 të UNMIK-ut.

## Hapen pikat kufitare "problematike"

Sipas këtij plani, pra, parashihet edhe hapja e pikave kufitare 1 dhe 31, respektivisht pikave në komunën e Zubin Potokut dhe Leposaviqit, të cilat tradicionalisht, pas përfundimit të luftës, janë dëshmuar shumë "problematike" për vendin tonë dhe, si të tilla, i kanë bërë dëm të madh ekonomisë së Kosovës, duke ndikuar drejtpërdrejt në buxhetin e saj, përkatësisht në uljen e përqindjes së të hyrave doganore në buxhetin e Kosovës.

Këto dy pika kufitare janë vlerësuar nga ekspertët tanë si ambiente të "mirëfillta" për zhvillimin e kimit të organizuar dhe dukurive të tjera të dëmshme për ekonominë e vendit, në veçanti dhe shtetin, në përgjithësi.

Plani përkatës për çështjen e doganave rekomandon ndarjen e të hyrave doganore. Ai parasheh se të ardhurat nga këto dy pika kufitare të distribuohen për zhvillimin e komuniteteve lokale, e që në rastin tonë përfitues direkt do të ishin qytetarët e këtyre dy qyteteve, pjesa dërmuese e të cilëve i përkasin komunitetit serb. Nën-pika d. e pikës së dytë të këtij plani e specifikon këtë çështje më detajisht. Në të thuhet: "Do të nevojiten negociata të mëtutjeshme, mes palëve relevante negociuese, për të arritur pajtimin dhe për të përcaktuar modalitetet për operim për riaktivizimin e pikave doganore, të përmendura

më lart. Këto diskutime gjithashtu do t'i adresohen edhe distribuimit të të ardhurave doganore, të grumbulluara në

## Huruglica: Nga mos-funksionimi i dy pikave doganore në veri, Kosova humb 20 - 22 milionë euro në vit

Duke folur rreth ngjarjeve të fundit, sa i përket këtyre dy pikave, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës, Naim Huruglica ka theksuar: "Javën e ardhshme pritet përcaktimi i mënyrës së rikthimit të kamerave në këto pika dhe kështu zyrtarëve të EULEX-it dhe oficerëve tanë fillimisht t'i krijojmë kushte përmes instalimit të këtyre kamerave, të cilat janë vendosur edhe më herët por kemi pasur pengesa nga pjesëtarë të caktuar të pidentifikuar, të cilët i kanë dëmtuar ato".

Drejtori Huruglica ka shprehur edhe njëherë gatishmërinë për rikthimin e oficerëve të doganave të Kosovës në këto dy pika dhe funksionalizimin e tërësishëm të tyre. "Mendoj se në momentin e parë kur të arrihet në konkluzionin se oficerët tanë doganorë nuk janë në rrezik nga grupe të caktuara që qarkullojnë lirshëm, ne do t'i vëmë në funksion. Nëse jo në të dy pikat përnjëherë, atëherë ne do të kemi patrullime të shpeshta në ato pika" - ka thënë Huruglica.

Të hyrat nga këto dy pika konsiderohet të jenë rreth gjashtë milionë euro, pa marrë parasysh kontrabandën e madhe e cila ka karakterizuar pikat doganore në veri, gjatë këtyre viteve. "Kontrabanda nëpër pikat doganore në veri ka variuar në muaj të caktuar nga 2 deri 3 milionë euro, e që në total, gjatë tërësive të vitit, kalon shifrën 20 - 22 milionë euro" - ka theksuar Huruglica.

pikat 1 dhe 31, të cilat gjithashtu duhet t'i kontribuojnë edhe zhvillimit të komuniteteve lokale".

Lidhur me këtë çështje, zëdhënësi i qeverisë, Memli Krasniqi, ka deklaruar se kundërshtimi i qeverisë për këto pika ka qenë i qartë dhe nuk ka çka të diskutohet në lidhje me to. "Kryeministri e ka bërë të qartë se kjo çështje ka rënë në ujë dhe nuk dëshirojmë të komentojmë më rreth këtij problemi" - ka thënë Krasniqi. Ndërsa zëdhënësi i doganave, Adriatik Stavileci nga ana e tij ka thënë: "Qeveria e ka shpallur të mbyllur këtë çështje, prandaj dogana nuk mund të përzihet në këto çështje". Gjithashtu, gjatë këtij muaji pritet edhe vendosja e kamerave në këto dy pika, të cilat pas shpalljes së pavarësisë janë shkatërruar dhe nuk kanë funksionuar më.

## Doganat kontribuuesi kryesor në buxhetin Kosovës

Doganat, që nga përfundimi i luftës, kanë mbajtur primatin e kontribuuesit kryesor në buxhetin e Republikës së Kosovës dhe si të tilla kanë luajtur rol thelbësor edhe në stabilizimin e vendit. Në këtë kontekst, vlen të theksohet që këtë muaj doganat kanë arritur rekord në mbledhjen e të hyrave, ngase për herë të parë, për buxhetin e Kosovës, janë mbledhur gjysmë miliard euro, dy muaj para përfundimit të vitit, duke shënuar kështu një rritje prej 54 milionë eurosh në krahasim me periudhën paraprake të vitit të kaluar dhe duke shënuar kështu një rritje prej 12 %, që duke marrë parasysh rrethanat dhe peripecitë e shumta me të cilat janë ballafaquar, sidomos gjatë këtij viti, është një sukses i veçantë i doganave.

Mirëpo, plani gjashtëpikësh tashmë ka hyrë në fuqi dhe vetëm mbetet të shihet se cili do jetë efekti i rekomandimeve të ardhura nga sekretari i OKB-së në tërë sferat në përgjithësi dhe në lëmin e doganave në veçanti.

Vendi ynë ka qenë edhe më parë pjesë e "eksperimenteve" të ndryshme, të cilat kanë shkruar në dëm të avancimit dhe zhvillimit të tij dhe nuk do ishte çudi që edhe këto pika të kishin të njëjtin skenar të rrjedhës së tyre!!!

Intervistë me Agron Mustafën, drejtor menaxhues i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës

# Së shpejti rrugë e re

- Deri në fund të vitit 1,2 milion udhëtarë
- Fitimi për këtë vit rreth tetë milionë euro
- Produkte dhe linja të reja
- E ardhmja e Ndërmarrjeve Publike në Kosovë përfshirë edhe ANP-në, duhet të jetë Partneriteti Publiko-Privat
- Së shpejti rrugë e re ajrore me Shqipërinë

## Intervistoi: Demir RESHITI

**A**eroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP) radhitet ndër aeroportet lidere të rajonit. Viti 2008 mund të llogaritet si viti më i suksesshëm i këtij aeroporti i cili, përveçse është licencuar, ka tejkaluar numrin prej një milion pasagjerësh në vit. Deri më 31 shtator 2008, fitimi neto i aeroportit ka qenë 6 milion euro ndërsa deri në fund të dhjetorit pritet që të arrijë në rreth 8 milion euro, duke e radhitur këtë aeroport në mesin e ndërmarrjeve më të suksesshme publike në Kosovë. Ky fitim i siguar, tregon edhe njëherë punën e mirë të menaxhmentit të kompanisë dhe qasjen e re, atë të përkushtimit ndaj konsumatorëve.

Për t'u njohur më për së afërmi me të arriturat dhe projektet për të ardhmen, zhvilluam një intervistë ekskluzive me z. Agron Mustafa, drejtor menaxhues i ANP-së.

### Deri në fund të vitit 1,2 milion udhëtarë

**PAQJA:** Kohë më parë në ANP ka zbritur udhëtari i një milionit për këtë vit. Me çfarë shifrash po e mbyllni vitin 2008?

**Mustafa:** Vitin e kaluar ANP ka pasur 990 mijë udhëtarë komercialë, ndërsa këtë vit është arritur dhe tejkaluar numri prej 1 milion udhëtarësh komercialë, për herë të parë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Gjithsej, deri në fund të vitit presim që numri i udhëtarëve komercialë t'i afrohet shifrës 1.2 milion udhëtarë.

**PAQJA:** Çka keni ndërmarrë për ta



**Agron S. Mustafa** është i lindur më 25 korrik të vitit 1977 në Prishtinë. Ka përfunduar fakultetin ekonomik në Prishtinë dhe ka një numër kursesh akademike dhe profesionale të përfunduara në institucione të njohura ndërkombëtare. Aktualisht është në përfundim të punimit të magjistraturës në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Që nga viti 2005 punon në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës në postin e Drejtorit të Burimeve Njerëzore e më vonë edhe të Administratës. Nga 3 prilli 2008 është Drejtor Menaxhues i ANP-së.

**përballuar këtë rritje të numrit të udhëtarëve?**

**Mustafa:** Gjatë këtyre muajve jemi munduar të përgatitemi sa më mirë për përballimin e fluksit të udhëtarëve. Kemi përfunduar disa projekteve, siç është ai i modifikimeve në terminal. Pastaj kemi ngritur kapacitetet teknike, ku kemi bërë instalimin e një numri shtesë të "chekingave". Po ashtu, kemi zgjeruar hapësirën e dedikuar për policinë e Kosovës, që ata të mund t'i kryejnë detyrat e veta më lehtë dhe më shpejtë duke mundësuar procedim më të shpejtë të kontrollimit të dokumenteve për të gjithë udhëtarët. Në përgjithësi, investimet e fundit të bëra i kanë mundësuar ANP-së që t'i rrisë kapacitete e veta dhe të jemi më efikas ndaj klientëve tanë. Kemi futur në treg produkte të reja që nuk kanë qenë më parë, si ai i shërbimit të 'Business Lounge-it' për udhëtarët që udhëtojnë në klasën e biznesit, ofrimit të hapësir-

ave promovuese për të gjitha bizneset e interesuara për promovimin e produkteve të tyre dhe jemi në pritje të lëshimit në treg të disa produkteve të tjera shtesë. Gjatë kësaj kohe kemi ndryshuar edhe identitetin e Korporatës, duke filluar me miratimin e logos së re të ANP-së, logo që i ka dhënë një imazh të ri aeroportit.

### Fitimi për këtë vit rreth tetë milionë euro

**PAQJA:** Jeni njëri ndër Aeroportet lider në rajon. A mund të na jepni ndonjë shifër se sa janë fitimet e aeroportit gjatë këtij viti?

**Mustafa:** Deri më 31 Shtator 2008, ne kemi arritur që fitimi neto i aeroportit të jetë rreth 6 milion euro, ndërsa deri në fund të dhjetorit, sipas parashikimeve, fitimet mund të arrijnë në rreth 8 milion euro. Duhet të cekim se përveç që kemi rritje të të hyrave, kemi një rënie të

# Ajrore me Shqipërinë

vazhdueshme të shpenzimeve, ato deri më tani kemi arritur t'i zvogëlojmë deri në 10%.

**PAQJA:** ANP tashmë ka marrë licencën ndërkombëtare nga Aviacioni Civil i Islandës. Çfarë kushtesh është dashur të plotësoni për t'u pajisur me këtë licencë?

**Mustafa:** Aviacioni Civil i Islandës (ICAA), e ka mbikëqyrur aeroportin që nga vitit 2004. Nga ACI-ja dhe së fundmi edhe nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës kemi marrë licencën ndërkombëtare. Për të marrë këtë licencë janë dashur rreth 50 milion euro investime, si ri-shtresimi i pistës, rrugës perimetraike, rrethojës së re të aeroportit dhe shumë investimet të tjera më të vogla. Në veçanti, përmendim ri-shtresimin e pistës, që ka kushtuar mbi 14 milion euro, pastaj ndriçimit të pistës, që ka kushtuar afër 6 milion euro. Si projekt kapital, kemi përfunduar edhe ndërtimin e garazhit për pajisjet e zjarrfikësve, projekt që ka përfunduar. Pastaj, kemi ndryshimet e fundit të terminalit që kanë përfunduar. Të gjitha këto kanë ndikuar që ANP të pajiset me licencë ndërkombëtare.

**PAQJA:** Me rastin e marrjes së detyrës keni deklaruar se jeni të përkushtuar që të krijoni kushte sa më të mira dhe më të favorshme për avio-kompanitë në mënyrë që ato t'i zbrisin çmimet e biletave nga Prishtina... A ka ndodhur kjo zbritje e çmimeve?

**Mustafa:** Ne jemi në fazën përfundimtare të miratimit final (ANP-ja ka dhënë dritën e gjelbër) të disa prej planeve tona me interes të përbashkët, si p.sh. politikën nxitëse, që i dedikohet avio-kompanive. Kjo politikë përmban produkte të reja që më herët nuk ka qenë, siç është rasti që nëse një avio-kompani fillon një linjë të re, që nuk ka operuar më herët, ANP-ja ka paraparë lehtësime jo të vogla financiare, që për mendimin tonë janë mjaftë joshëse për avio-kompanitë. Po ashtu, edhe në rastet e shtimit të frekuencave për linjat aktuale janë paraparë lehtësime dhe faktorë nxitës. Lehtësime do t'iu ofrojmë edhe kompanive që rrisin numrin e udhëtarëve në vitin vijuar ndaj atij paraprak. Varësisht

edhe nga distanca e linjave të reja ajrore, politika e re nxitëse parasheh faktorë stimulues të ndryshëm për avio-kompanitë. Kjo mendojmë se do të ndikojë në uljen e çmimit të biletave.

**PAQJA:** A është vështirë të udhëheqësh një kompani siç është ANP-ja?

**Mustafa:** ANP-ja është njëra nga ndërmarrjet publike qendrore me status të qartë ligjor, sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike në Kosovë si dhe Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare, që përmban në vete karakteristikat e natyrës së biznesit që ushtron. Në rrethanat aktuale që është Kosova, duke marrë parasysh presionin e lartë shoqëror, si rezultat i gjendjes së rëndë ekonomike në vend, nuk është lehtë të menaxhohet një ndërmarrje publike në Kosovë. Megjithatë, përkushtimi ndaj punës, puna ekipore teknike dhe profesionale, si dhe një menaxhim efikas dhe i kujdesshëm i burimeve njerëzore të korporatës, me përkrahje nga Kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të Bordit të Drejtorëve, mundësojnë që ANP-ja dhe/apo çfarëdo ndërmarrje tjetër të udhëhiqet me jo shumë vështirësi.

**PAQJA:** Cilat kanë qenë të arriturat gjatë kësaj periudhe?

**Mustafa:** Të arriturat më të mëdha të ANP-së gjatë kësaj periudhe nuk janë të pakta. Është e një rëndësie të veçantë shpejtimi dhe kurorëzimi i procesit të certifikimit të ANP-së, proces i cili kishte filluar që nga viti 2004.

## Produkte dhe linja të reja

**PAQJA:** Çfarë produktesh të reja keni futur në treg gjatë kohës sa ju menaxhoni aeroportin?

**Mustafa:** Gjatë kësaj periudhe kemi arritur të ofrojmë shërbimet e dhomës së biznesit për të gjithë udhëtarët që udhëtojnë në klasë të biznesit. Kemi krijuar hapësira reklamuese dhe promovuese në ANP për të gjitha bizneset që dëshirojnë të promovojnë produktet e tyre. Jemi në futje të një numri të madh produktesh të reja, të cilat do të bëhen publike shumë shpejt.

**PAQJA:** Sa është shtuar numri i linjave nga për në Prishtinë?

**Mustafa:** Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore kemi arritur që një numër të avio-kompanive që nuk kanë operuar më parë në Prishtinë, t'i sjellim dhe të fillojnë operimet. Vlen të përmendet linja, Zagreb – Prishtinë, që nuk ka qenë më herët, e cila tani është linjë e rregullt, tri herë në javë. Është në plan që shumë shpejt të fillojë katër herë në javë dhe sipas gjitha gjasave, në pjesën e parë të vitit 2009, do të jetë fluturim i rregullt, 7 ditë në javë. Po ashtu, linjë e re që nuk ka qenë më parë është edhe ajo Prishtinë – Liezhë të Belgjikës. Gjithashtu, është më rëndësi të cekim linjën Prishtinë – Tiranë që operon në muajt e fundit tri herë në javë, dy herë në ditë. Linjë që ka lehtësuar qarkullimin në masë të madhe për të gjithë ata që udhëtojnë përmes Prishtinës dhe Tiranës.

## E ardhmja e Ndërmarrjeve Publike në Kosovë përfshirë edhe ANP-në, duhet të jetë Partneriteti Publiko-Privat

**PAQJA:** Në cilat projekte do të investoni në të ardhmen?

**Mustafa:** ANP-ja i ka dhënë prioritet fillimit të projektit mbi sortimin e bagazhit në ANP nga mënyra aktuale magnetike, në një mënyrë më të avancuar dhe automatike. Po ashtu së bashku me këtë projekt parashihet blerja dhe instalimi i skanerëve të avancuar për kontrollimin e bagazheve, skanerë të cilët janë të automatizuar dhe rrisin nivelin e sigurisë për disa shkallë gjatë kontrollimit të bagazheve të udhëtarëve në ANP. Po ashtu, në kuadër të këtij projekti, parashihet blerja dhe instalimi e tetë 'chekingave' të rinj, si dhe do investohet edhe në një linjë të re bagazhi, që pa dyshim do shkurtojë edhe më pritjet gjatë marrjes së bagazhit në arritje, që sot e kemi vetëm një. Përveç këtyre, ANP mund të përmend disa prej investimeve që planifikohen të fillojnë gjatë vitit të ardhshëm siç është ndërtimi i kullës së fluturimeve, së bashku me



infrastrukturën përcjellëse, investim që do të kushtojë disa miliona euro, ndërtimin e terminalit për persona të veçantë, delegacione qeveritare, zyrtarë ambasadash etj, prej 500 metrave katrorë që sipas vlerësimeve tona do të kushtojë rreth 500 mijë euro dhe do të fillojë të ndërtohet shumë shpejt dhe varësisht nga rrethanat, Menaxhmenti mund t'i propozojë Bordit të Drejtorëve idenë për ndërtimin e një terminali tërësisht të ri për pasagjerë, gjithmonë duke pas parasysh qasjen tonë në orientimin ndaj konsumatorit. Megjithatë, ligji mbi ndërmarrjet publike në Kosovë obligon kompanitë publike që të përgatisin Planin e Biznesit për vitin e ardhshëm, ku do duhet të bëhen të qarta synimet afariste dhe financiare të cilat synohen të arrihen nga NP si dhe orarin për realizimin e tyre. Andaj, Menaxhmenti i Aeroportit së bashku me Kryetarin e Bordit të Drejtorëve dhe Bordin e Drejtorëve do dalin shpejt me Planin e Biznesit, i cili do bëjë publik orientimin investiv të Aeroportit.

**PAQJA:** *Është paralajmëruar mundësia e dhënies me koncesion të ANP-së. Cili është mendimi juaj për këtë, duke pasur parasysh që aeroporti është në një gjendje të mirë dhe të qëndrueshme financiare?*

**Mustafa:** Koncesioni është një çështje që i përket Akcionarit të ANP-së dhe është një vendim që duhet të merret nga vetë aksionari për të ardhmen e ANP-së. Ministria e Ekonomisë dhe Financës, duke vepruar në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka publikuar kërkesën për pranimin e propozimeve nga konsulentë apo grupe konsulentësh të interesuarish për ofrimin e shërbimeve konsulente për strukturimin dhe implementimin e Partneritetit Publiko Privat në ANP. Duhet të keni parasysh që trendet e fundit të zhvillimeve të Aeroporteve Ndërkombëtare bazohen në Partneritetin Publiko-Privat. Praktikrat e gjertanishme tregojnë se partneritetet e tilla kanë rezultuar me sukses dhe janë bazë e shëndoshë e zhvillimit të Aeroporteve me standarde të larta botërore. ANP-ja sot është në një gjendje të mirë dhe të qëndrueshme financiare, por është e paqartë se sa gjatë mund të jetë një situatë e tillë, duke marrë parasysh zhvillimet e fundit të aeroporteve që janë konkurrent të drejtpërdrejtë të ANP-së, si p.sh. ai i Shkupit. Të gjitha ndërmarrjet publike në Kosovë kanë vështirësitë e tyre të shumta zhvillimore, si

rezultat i nënshtrimit të ligjeve të ndryshme, që në të shumtën e rasteve nuk janë favorizuese për zhvillimin dhe bërjes së tyre konkurrent në treg. Partneriteti Publiko-Privat, duke mos predikuar formën e tyre, ofron mundësi më të shpejta dhe fleksibile për ngritjen e aftësisë konkurruese dhe përparësive krahasuese të ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, ngrit edhe nivelin e infrastrukturës së tyre në nivel të ndërmarrjeve evropiane dhe botërore. Andaj, pa dyshim, që çdo gjë që shkon në rritjen e aftësisë konkurruese në treg të ANP-së dhe që shton vlerën e saj, Menaxhmenti i ANP-së do e përkrahë. Përndryshe, duke marrë për bazë trendet aktuale, e ardhmja e Ndërmarrjeve Publike në Kosovë duke përfshirë ANP, duhet të jetë Partneriteti Publiko-Privat apo dhe privatizimi i tyre.

### **Së shpejti rrugë e re ajrore me Shqipërinë**

**PAQJA:** *Kosova dihet se ka vetëm një korridor ajror. Kjo bën që aeroplanët që shkojnë në Tiranë të shkojnë nëpërmjet Maqedonisë. A keni ndonjë plan lidhur me krijimin e një korridori të ri me Shqipërinë?*

**Mustafa:** ANP-ja disa herë e ka ngritur çështjen e rrugëve të reja ajrore për dhe nga ANP-ja. Rruga e vetme ajrore sot për fluturime komerciale për dhe nga ANP-ja, është nëpërmjet Maqedonisë. ANP-ja ka qenë dhe është në dijeni se një rrugë e vetme ajrore, i detyron aeroplanët që të udhëtojnë për disa minuta më gjatë deri në ANP dhe anasjelltas, duke rezultuar direkt në ngritjen e shpenzimeve operative për avio-kompanitë që operojnë për dhe nga ANP-ja.

Me iniciativën e ANP-së kemi realizuar disa takime me Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, ku atyre u kemi dorëzuar edhe një (draft) plan të veprimit rreth mundësisë së hapjes së rrugës së re ajrore me Shqipërinë. Kemi hasur në mirëkuptim dhe përkrahje të plotë nga Ministria dhe sot sipas informatës së disponueshme, Ministri i Transportit dhe Post Telekomunikacionit i Qeverisë së Republikës së Kosovës është pajtuar në parim me Ministrin homolog të Republikës së Shqipërisë për hapjen e rrugës të tillë ajrore dhe çështja do të kalojë në nivele teknike, në këtë rast në mes të Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror të Shqipërisë dhe ANP-së. Unë, besoj që shumë shpejt këto nivele teknike do të ulen për të shqyrtuar dhe do të shohin se, çka duhet të bëhet në të dy anët e kufirit teknikisht që të jemi të gatshëm për të filluar një korridor i tillë të jetësohet.

**Paqja:** *Cilat do të jenë interesat e Kosovës me hapjen e këtij korridori?*

**Mustafa:** Automatikisht ky korridor do të ndikonte në zvogëlimin e kohës së fluturimeve për një numër aeroplanësh, varësisht nga vijnë në ANP. Zvogëlimi i kohës së fluturimeve, ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e shpenzimeve operative si atyre të derivateve, pastaj në zvogëlimin e pagave të pilotëve, stafit përcjellës etj. Dhe kur fluturimi në destinacione të njëjta mund të operohet me shpenzime më të vogla, automatikisht ka mundësi që të ulen biletat nga ana e avio-kompanive. Qëllimi ynë është që të kemi rrugën e tillë ajrore dhe ne si Aeroport t'u krijojmë mundësi avio-kompanive që ata të shikojnë mundësitë e tyre reale për të zbritur çmimet e biletave. Mirëpo, duhet ta bëjmë të qartë se është politikë e avio-kompanive për determinizimin e çmimeve të biletave dhe jo e Aeroportit.

# Universiteti i Prishtinës me hapa të guximshëm drejt Procesit të Bolonjës

Zyra për Zhvillim akademik është themeluar me qëllim që të promovojë dhe të zbatojë objektivat e Bolonjës për integrim në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë



**Gëzim QERIMI**

Universiteti i vetëm publik në Republikën e Kosovës, Universiteti i Prishtinës (UP) nën moton "E ardhmja është në duart tona", është përcaktuar për mësim dhe hulumtim, sipas vlerave e sistemeve perëndimore.

Vizioni i UP-së, është i orientuar në aftësimin e kuadrit mësimor për zbatimin e metodave bashkëkohore për mësimdhënie, evoluimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të hulumtimit, përmirësimin e përhershëm të programeve dhe të studimeve sipas Bolonjës, sigurimin e infrastrukturës, kapaciteteve ligjore dhe teknike për plotësimin e kriterëve ndërkombëtare për akreditim, si dhe sigurimin e fondeve publike dhe fondeve të tjera për realizimin e procesit mësimor dhe procesit të hulumtimit.

Universiteti i Prishtinës, me kapacitetet intelektuale, profesionale dhe shkencore, ka në vazhdimësi si synim kryesor që shtetin e Kosovës ta bëjë pjesë reale të shoqërisë evropiane.

UP-ja po bën hapa të guximshëm drejt Procesit të Bolonjës. Në këtë kontekst është themeluar edhe Zyra për Zhvillim akademik.

Kjo Zyrë është themeluar me qëllim që të promovojë dhe të zbatojë objektivat e Bolonjës për integrim në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Zyra përbehet nga tri njësi: Njësia për Sigurimin e Cilësisë; Njësia për Koordinimin e ECTS-ve; dhe nga Qendra LINK (Njësia e Shërbimeve Përkrahëse

për studentë).

## Njësia për Sigurimin e Cilësisë

Në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, mbi vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë dhe me Standardet dhe Udhëzimet e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë (ENQA), Njësia për Sigurimin e Cilësisë merret me themelimin dhe me zbatimin e procedurave që janë të orientuara drejt cilësisë në çdo pjesë të Universitetit, për të ofruar një nivel të lartë të shërbimeve akademike dhe administrative.

Njësia për Sigurimin e Cilësisë ka ngritur Komisionin Qendror për Sigurimin e Cilësisë në UP. Ky komision përbëhet nga stafi akademik, administrativ dhe nga strukturat studentore-Parlamenti i Studentëve.

Komisioni për Cilësi deri me tani ka hartuar Udhë-

zuesin për


vlerësimin e cilësisë, i cili është në harmoni të plotë me Standardet dhe Udhëzimet e Asociacionit Evropian për sigurimin e cilësisë dhe do të shërbejë për të ndihmuar organizimin e vlerësim-it të brendshëm dhe të jashtëm të UP-së, i cili tashmë ka filluar.

## Njësia për Koordinimin e ECTS-ve

Prezantimi i suksesshëm i një Njësie Qendrore të Koordinimit të ECTS-ve me koordinatore nëpër fakultete, me qëllim që t'ju ndihmojë profesorëve të caktojnë vlera kreditore në lëndët e tyre, e shton mundësinë që Universiteti jo vetëm ta përmirësojë cilësinë e programeve të veta, por edhe të diplomuarve të vet ua rrit njëkohësisht performancën profesionale, por edhe shton transparencën dhe sjell strukturat e veta institucionale e akademike në linjë me trendët e reformave në arsimin e lartë në Evropë.

## Qendra LINK

Qendra LINK është inauguruar zyrtarisht nga Rektori i UP-së më 24 prill 2007. Qendra është e para e këtij lloji në Universitetin e Prishtinës dhe ofron shërbime për 34000 studentë si dhe për nxënës të shkollave të mesme që interesohen për të hulumtuar mundësitë e studimeve në UP. Në vitin e parë të veprimit të saj, Qendra për përkrahjen e Studentëve LINK ka shpërndarë informata lidhur me burimet, ngjarjet, mundësitë e karrierës, praktikën, etj. Qendra ka bërë edhe mikpritjen për këshillime individuale dhe grupe, ka ofruar punëtori për orientimin e studentëve të rinj, trajnime për aftësi të nxënies si dhe udhëzime për karrierë.



Në dyvjetorin e daljes së revistës "Paqja"

# Aty ku punohet, nuk mu



Emine A. VEZAJ

**Th**onë se aty ku punohet nuk mungon sukcesi. Realisht, kjo frazë është ndër më kuptimplotat për revistën "Paqja", e cila në fillim të muajit dhjetor 2008 ka shënuar dyvjetorin e botimit.

Dy vite më parë, gjegjësisht në muajin dhjetor të vitit 2006, spektrit të revistave shqipe që dalin në Kosovë iu shtua edhe revista për aktualitet, kulturë, arsim e etikë, me emrin simbolik "Paqja", si organ i shoqatës "Zëri Ynë".

## Pak retrospektivë

Fillimi i kësaj reviste karakterizohet nga një staf që nuk kishte ndonjë përvojë në gazetari, por ishin njerëz me vullnet të madh, dashamirë të shkencës dhe

punës. Drejtor (botues) i kësaj reviste ishte dhe aktualisht është Muhamed Jusufi – Kajolli, redaktor përgjegjës: Shkelzen Nuza, redaktore gjuhësore: MIMOZA Sinani, si dhe redaktor teknik/grafik: Osman D. Gashi, ndërkaq në përbërje të redaksisë ishin: Arbër Zeka, Ilir Desku, Nexhati Spahiu dhe Mërgim Lushtaku.

Pas gati një viti punë, drejtimin e revistës e merr gazetari me përvojë shumëvjeçare, Demir Reshiti i cili edhe është aktualisht redaktor përgjegjës. Me këto ndryshime, u fut një frymë e re pune në revistë, e cila dita-ditës pasurohej dhe përfitonte lexuesin e saj anekënd Kosovës, por edhe në Maqedoni dhe Shqipëri.

Dhe siç thotë fjala e urtë "gur, gur bëhet kalaja", numër pas numri edhe "Paqja" u shndërrua në një kështjellë ku bënë hapat e parë në gazetari shumë



studentë (pjesa më e madhe studentë të Degës së Gazetarisë në UP, por edhe studentë të drejtimeve të tjera që kishin prirje në gazetari. S'do mend se kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim ka dhënë dhe po jep profesori i nderuar Milazim Krasniqi i cili është një nga nismëtarët e botimit të revistës, me të vetmin qëllim që t'u krijohet hapësirë të rinjve që t'i sprovujnë aftësitë e tyre prej gazetari.



# ngon sukses!

Deri më tani janë botuar njëzet e katër numra të revistës, duke shënuar rritje cilësore në çdo numër dhe shtim të bashkëpunëtorëve nga e gjithë gjeografia shqiptare, madje edhe nga SHBA-ja.



## Dyvjeteri shënohet në Prevallë...

Me rastin e dyvjeterit të botimit, redaksia e revistës "Paqja", më 5 dhjetor të këtij viti, ftoi shumicën e bashkëpunëtorëve në një drekë të përbashkët që u shtrua në ambientet e hotelit "Kalliri i mirësisë", në Prevallë të Prizrenit.

Ishte ky një moment i veçantë për faktin se u takuan dhe u njohën më për së afërmi bashkëpunëtorët e revistës me njëri-tjetrin, por edhe me planet e revistën për të ardhmen.

Pas një dreke të begatshme, të pranishmëve me një fjalë rasti ju drejtua drejtori Muhamed Jusufi – Kajolli, i cili shprehu një falënderim për angazhimin që kanë bërë stafi redaktues dhe bashkëpunëtorët, falë punës të së cilëve janë shënuar rezultate të pamohueshme. Lidhur me planet e punës dhe orientimeve redaktoriale në të ardhmen ka folur redaktori përgjegjës Demir Reshiti, i cili ka thënë se përkundër sukseseve të arritura, nuk duhet të lëshohemi në vetëkënaqësi, por të punojmë për ta ngritur edhe më cilësinë e revistës dhe për ta ruajtur lexuesin të cilin tashmë e ka përfituar "Paqja".

Profesori Milazim Krasniqi, fillimisht u ka përkujtuar të pranishmëve një historik të shkurtër të lindjes dhe rritjes dyvjeçare të revistës "Paqja" dhe i ka stimuluar bashkëpunëtorët për një punë më intensive në revistë duke sugjeruar që revista të pasurohet me rubrika të tjera të reja krahas atyre që e karakterizojnë tani.

Në vazhdim, është zhvilluar një bisedë kolegjiale në të cilën kanë marrë pjesë edhe pjesëmarrësit e tjerë, të cilët kanë shprehur fjalë miradije për organizatorët dhe e kanë vlerësuar këtë takim si stimulim për punë të mëtutjeshme.

## Fondacioni "Atmosfera" hap zyren në Prishtinë



**F**ondacioni për arsim dhe kulturë "Atmosfera", më 4 dhjetor ka bërë hapjen solemne të zyrës qendrore në Prishtinë si dhe ka inauguruar konviktin për 100 studentë.

Shiritin e hapjes e kanë prerë bashkërisht drejtori i Fondacionit, z. Talib Aktash dhe përfaqësuesi nga Ministria e Shërbimeve Publike, Bajram Kosumi.

Në ceremoninë e hapjes, ku ishin të pranishëm një numër i madh i intelektualëve dhe përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme në Kosovë, drejtori i këtij Fondacioni Talip Aktash, tha se: 'Fondacioni ka për qëllim të ndihmojë studentët të cilët duke studiuar fusha të ndryshme, në të njëjtën kohë, do të mësojnë edhe rrugën e formimit të një personaliteti të mirëfilltë moral, që të jetë i dobishëm për shoqërinë dhe mjedisin.'

Aktash ka thënë se brenga e vetme e Fondacionit është që t'i ndihmojë gjeneratat e ardhshme që të marrin një arsimim të mirë dhe një edukim të mirë, për të jetuar në paqe e mirëqenie, me dashuri, tolerancë, parakushte këto që do ta forcojnë edhe Pavarësinë e Republikës së Kosovës. Më tej, Aktash ka thënë se në konviktin me 100 vende do të strehohen studentë nga vende të ndryshme të Kosovës, për të cilët është siguruar një ambient bashkëkohor. Ai ka theksuar se "Atmosfera" tashmë ka hapur një konvikt në Prizren ku janë vendosur nxënës të shkollave të mesme nga rajoni i Prizrenit.

Fjalim përshëndetës kanë mbajtur edhe sekretari i përgjithshëm i Bashkësisë Islame të Kosovës, z. Resul Rexhepi si dhe përfaqësuesi nga Ministria e Shërbimeve Publike, z. Bajram Kosumi, të cilët kanë shprehur shpresën se institucione të tilla, që do të ndihmojnë arsimin, do të ketë edhe në të ardhmen.

Sipas koordinatorit Bashkim Çmega, aktualisht, në konviktin e Fondacionit "Atmosfera", janë strehuar rreth 60 studentë, duke shtuar se gjatë 4 vitesh të veprimit, Fondacioni "Atmosfera", po ashtu, ka organizuar edhe konferenca me tema të ndryshme, simpoziume për dialogun ndërfaqësor dhe ndërkulturor, shëtitje me intelektualë jashtë vendit, si dhe janë bërë promovime, botime dhe shpërndarje të librave të karakterit kulturor.

(Ditëlind Reshiti)

**BFI-ja, në vend se të gëzojë kredibilitetin si institucion i lartë fetar, po bëhet arenë cirku, që i nxit njerëzit herë të qajnë (ithtarët e Islamit), e herë të qeshin (dashakeqësit e Islamit)**



**Avni AVDIU**

**P**as partive politike shqiptare, Bashkësia Fetare 'Islame' në Maqedoni është subjekti më i përfolur problematik. Zaten kjo Bashkësi e Fraksioneve Interesante ka qenë arenë e skandaleve, që kanë dëmtuar jo vetëm imazhin e muslimanëve përpara njerëzve të përkatësive të tjera fetare, por edhe imazhin e Islamit në Maqedoni e më gjerë. Askujt nuk do t'i shkonte as ndërmend se disa hoxhallarë dinë të bëjnë aso veprimesh të turpshme, për të cilat edhe djalli do t'ua kishte zilinë (ose lakminë). Lajmi i fundit që u publikua me pompozitet nga mediat, e që kishte të bënte me kapjen e shoferit të reisit të BFI-së, njëherësh anëtar i muftinisë së Shkupit, Afrim Feratit, me lëndë narkotike, dëshmoi se kjo bashkësi vërtet ka marrë tatëpjetën. Zaten sipas burimeve të televizionit AlsatM, ky skandal ishte pretekst që besimtarët muslimanë gjatë faljes festive të namazit të kurban bajramit ta bojkotonin xhaminë e sulltan Muratit në Shkup, në shenjë pakënaqësie ndaj kreut të BFI-së, Sulejman Rexhepit, prezenca e të cilit ishte paralajmëruar. Madje, po sipas të njëjtit bu-

**Korrespondencë nga Shkupi**


# Çka po ndodh

rim, kreut të BFI-së nuk i kanë arritur as përgëzimet e zakonshme gjatë kësaj feste nga figurat politike në vend.

## **Kërkohej ndihmë nga Ali Ahmeti...**

Për ta kuptuar gjenezën e problematikës, sa për ilustrim, për të mos hyrë në spekulime e thashetheme po sjell disa theksime nga shkrimet e mëparshme, të cilat hedhin dritë kronologjike mbi disa parregullsi që e kanë përcjellë vazhdimisht këtë institucion fetar. Gazeta "Koha ditore", e ditës së enjte 23 qershor 2005, fq. 1 dhe 4 sillte raportin e Besim Iljazit me titull: "Reis Ul Ulema Emini i shtrirë në spital, Bashkësia Islame para shthurjes", ku thuhej se sipas fjalëve të familjes së tij nga Gostivari kryetari i BIM reis ul ulema Arif efendi Emini nga plagët e marra në fytyrë ditën e shtunë është shtrirë në spital. Ai, vazhdimisht, ka presione dhe lloj-lloj kërcënimesh... Prijësi fetar i muslimanëve, sipas informatave që depërtuan në opinion, është ofenduar dhe është sulmuar fizikisht nga një grup sulmuesish, të cilët kanë shtënë me armë zjarri në sallë dhe i kanë detyruar kuvendarët të shtrihen për tokë... Imamët e pakënaqur kërkojnë nga Ali Ameti (kryetar i partisë së BDI-së) që ai të vijë e të ngujohet bashkë me ta në kabinetin e BIM deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre... Imamët kanë paralajmëruar se për zgjidhjen e problemit do të kërkojnë edhe ndihmën e kryetarit të PDSH-së,

Arbër Xhaferit, duke paralajmëruar se do të kërkojnë një takim me të. Gazeta "Fakti", e premte 24 qershor 2005, fq. 5 sillte raportin e Sevdail Demirit me titull: "Vazhdon kaosi në BFI - Ahmeti sërish do të futet në qetësimin e hoxhallarëve", ku theksohet se kryetari i BDI -së ka konfirmuar sërish vullnetin e tij të mirë që të futet në zgjidhjen e problemeve në Bashkësinë Islame të Maqedonisë. Gazeta "Bota sot", e shtunë 25 qershor 2005, fq. 14 sillte raportin e M. Hoxhës me titull: "Imamët uzurpojnë zyrën e kryetarit të BFIM-së", ku theksohej se 'imamët e ngujuar kërkojnë zgjidhjen e problemit nga ana e kryetarit Arif Emini, në zyrën e të cilit janë ngujuar'. Gazeta "Fakti", e hënë 27 qershor 2005, fq. 1 dhe 5 sillte raportin e Eshref Ametit me titull: "A po i vihet çelësi Bashkësisë Islame?!", ku theksohej se tashmë nuk është duke funksionuar as rijaseti e as institucioni i kuvendit. Imamët thuhet në raport kanë ardhur në konstatim se Bashkësia Islame, si strukturë organizative, është e vdekur. Gazeta "Fakti", e martë 28 qershor 2005, fq. 1 dhe 3 sillte raportin e Eshref Ametit me titull: "Bashkësia Islame nën dry", ku thuhet se 49 të punësuarit e këtij institucioni do të mbeten pa punë. Natën mes të dielës dhe të hënës, përreth objektit ku është vendosur selia e BFIM, janë vërejtur disa vetura dhe pjesëtarë të njëjësive speciale "Alfa" (njësite policore speciale maqedonase). Gazeta "Lajm", e hënë 28 qershor



# h në BFIM?!

2005, fq.4 sjell raportin e Bekim Buçit me titull: “Bashkësia Islame në vdekje klinike”, ku ceket deklarata e kryesuesit të imamëve të ngjuar Muamer Veseli, i cili shpreson që rastin ta ndërmjetësojnë edhe tre liderët e partive politike shqiptare në Maqedoni: BDI-së Ali Ahmeti, PDSH-së Arbër Xhaferi dhe PPD-së Abdylhadi Veseli. Gazeta “Fakti”, e mërkurë 29 qershor 2005, fq. 5 sillte shënimin e Eshref Ametit me titull: “Reisi propozon takim pajtues te liderët e partive shqiptare”, ku thuhej se letra iu është adresuar tre liderëve të partive të BDI-së, PDSH-së dhe PPD-së, kryeministrit Vllado Buçkovski, Misionit Policor të BE-së në Maqedoni (Proxima), përfaqësuesit të BE në Maqedoni, ambasadës amerikane dhe turke, prej të cilave kërkohet të ndërhyjnë në zgjidhjen e problemit. Gazeta “Fakti”, e enjte 30 qershor 2005, fq. 7 sillte raportin e Eshref Ametit me titull: “Selia e BFIM pa telefon”, ku njoftohej se përveç telefonit parashikohet që imamëve të ngjuar t’u ndalet edhe rryma dhe uji. Në numrin e së premtes, fq. 5, i njëjti gazetar titullon raportin “Thellohet kriza në BFIM”, ku njoftohet për dorëheqjen e reisit Arif Emin. Gazeta “Bota sot”, e premte 1 korrik 2005, në fq. 12 Muhamed Hoxha sillte raportin me titull: “Bashkësia fetare islame në Maqedoni mbetet pa kryetar”. Gazeta “Koha ditore”, e hënë 4 korrik 2005, fq. 4 sillte raportin e Vedat Masarit me titull: “Sulmohen imamët e pakënaqur, Muhamer Vejselit i lëndohet syri”, ku flitej për përmasat e dramës që po ndodhte në Bashkësinë Islame të Maqedonisë. Persona të maskuar kishin dalë nga një veturë e tipit Opel Astra dhe sapo e kishin parë prijësin e imamëve të ngjuar në zyrat e reisit Muhamer Veselin kishin filluar ta godisnin me kondak të kallashnikovit në afërsi të komunës së Kondovës. Gazeta “Zëri”, e enjte 7 korrik 2005, fq. 12 sillte vështrimin e gazetës maqedonase ‘VREME’ (Koha) me titull: “Si e sheh shtypi maqedonas problemin në

Bashkësinë Islame të Maqedonisë”, ku thuhej: ‘Kaosi dhe incidentet në BIM janë rezultat i konfliktit ndërmjet përfaqësuesve të Islamit radikal dhe atij të matur’ – vlerësojnë mediumet e shtypit maqedonas lidhur me fërkimet në BIM.

Këto ishin disa referenca nga gazetat e ndryshme rreth ngjarjeve të mëparshme në Bashkësinë Islame të Maqedonisë. Ndërkaq, mediat elektronike maqedonase, siç janë A1, Siteli, Telma, TV5, Telma, RTVM etj, gjatë gjithë kohës së trazirave në këtë institucion fetar, kanë njoftuar po ashtu për rrahje hoxhallarësh mes vete, kërcënime dhe veprime të tjera me të cilat u bënë gazi i botës. Sivjet, BFI u ndodh sërish në udhëkryq. Problemi shpërtheu pak para Ramazanit, pas deklaratës së myftiut të Shkupit, Taxhedin Bislimit, i cili kundërshtoi vendimin e kryetarit të BFIM-së, Sulejman Rexhepit, për ndryshimet kushtetuese të këtij institucioni, se reisi e ndryshon kushtetutën kur t’i teket pa u konsultuar me myftilerët, me qëllim që të bëjë veprime konform vullnetit të tij, se nuk funksionon as Këshilli i Lartë Kushtetues, i cili do ta mbikëqyrte rrjedhën e zbatimit të kushtetutës, se nuk funksionon as kuvendi 51 anëtarësh, as rijaseti dhe se paralizimi i organeve punëdrejtuese të BFI-së bëhet me qëllim që reisi të ushtrojë pushtet absolut në këtë institucion, duke i instrumentalizuar 13 myftilerët në stilin ‘më zgjedh të të zgjedh’, një formë e njohur me terminologjinë më të re politike ‘putinizimi i postit’. Nuk mund të flitet për ndryshimin e kushtetutës, kur për të mëparshmen thuhet se ishte inekzistente, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me krijimin e një kushtetute të re, e jo ndryshim. Myftiu Taxhedin Bislimi mori guxim ta kundërshtojë ‘diktatorin’ e BFI-së për këto veprime arbitrare dhe, pas shkarkimit pa të drejtë ankese, ai e ndiente veten siç është shprehur ‘viktimë e mendimit të lirë’, sepse atë ka të drejtë ta shkarkojë rijaseti, e jo dikush prej deti (thuhej, po ashtu, se reisi Sulejman Rexhepi ishte në pushime në Ulqin kur

e shkarkoi myftiun e Shkupit).

Flitet se në BFI zotëron një atmosferë censure dhe ngufatje e mendimit të lirë, sa që mund të thuhet se është më e tmerrshme se në pushtetet monarkike ose në regjimet moniste. Gjithashtu, thuhet se bëhen shpërdorime të ndryshme financiare, përfshirë fondin e vakëfeve, haxhit dhe të hyrave të tjera. Për këto ‘spekulime’ asnjëherë nuk është ofruar publikisht ndonjë argument (p.sh: faturë, a dëshmitar) dhe as nuk është ngritur ndonjë akuzë gjyqësore, që përmes procedurave juridike të ndiqet dikush, prandaj përdërisa nuk ka prova faktike akuzat mbeten vetëm fjalë. Pa ferrë në këmbë shpëtuan edhe ata që i ‘kërcënuan’ gazetarët se nëse e publikonin ‘të vërtetën’ do t’u ngjiten fotot diku në ndonjë vend tjetër (lexo: në shtylla elektrike).

## Bashkësi e Fraksioneve Interesante...

Brenda BFI kanë ndodhur fraksionet më të çuditshme: disa hoxhallarë sa që janë pozicionuar në krahun e një ekstremi, befas kanë dalë në anën e ekstremit tjetër. Prandaj marr guximin ta quaj Bashkësi e Fraksioneve Interesante. Meqë reisi ka qenë person ‘non-grata’, të habit fakti pse ai gëzonte mbështetje nga ata që sot kanë dalë kundër tij. Sado ‘diktator i ashpër’ të ketë qenë, është dashur t’i tërhiqet vërejtja me kohë, ashtu siç e kundërshtoi një grua në xhami halifin më serioz (të hulefae rashidinëve) Omar Ibën Hatabin. Duket e paimagjinueshme që gjithë ata burra hoxhallarë të mos kenë guximin dhe trimërinë as sa të një gruaje. Apo ndoshta është çështja sikur ‘story Stalin-Hrushov’. Nuk e di. Ndërkaq BFI-ja, në vend se të gëzojë kredibilitetin si institucion i lartë fetar, po bëhet arenë cirku, që i nxit njerëzit herë të qajnë (ithtarët e Islamit), e herë të qeshin (dashakeqësit e Islamit). Në çdo vend, kudo në botë, kur ndodhin gjëra të pahijshme, në shenjë të detyrimit moral ndaj njerëzve të ndershëm, kreu i institucionit të goditur nga gjendja e krijuar, jep dorëheqje. Megjithatë, kjo në BFI as që mund të paramendohet. Mirëpo është në interes të muslimanëve dhe imazhit të Islamit në Maqedoni që në këtë bashkësi të kthehet normaliteti i punës dhe që në të ardhmen ajo të mos jetë vasale e partive politike, por të jetë mbi to dhe interesat e tyre.



Ferid SELIMI

**L**indja e një shteti të ri në botë nuk do të nënkupton domosdoshmërisht edhe lindjen e një kombi të ri, nëse ai ekziston me shekuj!

Nacionet shtet dhe komb janë dy nocione që nuk duhet kuptuar si sinonime. Ato kanë lidhshmëri në mes vete, por vetë emërtimet, të lënë të kuptosh që secila ka domethënien e vet. Derisa shteti ka të bëjë me një organizatë politike që ka për tendencë sundimin e një vendi a një territori, i përcaktuar, i udhëhequr dhe i sanksionuar me ligje, kombi ka të bëjë me popullatën që jeton brenda një shteti që ka traditën, kulturën, gjuhën dhe historinë e përbashkët.

Derisa kombet lindën në shekullin e nëntëmbëdhjetë, shteti është krijuar shumë më herët, që në antikën e vjetër ku njiheshin qytete-shtetet (Polis-et).

Njerëzit, gjatë historisë së civilizimit, kanë jetuar nëpër kope, pastaj fise, e më vonë u krijuan kombet të cilat kishin një përkatësi të një grupi etnik.

Derisa më herët mendohej se shtetësia fitohej me të lindur, sipas teorive të reja, ajo nuk qëndron më, ngase shtetësia mund të merret. Shembuj për këtë mund të merren Amerika dhe Izraeli. Në këto shtete janë vendosur grupe të ndryshme etnike ose (paraardhësit e tyre kishin një kombësi tjetër). Më parë e bëmë të njohur që gjuha e përbashkët ishte baza e kombit, sepse gjuha e lidhte popullin me historinë, gojëdhënat dhe territorin. Të gjitha këto elemente që përbëjnë kombin, mbase, e bëjnë më të qartë dallimin që ai ka nga shteti.

Nëse i referohemi Fjalorit Politik të Oksfordit, ky përkufizim dallues është më koherent, por nuk e ka shpjegimin e duhur për shtetet shumëgjuhëshe të tilla si zviceranët, indianët e belgët dhe nuk pajtohet me realitetin e sotëm, ku shumë popuj në të kaluarën kishin gjuhë të parë spanjishten ose anglishten. Përbërja e kombeve të mëdha është bërë në tri mënyra: nëpërmjet asimilimit, shkrirjes në kombin tjetër dhe pluralizmit kulturor. Raste të tilla ka në Amerikë, Britani, Turqi etj. Ndërkaq, fati i kombeve

# Shteti nuk është

**Nisur nga fakti që përkatësia etnike kombëtare vjen si rrjedhojë e vetëdijes së përbashkët e prejardhjes dhe e traditave të përbashkëta, kujtoj që edhe po të mbështetej krijimi i kombit kosovar (që s'e besoj), ky komb do të ishte jetëshkurtër**

të vegjël, që u shpërndanë nëpër botë duke jetuar në shtete të ndryshme, ishte i tillë që ata assesi nuk mund të kultivonin në mënyrë të barabartë kulturën e tyre shekullore. Kështu, sipas mendimit tim, lindën pakicat kombëtare me përkatësi të ndryshme që gjithsesi asnjëherë nuk e ndalën përpjekjen për të realizuar të drejtën e të qenit komb.

## **Çdo tentim për krijimin e një kombi të ri do të ishte artificial dhe nuk do të funksiononte**

Thuhet se shqiptarët, duke u mbështetur në mendimet e historianëve dhe albanologëve të njohur, kanë prejardhje iliro-pellazge. Si të tillë, ata nga një sërë fisesh si grup etnik kulturor e politik, me zhvillimin e mëtutjeshëm të kulturës, traditës, ekonomisë e politikës, themeluan principata, u shkrinë në komb, e më pas formuan shtetin shqiptar, mbase të përgjysmuar, në fillim të decenies së dytë të shekullit të 20-të.

Kosova, një territor prej dhjetë mijë kilometrash katrorë, i banuar kryesisht me shqiptarë, e që ishte pjesë e territorit të Shqipërisë, atëbotë u aneksua nga Serbia cariste. Ashtu e aneksuar mbeti edhe në kohën e pasluftës së dytë botërore, për të vazhduar edhe në kohën e komunizmit dhe pas rënies së komunizmit, deri në vitin 1999, kur në sajë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ndihmës së shteteve që bëjnë pjesë në NATO, me në krye Amerikën, u arrit që Serbia të dëbohej përfundimisht nga Kosova. Kjo gjë duhet kuptuar drejt. Nuk qe Kosova që u shkëput nga Serbia, por qe Serbia që u dëbua nga Kosova. Më 17 shkurt, Kosova shpalli pavarësinë. U realizua ëndrra e kamotshme e shqiptarëve të Kosovës: Kosova Republikë. Çka më tutje? Shtrohet pyetja: Me shtetësinë e Kosovës, u krijuan

kushtet edhe për lindjen e një kombi të ri në botë? Unë them jo. Jo, ngase, kombet që jetojnë në Kosovë ekzistojnë që nga lindja e tyre, aty nga shekulli i nëntëmbëdhjetë. Pastaj, ne si pjesëtarë të kombit shqiptar nuk kërkojmë një gjë të tillë. Jo vetëm që nuk kërkojmë, por nuk duam të ndahemi nga trangu i përbashkët, si dhe nga historia, kultura, tradita e gjuha shqiptare. Nuk duam të ndajmë thesarin historik të mbushur me plot luftëtarë e shkrimtarë. Nuk duam të ndajmë as letërsinë. Nuk duam të ndajmë ngjarjet tragjike që na ndoqën me shekuj. Kujtoj që këto elemente na kanë mbajtur gjallë gjithnjë. Çdo tentim për nxjerrjen e një kombi të ri do të ishte artificiale dhe nuk do të funksiononte në shoqërinë e Botës së tretë. Të marrim shembullin e Jugosllavisë. Në atë shtet të krijuar nga



# htë kombi

tetë njësi territoriale e shumë kombe (atëherë kishte edhe kombësi) assesi nuk u arrit qëllimi i shumëpritur nga komunistët e atëherëshëm që shtetasit e Jugosllavisë të njiheshin njëkohësisht edhe si komb jugosllav. Nuk mund të qëndronte një tendencë e tillë ngase në Jugosllavi nuk jetonin vetëm sllavët e jugut. Aty jetonin shqiptarët, hungarezët, rumunët, bullgarët, turqit etj. Bile edhe brenda sllavëve të jugut kishte kombe si: slovenët, serbët, kroatët, etj. Ky shtet ishte një shtet multi-kulturor dhe multi-gjuhësor. Kosova, edhe pse e emërtuar si shtet multietnik, dallon nga përbërja e popullsisë së Jugosllavisë së atëherëshme. Derisa në Jugosllavi jetonin një përqindje e përafërt e kombeve dhe kombësive të ndryshme, në Kosovë jetojnë mbi 90% shqiptarë. Pjesa tjetër është e përbërë nga serbët, boshnjakët, turqit, ashkalinjtë, romët etj. Nisur nga fakti që përkatësia etnike kombëtare vjen si rrjedhojë e vetëdijes së përbashkët e prejardhjes dhe e traditave të përbashkëta, kujtoj që edhe po të mbështetej krijimi i kombit kosovar (që së besoj), ky komb do të ishte jetëshkurtër. Jo që ne (shqiptarët e Kosovës) nuk ishim të gatshëm të themelonim shtetin tonë, përkundrazi, unë kujtoj që ishin pjekur të gjitha kushtet për pavarësimin e vendit, por kjo nuk do të thotë që jemi të gatshëm të ndërrojmë edhe përkatësinë etnike kombëtare e me të, të harrojmë kulturën, traditat, historinë dhe gjuhën shqipe. Tek e fundit, lindja e një shteti të ri në botë nuk do të nënkupton domosdoshmërisht edhe lindjen e kombit të ri, nëse ai ekziston me shekuj!



## Gjithnjë kam pasur identitet

Dafina Buginea

**U**bënë ca muaj që në mediat tona qarkullon reklama "TASH KAM IDENTITET". Kjo reklamë transmetohet pothuajse çdo pesë minuta. Ata që përgatitën këtë "gjellë", të cilën po ia servojnë popullit që si duket po e gëlltit mirë, po mundohen që t'ia shpëlajnë trurin popullit duke e bërë atë të besojë se identiteti i tij u formua më 17 shkurt. Nëse është kështu, atëherë shtrohet pyetja se çka ishim ne (shqiptarët e Kosovës) para 17 shkurtit? Ishim pa identitet? Për të gjithë ata që e pranuan këtë slogan, po. Por për shqiptarët e vërtetë, jo. Nëse i kthehemi të kaluarës sonë të lavdishme do të shohim se për autoktoninë dhe lashtësinë e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe flet shkencë e historisë dhe disiplinat e tjera shkencore, të cilat kanë dhënë shumë dëshmi e fakte. Rrënjët e popullit shqiptar i gjejmë herët në histori, edhe pse gjuha shqipe ka filluar të shkruhet më vonë (1908), me formimin e alfabetit unik për shkrimin e gjuhës shqipe.

Rilindësit, ndër të tjera, kishin edhe këtë qëllim: t'i tregonin botës se shqiptarët nuk ishin as grekë, as turq, as sllavë, as latinë, siç i paraqitnin armiqtë e shqiptarëve, por se ishin një komb i veçantë me tradita, doke, kulturë, histori të begatshme dhe me gjuhën e tyre të veçantë. Në këtë rrugë të gjatë të rilindësve, bashkudhëtarë ishin edhe shumë shqiptarë të Kosovës, të cilët dhanë kontributin e tyre të pazëvendësueshëm për gjuhën dhe alfabetin shqip. Ndërsa tani na del se puna e tyre ndër shekuj ishte e kotë, se gjuha letrare shqipe (1972) nuk është gjuha jonë, se ne jemi gegë dhe se gjuha jonë duhet të dallojë nga ajo e shtetit fqinj, në këtë rast Shqipërisë. Në emisionin "Përrallë me tupan", humoristi Sevdai Radogoshi, i cili ishte mysafir, tha: "I bëj apel popullit të Kosovës që mos ta flasë gjuhën standarde shqipe se nuk është e jona. Kush e flet një gjuhë të tillë është budalla. Na jena gegë dhe kemi gjuhën tonë".

Njerëzit e tillë, të cilët ndjejnë ende nostalgji për "vëlazërim-bashkim"-in, janë armiqtë e kombit tonë. Atyre iu vjen më ëmbël kur flasin shumicën e fjalëve serbe. Ajo iu duket gjuha e tyre. Një i tillë si ky, tash ka identitet. Një i tillë si ky ka edhe kushtetutë, ku dominon pakica serbe në vend të shumicës shqiptare. Një i tillë si ky pranon edhe gjashtëpikëshin dhe ndarjen territoriale të Kosovës. Një i tillë si ky mohon vlerat e luftës dhe të UÇK-së, gjakun e derdhur për liri, mohon historinë e lavdishme duke lejuar që historinë t'ia shkruajnë të tjerët. Një i tillë si ky ka lindur më 17 shkurt, ndërsa shqiptarët e vërtetë kanë ekzistuar dhe do të ekzistojnë ndër shekuj.

(Autorja është studente e gazetarisë në UP)

Lufta kundër korrupsionit, sfidë për shtetin e Kosovës



Sabri HALILI

**N**ë konkluzionet e mbledhjes së fundit të BE-së për Kosovën, të mbajtur më 8.12.2008, ndër të tjera, pasi përmenden disa përparime, theksohet se mbesin edhe shumë sfida për Kosovën, ku decidivisht përmendet, "forcimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit". Madje edhe organizatat joqeveritare i kanë shpallur institucionet aktuale, sikurse edhe ato më herët, "kampion të korrupsionit".

Këto janë fenomenet të cilat, tash një kohë të gjatë, i përcjellin institucionet e vendit. Secila garniturë udhëheqëse ka shpallur "zero tolerancë" për këto dukuri, por deri më tash, pos fjalëve të mëdha, asgjë nuk po ndryshon në këto rrjedha. Edhe vetë udhëheqësit e institucioneve e diagnostifikuan këtë dukuri kaq të shëmtuar si "dukuri kancerogjene", por asnjëri prej tyre nuk gjeti ilaç për këtë sëmundje, apo nuk dëshoi të gjejë. Madje ajo, dita ditës, po zgjeron metastazat në të gjitha porët e shoqërisë. Për Kosovën, këto dukuri janë me rrezikshmëri të dyfishtë edhe për shkakun se jemi në fazën e ndërtimit të shtetit.

### Mungon vullneti për luftimin e të keqes

Shumë fjalë të mëdha për luftimin e korrupsionit, të nepotizmit, trafikimit dhe të drogës nga institucionet shtetërore.

Është e qartë se askush, në asnjë vend të botës, nuk e ka luftuar me fjalë korrupsionin, trafikimin, drogën, gjegjësisht krimin e organizuar. Udhëheqësit institucionalë këtë "luftë" e kanë bërë, për më tepër, nëpër forumet e ndryshme lidhur me këto fenomene, aty ku pjesëmarrës janë edhe struktura të ndryshme ndërkombëtare, por edhe në përgjigjet e imponuara në konferencat e ndryshme për gazetarë.

Udhëheqësit tanë e dinë mirë se ku është filli dhe ku është mbarimi i fenomeneve. Të gjitha opsionet për zgjidhjen

# "Sëmundja kancer"

**A ka angazhim të sigurtë të institucioneve shtetërore për përmirësimin e gjendjes që aktualisht mbretëron në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, për dukuritë "kancerogjene" siç janë korrupsioni, nepotizmi, trafikimi... në Kosovë? Kjo është pyetja e cila rëndon dyshimet reale të opinionit profesionist dhe opinionit më të gjerë**



e këtij problemi janë në duart e tyre. E në këtë rast, ka munguar vetëm vullneti politik dhe guximi shtetëror e qytetar për luftën e vërtetë të këtyre dukurive, edhe pse përsërisin vazhdimisht refrenin, tashmë të bërë bajat, se këto "janë dukuri kancerogjene për shoqërinë dhe shtetin e Kosovës". Nga kush presin që të fillojë lufta kundër këtyre dukurive? Nga populli, nga ndërkombëtarët apo ndonjë force tjetër?! Kjo është e çuditshme! Ata që i njohin mirë fillet e këtyre sëmundjeve, nuk besojnë se pushteti aktual është duke bërë gjë për përmirësimin e gjendjes ekzistuese. Arsytet janë të shumta dhe janë për hetime të organeve shtetërore kompetente. Askush nuk mund ta kuptojë dhe ta arsyetojë një pushtet i cili e di se ka krim të organizuar, ka korrupsion, trafikim..., edhe pse i ka të gjitha mekanizmat shtetëror e gjyqësor në kompetencë të vetën, e të mos bëjë asgjë për ndryshimin pozitiv të gjendjes. Pra, në këtë rast, më shumë se fjalët e mëdha na duhen vepra, qoftë edhe të vogla, por që duhen të jenë shpresëdhënëse se diçka po lëviz në aspektin pozitiv. Në këtë drejtim, nuk duhet të ketë vështirësi nëse ka vull-

net e dëshirë për ndryshime të duhura, sepse janë në pyetje vetëm mjetet financiare e në këtë drejtim nuk po mungojnë për lukse e privilegje të pushtetarëve.

Mu për këtë shtrohet një pyetje tjetër e arsyeshme: nëse vërtet janë të interesuar institucionet dhe udhëheqësit aktual që të bëjnë ndryshime në këtë drejtim?!

### Atje ku mund të nisë filli i luftës kundër dukurive "kancerogjene"

Thuhet se pushteti gjyqësor dhe prokurorial, si dhe policia, duhet dhe munden ta luftojnë këtë fenomen. Megjithatë, edhe në këtë sistem, kemi një gjendje të rëndë sa i përket këtyre dukurive. Lëndë të grumbulluara, mungesë gjyqtarësh e prokurorësh, paga të mjera dhe poshtëruese, varësi nga pushtetet e tjera legislative e ekzekutive, shantazhe, kërcënime, mungesë e infrastrukturës, mungesë e sigurisë fizike të gjyqtarëve e prokurorëve, pozita tejet e mjerueshme edhe e policisë..., e çka jo. Kjo gjendje në gjyqësor dhe në polici është e njohur për të gjithë pushtetarët, por ata nuk ndërmarrin masa urgjente për zgjidhjen e një pjese

# ogjene” zgjeron metastazat

të këtyre problemeve nga lista e gjatë e tyre. Nga kjo gjendje fitohet përshtypja se ata që e udhëheqin shtetin nuk dëshirojnë të ndajnë më shumë para për drejtësi, për sundimin e ligjit, për polici, sepse në këtë mënyrë do të shkatërrohen rrjetat e tyre të krimit dhe organizimit mafioz, prej nga e kanë burimin kryesor të pasurimit. Si mund të të bindin udhëheqësit institucionalë se po bëjnë veprime serioze për luftimin e kësaj dukurie, kur burimi i të gjitha aferave korruptive me të ashtuquajturën dukuri tenderike, apo me tenderomaninë, janë pikërisht institucionet ku ata punojnë dhe ndërmarrjet publike të cilat ata vetë i menaxhojnë?

Si mund të të bindë dikush nga këto institucione se po e lufton krimin e organizuar, kur tash 8 vjet e kanë lënë gjyqësorin, gjyqtarët dhe prokurorët si dhe policinë në gjendje të mjerueshme financiare e të sigurisë, madje edhe nënçmuese e fyese. Kush është ai njeri normal që të besojë në moralin e lartë të një njeriu i cili ka familje, ka nevoja e shpenzime marramendëse di-

to, ndërkohë që paguhet me një pagë aq të ultë dhe trajtohet nga institucionet në këtë mënyrë? Si mund të kërkojnë udhëheqësit shtetërorë nga gjyqtari, prokurori, nga polici të përballet me krimin e organizuar, me trafikimin, gjegjësisht me kriminelët, të cilët i udhëheqin këto krime, pa para, pa sigurim fizik, pa mbrojtje adekuate për ta dhe familjet e tyre, derisa ata vetë janë akomoduar bukur mirë me privilegje, me punë të mira, me paga të majme, për vete dhe për familjet e tyre?

Derisa nuk fillon të ndryshojë qasja e këtyre institucioneve në drejtim të zgjidhjes së këtyre problemeve në gjyqësor dhe në polici, duke bërë reforma rrënjësore në çdo aspekt, nuk ka luftë kundër këtyre dukurive. Megjithatë, udhëheqësit institucionalë do të vazhdojnë të shesin fjalë “të mëdha”, por vetëm për ata që konsumojnë gjëra të tilla. Megjithatë, kjo nuk do të zgjasë në pafundësi. Kurdoherë, dikush do të kuptojë se nga fjalët e tilla nuk është bërë asgjë në vepër.

Kjo dyfaqësi në fjalë e veprime, e

njerëzve që kanë obligim të luftojnë dukuritë negative në shoqëri, e të sigurojnë mirëqenie për të gjithë qytetarët e Kosovës, të bën të dyshosh për gjithçka. Këto dyshime çojnë në humbjen e besueshmërisë ndaj gjyqësorit dhe ndaj drejtësisë në përgjithësi, e mos të flasim për ata që na udhëheqin.

Edhe pse të gjitha këto dukuri negative shikohen dhe përjetohen për ditë, edhe nga qytetarët edhe nga institucionet, deri tashti në rrjetin e luftuesve të krimit vazhdojnë të mbesin ende vetëm “peshqit” e vegjël, ndërsa ata më të mëdhenjtë gjejnë hapësira për të dalë jashtë rrjetit. Ky është fenomen shumë i kundërt me ligjet natyrore.

Për më tepër, kjo ndodh për shkak të koordinimit shumë të mirë të mafive që janë të pranishme në hapësirat kosovare dhe që veprojnë vetëm në dëm të Kosovës dhe popullit të saj. Pa një ndihmë dhe mbështetje institucionale dhe sistemore, kjo nuk do të mund të zgjaste në pakufi, siç po zgjat në Kosovë.

## Për një qasje më ndryshe ndaj sistemit arsimor

**D**ikur, gjëja më e rëndësishme ka qenë të diplomojë dhe për punë nuk ishte shumë problem. Mirëpo, më kalimin e kohës gjërat ndryshuan, rrënjësisht. Sot, si për ironi, problemi më i madh është se si të gjejmë punë se sa për diplomim nuk është edhe aq vështirë.

Shumë të diplomuar bredhin rrugëve pa pasur mundësinë që ta gjejnë një vend pune. Shpresa se pas pavarësisht të Kosovës do të ndryshojnë gjërat për të mirë, duket se edhe për një kohë do të ngelet vetëm shpresë. Kosova jonë e dashur është zhytur thellësisht në moçalin e korrupsionit, varfërisë, papunësisë dhe gjërave të tjera të shëmtuara, që i bëjnë asaj shumë dëm në rrugën drejt prosperitetit dhe integriteteve euroatlantike.

### Me rritjen e numrit të studentëve nuk zgjidhet problemi i papunësisë

Vlerësoj se Qeveria e Kosovës ka qasje të gabuar ndaj sistemit arsimor.

Mendoj se më e dobishme do të ishte të investohet në hapjen e shkollave profesionale të zanatit. Jam i bindur se shumë studentë, që sot janë pjesë e Universitetit të Prishtinës, do të orientoheshin në zanate të ndryshme dhe jo të bënin presion për stërngarkimin e UP-së me studentë, ku janë numër e jo emër. Sigurisht, se me pranimin e numrit të madh të studentëve nuk zgjidhet problemi i papunësisë, por vetëm se e rëndon atë.

Komisioni për përpilimin e testeve për provim pranues jo rrallë është dashur ta ulë kriterin e dijes për të arritur numrin e kërkuar. Pjesë e fajit mendoj që janë edhe politikat e UP-së për shkak të kriterit të dobët që kanë në vlerësim dhe kalimin e studentëve të dobët në provime. Me këtë rast bëhet një konkurrencë jokorrekte ku i miri dhe i dobëti nuk kanë dallim, sepse që të dy posedojnë diplomë, kurse mënyra për të ardhur deri te diploma është e lehtë.

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet t'i qaset seriozisht dhe me vullnet të madh këtij problemi, të bëjë një balancim në mes kërkesave për mësimdhënës dhe pranimin të studentëve, sepse çka duhen dhjetëra të diplomuar të drejtimeve të ndryshme të sillen me diplomë në xhep, kurse të tillë tashmë ka me bollëk. Institucionet tona duhet ta kuptojnë se universiteti nuk është ushtri ku çdo pjesëtarë i shoqërisë duhet ta kryej atë. Ato duhet të përpilojnë programe për adresimin e drejtë të të rinjve, dhe jo ta stërngarkojnë Universitetin.

Ndërsa, Universiteti i Prishtinës duhet ta ngrejë kriterin e vlerësimit në përgjithësi, të bëjë filtrimin e studentëve, në mënyrë që të punojë më tepër me ata që e meritojnë, t'i stimulojë dhe t'i përkrähë, që në të ardhmen të dalin ekonomistë, gjuhëtarë, inxhinierë e teknologë të suksesshëm, të cilët me lehtësi do të punësoheshin dhe do të kontribuonin për shtetin tonë të ri.

Abdurrahim Maxhuni

Nga jeta studentore në Prishtinë

# Zgjohet e bie me shpresën për një ditë më të mirë



Fatos SHALA

**A**larmi i telefonit e zgjon Nehar Selimin nga gjumi në orën 6:45. Duhet të bëhet gati për të shkuar në ligjëratat që fillojnë në orën shtatë e gjysmë. Nehari, një biond mesatarisht i gjatë, nga Prizreni, është student i vitit të parë në Universitetin e Prishtinës, banues në konviktin numër një në Qendrën e Studentëve.

Në dollapin e tij të ngushtë, merr pastën e dhëmbëve, por me kot sepse nuk kishte asnjë pikë uji... Vesh rrobat që i janë stër-rrudhur në dollap dhe nisjet për në Fakultetin Teknik...

## Profesori e nxjerr nga ora për shkak të librit

Mësimi fillon me disa minuta vonesë, por jo edhe për personazhin e këtij shkrimi. Atë, së bashku me disa kolegë studentë, i largon profesori nga ligjëratat me arsyetim se nuk e kanë blerë librin, autor i së cilit është vetë profesori. Në fakt, Nehari ishte nisur për ta blerë librin dy ditë më herët, por kishte hequr dorë pasi mësoi se libri kushton hiç më pak se 15 euro.

“Nuk po mund t’i blej të gjitha librat njëkohësisht. Secila po kushton gati 15 euro. Po kam edhe shpenzime të tjera, pagesa e konviktit, mensës etj.” - shprehet Nehari, duke treguar se për shkak të shpenzimeve, vetëm një herë në muaj udhëton për në Prizren, nga se bileta e autobusit për një drejtim në linjën Prishtinë-Prizren, kushton 4 euro...

...Si i ri e i paprovuar më jetën studentore, Nehari nuk di si të silltet në këtë situatë. Merr fletoret e tij dhe vepron sipas kërkesës së profesorit. Largohet kokulur nga salla.

## Pritjet e gjata në bibliotekë dhe mensë

Për ta kompensuar në një formë ligjëratën, Nehari ia mësyn Bibliotekës Kombëtare. Radha e gjatë e studentëve dhe procedurat e lejes për të hyrë në bibliotekë, ia marrin atij edhe nja tri orë tjera. Megjithatë, as këtu nuk i del siç kishte menduar. Zhurma e madhe në Bibliotekë dhe lodhja e tij duke pritur në këmbë për të zënë një vend, nuk ia mundësojnë që të koncentrohet në lexim.

“Studentët po bëjnë zhurmë këtu në bibliotekë. Ata po lëvizin poshtë e lart nëpër salla të bibliotekës, duke bërë që ta humbasin koncentrimin” - shprehet Nehari, duke fajësuar për këtë edhe punëtorët e bibliotekës, të cilët nuk po kujdesen për mbajtjen e rendit...

Pasi ka bërë nja dy orë lexim “për gazep”, Neharit i vjen koha për t’u ushqyer në mensë. Edhe këtu i duhet të presë në rend gati një orë e gjysmë. Ai tashmë është mësuar të presë në radhë dhe nuk e shqetëson edhe aq pritja, por nuk është i kënaqur me ambientin në mensë.

“Është papastërti dhe rrallë ka ujë, ndërsa menyja pothuajse është gjithmonë e njëjtë” - shprehet Nehari, i cili për t’u ushqyer nga dy herë në ditë në mensë, paguan 30 euro në muaj. 40 euro të tjera ai i paguan për vendosje në konvikt.

Para së të vinte për studime kishte dëgjuar se çmimet do të jenë më të lira së kaq. Ministria kishte premtuar për lirim të pagesës në ushqim dhe në banim në Qendrën e Studentëve, por një gjë e tillë deri më sot nuk kishte ndodhur.

## Lutje dhe shpresë për një ditë më të mirë

Ha me nxitim sepse i duhet të arrijë në konvikt në orën 18, që të zërë rendin për të bërë banjë, sepse vetëm në atë kohë ka ujë të nxehtë në konvikt. Ky orar i ujit zgjat deri në orën 19. Brenda kësaj ore, i bie që të pastrohen 60 studentë në dy banja, sepse në secilin kat të konviktit janë nga dy banja.

“Shpesh na ndodh që të mbetemi pa u pastruar sepse harxhohet uji. Besa nganjëherë më ujë të ftoftë lahem si s’kemi zgjidhje tjetër” - shprehet ai. Pasi ka bërë një dush prej pesë minutash, Nehari kthehet në dhomë. Meqë nuk kishte mundur të lexonte si duhet në bibliotekë, provon që këtë ta kompensojë në dhomën e konviktit. Por as këtu fati nuk është në anën e tij. Rryma ndalet... Është ora 22 dhe Nehari bëhet gati për gjumë. Si zakonisht, kurdis alarmin e telefonit që ta zgjojë të nesërmen në orën 6 e 45 minuta. Shtrihet në krevat duke u lutur dhe shpresuar për një të nesërme më të mirë.



Reduktohet numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale

# Serbët më të privilegjuarit

**Struktura nacionale e familjeve që shfrytëzojnë ndihmën sociale në Kosovë, për muajin shtator 2008, shprehur në përqindje, paraqitet si në vijim: shqiptarë 78.6 për qind, serbë 12.5 për qind, malazezë 0.03 për qind, myslimanë 1.84 për qind, turq 0.30 për qind, ashkalinj 3.64 për qind, romë 2.27 për qind, të padeklaruar 0.33 për qind dhe të tjerë 0.34 për qind**



**Hekuran AVDYLI**

**N**ga një raport i Zyrës për Komunikim me publikun e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, del se numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale ka rënë për 9.85 për qind nga numri i përgjithshëm i familjeve nën asistencë sociale, në periudhën janar-tetor 2008.

Të gjithë qytetarët apo familjet e varfra të Kosovës, që i kanë plotësuar kriteret e Skemës së Ndihmave Sociale, e kanë shfrytëzuar dhe vazhdojnë ta shfrytëzojnë këtë ndihmë në bazë të ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale.

Struktura nacionale e familjeve që shfrytëzojnë ndihmën sociale në Kosovë, për muajin shtator 2008, shprehur në përqindje, paraqitet si në vijim: shqiptarë 78.6 për qind, serbë 12.5 për qind, malazezë 0.03 për qind, myslimanë 1.84 për qind, turq 0.30 për qind, ashkalinj 3.64 për qind, romë 2.27 për qind, të padeklaruar 0.33 për qind dhe të tjerë 0.34 për qind.

Bazuar në përbërjen e popullsisë sipas përqindjes, del se minoriteti serb është përfituesi më i madh i këtyre ndihmave.

## Dy milionë euro për ndihma sociale në periudhën janar-tetor 2008

Në periudhën janar-tetor 2008, numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale ka rënë për 3, 685 familje apo për 9.85 për qind, numri i anëtarëve të familjeve nën asistencë sociale ka rënë në 9.6 për qind dhe shuma e mjeteve financiare është zvogëluar për 231 mijë e 720 euro ose për 10.1 për qind më pak në krahasim me vitet e kaluara.

Shuma e përgjithshme monetare, e cila është shfrytëzuar për ndihma sociale në periudhën janar-tetor 2008, arrin shifrën në afër 2 milion euro.

Angazhimi i shtuar i tërë stafit të Divizionit të Ndihmave Sociale dhe sektorëve të tjerë kanë ndikuar dukshëm në disiplinimin e Skemës së ndihmave, gjë e cila mund të vërehet përmes zvogëlimit gradual të numrit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret për këtë ndihmë.

Sa i përket plotësimit të kriterëve, ndryshimet e Projektligjit të Skemës së ndihmave sociale do të futen në agjendën e ndryshimeve ligjore për vitin 2009.



Në bazë të nenit 12, pika 12.1 të Ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, për rregullimin e procedurave të përkrahjes financiare familjeve dhe individëve në raste të jashtëzakonshme, për periudhën raportuese janar-nëntor 2008, komisionit përkatës i janë drejtuar 289 familje me kërkesë për ndihmë të menjëhershme, prej tyre 250 janë aprovuar, ndërsa 39 kërkesa janë refuzuar.

Sektori i Kontrollit dhe Mbikëqyrjes, i cili ka për detyrë të kontrollojë dhe të mbikëqyrë mënyrën e implementimit të Ligjit mbi Skemën e Ndihmës Sociale, ka bërë verifikimin dhe riverifikimin e familjeve në asistencë sociale. Nga gjithsej 959 familje të verifikuara, 96.7 për qind janë familje të përzgjedhura, ndërsa 3.1

për qind janë familje të papërzgjedhura. Pas riverifikimit, ky sektor ka konstatuar se të gjitha familjet e papërzgjedhura janë larguar nga regjistri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale.

## Vazhdon programi për shlyerjen e borxheve të energjisë elektrike për një kategori shfrytëzuesish

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale edhe këtë vit, si dhe vitin e kaluar, ka lidhur Marrëveshjen e Mirëkuptimit me Menaxhmentin Ekonomik Financiar (MEF) dhe me Korporatën Energetike të Kosovës (KEK), për vazhdimin e programit për shlyerjen e borxheve të energjisë elektrike për shfrytëzuesit e Skemës së Ndihmave Sociale të sektorit të Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të luftës. Me këtë marrëveshje parashihet që çdo familje që përfiton nga skemat e sipërpërmendura t'i shlyhen borxhet e energjisë elektrike në lartësi deri 20 euro në muaj.

Aktualisht MPMS dhe KEK-u janë duke i shkëmbyer bazat e të dhënave dhe gjatë muajit janar-dhjetor 2008 parashihet që të bëhet shlyerja e borxheve të energjisë elektrike për shfrytëzuesit e skemave të lartpërmendura.

Struktura nacionale e familjeve që shfrytëzojnë ndihmën sociale në Kosovë, për muajin shtator 2008, shprehur në përqindje, paraqitet si në vijim: shqiptarë 78.6 për qind, serbë 12.5 për qind, malazezë 0.03 për qind, myslimanë 1.84 për qind, turq 0.30 për qind, ashkalinj 3.64 për qind, romë 2.27 për qind, të padeklaruar 0.33 për qind dhe të tjerë 0.34 për qind.

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

# Asnjë njohje në m

Demir RESHITI

**N**ëntori është muaji i dytë (pas korrikut) kur nuk është shënuar asnjë njohje e pavarësisë së Kosovës!

Megjithatë, gjatë këtij muaji, Kosova ka qenë mjaft e pranishme në agjendat e mekanizmave më të rëndësishëm politikë ndërkombëtarë. Një plan gjashtëpikësh i hartuar nga sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Moon, i cili ka përfillur kërkesat e Beogradit si kusht për pranimin e shtrirjes së EULEX-it në Kosovë, ka hasur në kundërshtimin e institucioneve të Kosovës si dhe shoqërisë civile. Mirëpo ky kundërshtim nuk ka mjaftuar që ta bindë Këshillin e Sigurimit të OKB-së, i cili ka vendosur për shtrirjen e misionit të BE-së në Kosovë nën ombrellën e OKB-së, me qasje neutrale ndaj statusit të Kosovës.

Për Kosovën ka diskutuar edhe Asambleja parlamentare e NATO-s, e cila ka kërkuar nga vendet anëtare të Aleancës që të mbeten të angazhuara për sigurimin e paqes në Kosovë.

Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit nëntor 2008.

## (4 nëntor) Mesiç: Vendimi i GJND për Kosovën vetëm këshilldhënës

**Izmir** - Presidenti i Kroacisë, Stipe Mesiç, ka thënë se çfarëdo vendimi, që merr Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë mbi ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës, do jetë vetëm këshilldhënës. Ai i ka bërë këto komente pas takimit të përbashkët me kryetarin malazias, Filip Vujanoviç, atë të Bosnjës, Haris Silajxhiq dhe me ish presidentin turk, Sulejman Demirel, në Izmir të Turqisë, ku është biseduar për situatën në Bosnjë, Serbi dhe Kosovë.

## (5 nëntor) Doris Pack: Serbia nuk guxon të pengojë BE-në në Kosovë

**Berlin** - "Serbisë nuk guxon t'i lejohehet që të pengojë BE-në në punën me popullsinë e Kosovës" - ka deklaruar kryetarja e delegacionit të Parlamentit



Doris Pack

Evropian për Evropën Juglindore, Doris Pack. "Ne kemi ndërmend që me EULEX-in të punojmë në interes të të gjithë njerëzve që jetojnë atje, në radhë të parë të serbëve që jetojnë atje, e kjo është zbatimi në vepër i planit të Ahtisarit dhe të asaj që është në Kushtetutën e Kosovës" - ka thënë Doris Pack për radion DW.

**Bruksel** - Përfaqësuesi i lartë i BE-së, Javier Solana, ka deklaruar se për misionin e EULEX-it po zhvillohet "një dialog shumë intensiv" me Beogradin dhe se shpreson që ky mision i BE-së do të shtrihet në tërë Kosovën në muajin dhjetor.

**Prishtinë** - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jap de Hop Schefer, gjatë qëndrimit në Prishtinë, ka thënë se roli i NATO-s në Kosovë nuk do të ketë ndryshime. Ai ka premtuar ndihmën e NATO-s në krijimin e FSK-së.

## (6 nëntor) Lagendijk: BE të kushtëzojë Serbinë me pranimin e misionit të EULEX-it

**Bruksel** - Raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Joost Lagendijk ka kërkuar nga Bashkimi Evropian që ta kushtëzojë afrimin e mëtejshëm të Serbisë me BE-në, me pranimin e misionit të EULEX-it.

"Beogradi edhe më tutje po e pengon shtrirjen e EULEX-it në veri të Kosovës. BE nuk guxon t'i lejojë Serbisë të bëjë hapa të mëtejme drejt anëtarësimit derisa e pengon këtë mision" - ka thënë Lagendijk, pas publikimit të raportit të Komisionit Evropian për Ballkanin.

## (7 nëntor) Mirel: BE ka pranuar kushtet e Beogradit për shtrirjen e EULEX-it në Kosovë

**Beograd** - "BE ka pranuar që shtrirja e EULEX-it duhet të pranohet në Këshillin e Sigurimit të KB, që sa i përket statusit të jetë neutral dhe që të mos ketë lidhje me planin e Marti Ahtisarit" - ka deklaruar drejtori për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerimin të BE-së, Pjer Mirel. Ai ka thënë para gazetarëve, në Beograd, se Bashkimi Evropian ka pranuar kushtet e Beogradit për shtrirjen e EULEX-it në Kosovë.

## (12 nëntor) Ban Ki-Moon: Prishtina të pranojë planin e OKB-së



Ban Ki-Moon

**Nju Jork** - Kreu i OKB-së, Ban Ki-Moon u ka bërë thirrje liderëve të Kosovës që të rishqyrtojnë refuzimin e bërë dhe të miratojnë planin e Kombeve të Bashkuara për vendosjen e misionit EULEX në Kosovë.

"Unë shpresoj se Qeveria e Prishtinës do t'i shqyrtojë pozitivisht propozimet e mia dhe këtë proces të bisedimeve për të ardhmen e vendit të tyre" - ka thënë Ki-Moon para gazetarëve, në selinë e OKB-së në Nju Jork.


## (17 nëntor) Frid: EULEX-i duhet të vendoset në Kosovë me pëlqimin e Prishtinës

**Prishtinë** - "Kosova është vend i pavarur dhe sovran dhe askush nuk duhet të mendojë të kundërtën. Qeveria e Kosovës është qeveri sovraane, ajo dëgjon mendimet e të tjerëve, por vendimet i

# nuajin nëntor

merr vetë dhe ne duhet t'i respektojmë ato" - ka thënë nënsekretari amerikan i shtetit për çështje politike, Daniel Frid, pas takimit me liderët e institucioneve të Kosovës. Ai tha se EULEX-i duhet të vendoset sa më shpejt në Kosovë dhe për këtë duhet të merret parasysh qëndrimi i qeverisë në Prishtinë.

**(18 nëntor) NATO-ja e angazhuar**



**për sigurinë në Kosovë**

**Valencia** - Asambleja parlamentare e NATO-s, që po zhvillon punimet në Valencia të Spanjës, ka kërkuar nga vendet anëtare të Aleancës që të mbeten të angazhuara për sigurimin e paqes në Kosovë.

**(21 nëntor) GMNK: EULEX-i të veprojë në përputhje me kushtetutën e Kosovës**

**Bruksel**-Grupi Mbikëqyrës Ndërkombëtar për Kosovën (GMNK), në mbledhjen e mbajtur në Bruksel, ka ripohuar përkushtimin ndaj respektimit të plotë të sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës. GMNK ka thënë se mirëpret vendosjen e planifikuar të misionit të BE-së në mbarë territorin e Kosovës dhe mbështet synimin që EULEX-i të veprojë në përputhje me kornizën institucionale dhe juridike që është në fuqi në Kosovë, që nga 15 qershor 2008.

**(22 nëntor) Solana: EULEX-i vendoset në fillim të dhjetorit**

**Nju Jork** - "Shpresoj shumë që raporti i sekretarit të përgjithshëm do të publikohet, sa më shpejt aq më mirë,



**Havier Solana**

dhe shpresoj që kjo të ndodh në fillim të javës së ardhshme" - ka thënë Shefi për politikë të jashtme i Bashkimit Evropian, Javier Solana, pas takimit me Ban Ki-Moon-in në Kombet e Bashkuara. "Nëse do të jetë kështu, atëherë ne do të jemi të gatshëm për vendosje në fillim të dhjetorit" - citon Solanën agjencia Reuters.

**(22 nëntor) Berisha: Përpjekjet për ndarje të Kosovës - të rrezikshme**

**Shkup** - Kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, ka thënë në Shkup se projektet që krijojnë përshtypjen për një ndarje në pjesën veriore të Kosovës, përbëjnë një rrezikshmëri të madhe për paqen dhe stabilitetin.

**(24 nëntor) Solana: EULEX-i në Kosovë, mundësisht më 2 dhjetor**

**Bruksel** - "Shpresoj që vendosja e EULEX-it të fillojë sa më shpejt në fillim të dhjetorit, mundësisht më 2 dhjetor" - ka thënë shefi i diplomacisë evropiane, Javier Solana, gjatë një konference të përbashkët për shtyp me kreun e NATO-s, Jap de Hop Scheffer. Solana ka theksuar se EULEX-i "do të vendoset në tërë territorin e Kosovës sipas planit të veprimit, miratuar kohë më parë nga Bashkimi Evropian".

**(26 nëntor) OKB: EULEX-i në Kosovë nën ombrellën e OKB-së neutral ndaj statusit**

**Nju Jork** - Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka vendosur për shtrirjen e misionit të BE-së në Kosovë nën ombrellën e

OKB-së.

Në raportin e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki-Moon, thuhet se EULEX-i do të punojë në mënyrë neutrale ndaj statusit të Kosovës.

Këshilli i Sigurimit ka miratuar një deklaratë presidenciale, të cilën e kanë përkrahur të 15 anëtarët, duke mirëpritur synimet e Serbisë dhe të Kosovës për të bashkëpunuar me këtë mision. "Këshilli i Sigurimit merr parasysh raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të 24 nëntorit, duke marrë parasysh edhe qëndrimet e Beogradit dhe Prishtinës, të cilat edhe janë reflektuar në deklaratat e tyre, ndërsa mirëpret synimet e tyre që të bashkëpunojnë me bashkësinë ndërkombëtare" - thuhet në deklaratë.

**(27 nëntor) Erdoan: Turqia do të bëjë përpjekje maksimale tek vendet mike që ta njohin pavarësinë e Kosovës**

**Tiranë** - Kryeministri turk, Erdoan, në një takim me presidentin e Shqipërisë Bamir Topi, ka deklaruar se Turqia do të vazhdojë përpjekjet e saj maksimale për të ndikuar tek vendet mike për rritjen e numrit shteteve të tjera që do ta njohin pavarësinë e Kosovës.

**(28 nëntor) Kermabon: EULEX-i do t'i raportojë BE-së dhe OKB-së**

**Prishtinë** - Shefi i EULEX-it Iv de Kermabon, ka deklaruar se EULEX-i do t'i raportojë BE-së, por edhe OKB-së, pasi është duke punuar nën Rezolutën 1244. Kermabon ka thënë se EULEX-i është i gatshëm të nisë punën në fushat e policisë, gjykatave dhe doganave, duke shtuar se mbi 2 mijë policë, prokurorë, gjykatës dhe doganierë ndërkombëtarë pritet të fillojnë punën nga 2 dhjetori.



**Iv de Kermabon**

Histori Islame (25)

# Ebu Bekri Kalif

Kjo është fantastike. Pa asnjë dyshim se ato i ngjasojnë zgjedhjeve të lira, edhe pse atë ditë nuk doli asnjë kundërkandidat tjetër. Kjo formë e dhënies së besës nuk mbaroi vetëm në qytetin e Medinës, por vazhdoi kështu edhe në qendrat e tjera më të mëdha të asaj kohe.

“Betohem për All-llahun se froni nuk ka qenë kurrë synimi im dhe asnjëherë nuk i jam lutur All-llahut të Lartëmadhëruar për të.”



Muhamed JUSUFI  
-KAJOLLI

**P**ara se të filloj të jap një pasqyrë rreth asaj se ç'ndodhi në shtëpinë e Sekifes, dua të bëj një analizë të shkurtër rreth arsyes se përse Omeri veprroi ashtu siç e pamë në vazhdimin e kaluar, menjëherë pas vdekjes së Pejgamberit s.a.v.s.

Dikush mund të pyesë se si ishte e mundur që Omeri r.a. të mos ishte aq largpamës dhe të sillej ashtu siç u soll, kur i thanë se Muhammedi s.a.v.s. vdiq!? Këtë përgjigje nuk do ta mësonim kurrë sikur ai të mos na e rrëfente vetë. Shumë kohë pasi u shpall kalif, në një rast ai kujtoi sjelljen e tij dhe derisa po qëndronte me Abasin i tha: “O ibni Abas, a e di ti se çfarë më shtyu të sillësja ashtu, ditën kur dëgjova për vdekjen e Muhammedi s.a.v.s.? -Nuk e di, o Emiri i besimtarëve, ti e di më së miri, - iu përgjigj Abasi. Omeri r.a. tha: -Pasha All-llahun e Lartëmadhëruar, ajo që më nxiti ishte thënia e All-llahut në Kur'an të cilën e lexoja shumë shpesh: “Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju...” Për All-llahun, mendoja se i Dërguari All-llahut do të mbetej ndërmjet ummetit, për të qenë dëshmitar mbi ta, deri në fund të jetës së ummetit. Prandaj, kjo më shtyu të thosha atë që e thashë atëherë”.

Ky tregim i Omerit r.a. dhe tregimet e tjera të shumta, tregojnë se shokët e Muhammedit s.a.v.s. ishin fillestarë të një civilizimi i cili sapo kishte lindur.

Natyrisht atyre ju mungonte shumëçka. Secili prej tyre e shijonte besimin sipas aftësive ose mundësive të kapjes së fenomeneve dhe këshillave që jepeshin gjatë Shpalljes së ajeteve kur'anore dhe mësimëve që ua predikonte Muhammedi s.a.v.s.

Në një rast, Muhammedi s.a.v.s. kishte deklaruar se ai kishte informacion edhe një herë më shumë, se sa Kur'anin që e kishin përpara vetes. Kjo lë të kuptohet se, i zgjedhuri All-llahut s.a.v.s., ishte në dijeni të plotë se çfarë barre kishte mbi supë dhe ai, gjithashtu, kishte bindje të plotë në Fuqinë Hyjnore. Sikur të mos kishte një dituri më të qartë se të tjerët, ai do të kishte kërkuar njohuri shtesë nga Krijuesi i botëve, sikurse që kemi rastin e theksuar në Kur'an të Ibrahimit dhe Musait (All-llahu i shpëtoftë që të dy). Këta dy edhe pse ishin të bindur se janë të zgjedhurit e Krijuesit, kishin kërkuar prej Tij një mundësi shtesë. Vallë, mund të jemi të privilegjuar nga të tjerët, dhe të kërkojmë prej Tij, që ta shohim qenien e Tij me këta sy? Vetë pyetja e bërë prej tyre, do të thotë se ata donin akoma më shumë nga sa kishin njohuri. Ata donin ta shihnin me sytë e tyre dhe t'u qetësohej zemra. Kjo jep shenja të mungesës së diturisë.

Ndërsa as'habët, pas vdekjes së Muhammedit s.a.v.s. ishin shokuar dhe jo më kot e kanë ruajtur të shkruar sjelljen e Omerit r.a. dhe të tjerëve. Me të dëgjuar se i zgjedhuri All-llahut vdiq, ata u ndien të vetmuar, jetimë të vërtetë. Po ne kush do të na udhëheqë tani!? - menduan ata.

Tani është e kuptueshme se dhurata më e madhe nga All-llahu i Lartëmadhëruar për njerëzimin ishte garancia Hyjnore. Ai kishte garantuar se në Librin e Tij – në Kur'an, nuk do të qasej asnjë dorë njeriu për të bërë ndryshime.

Prej këtu, njeriu i kërkohet të japë maksimumin e tij për hir të besimit që ka dhe për aq sa ai e kupton Kur'anin - Librin e të gjitha gjeneratave, ndërsa rezultati vendoset sipas Vullnetit të Krijuesit. Për këtë arsye, pak para se të vdiste, Muhammedi s.a.v.s. pasi u siguria mirë për përmbledhjen e plotë të Kur'anit, ua mundësoi as'habëve të tij të shkruanin rreth ligjëratave dhe sjelljeve të tij.

E tërë kjo hyrje ishte për arsye se gjatë historisë do të ndodhnin gjëra shumë të pahijshme. Shumë studiues të Islamit (pa marrë parasysh, a e besojnë atë apo jo), po e ngatërrojnë Librin Hyjnor me sjelljet e besimtarit musliman. Libri Hyjnor nëse do të kuptohej 100% atëherë nuk do të ishte Hyjnor. Çdo gjeneratë e kupton në variantin e vet, ndërsa All-llahu e përhëndet dhe e shpërblen qëndrimin-nijetin e tij, qoftë edhe i gabuar.

## Ç'ndodhi në Sekife?

Pasi situata, brenda në xhami, filloi të përmirësohej dhe po shkonte drejt stabilizimit, të pranishmit filluan të besojnë se Muhammedi s.a.v.s. vërtet kishte vdekur. Pas mbretërimit të një heshtjeje e plotë, të pranishmit të përbotur filluan të shpërndahen. Disa prej besimtarëve filluan të grumbullohen nëpër shtëpitë e figurave më të njohura të muslimanëve, p.sh. një grup prej vendasve-ensarëve u mblodh në shtëpinë e Sekife bin Sead, grupi tjetër i Aliut (All-llahu e fisnikëroftë fytyrën e tij) i përbërë nga Zybejri, Talha dhe të tjerë, në shtëpinë e Fatimes, pastaj u grumbullua grupi tjetër i muhaxhirëve, si Ebu Bekri, Omeri dhe Ebu Ubejde ibn Xherrah dhe të tjerë (All-llahu qoftë i kënaqur me ta). Kështu vepruan edhe ata të grupit të Usejd ibni Hudejr me beni Abdul Eshel-it...

Alia (All-llahu e fisnikëroftë fytyrën e tij) me shokët e tij, para se të shkonte në shtëpi, u mor me përgatitjen e xhenazes, ndërsa grupi i besimtarëve vendas-ensarët ishin mbledhur në shtëpinë e Sekife Beni Sead-it dhe po diskutonin si do të vepronin tani pas vdekjes së Muhammedit s.a.v.s., kur ata nuk kishin zyrtarisht zëvendësin e tij, sepse administrata e udhëhequr nga Muhammedi s.a.v.s. nuk kishte zëvendës legjitim. Natyrisht se këta ensarë të vetëm, nuk do të vendosnin për fatin e shtetit të ri, por vetë fakti se ata po bisedonin midis vete, flet për një kulturë të lartë të të menduarit politik. Në këso takimesh historike edhe vulloset fati i njerëzve dhe, këtu, mbase, do të vendosej fati i dikujt prej ensarëve, sikur që ndodhi në këtë takim, ku u propozua për kalif i mundshëm Sead ibn Ibade, një besimtar shumë i devotshëm.

Sikur të mos u përcillej lajmi muhaxhirëve se ensarët janë duke propozuar ndokënd nga rrathët e tyre për kalif, ai mbase do të bëhej kalif. Nëse një grup e jep propozimin e vet, do të ishte e natyrshme të ndodhte që të mos tërhiqej nga vendimi i marrë. Gjithashtu, në këso momente, ndodh të rriten ambiciet në njërin anë dhe këmbëngulësia në anën tjetër. Kështu do të refuzoheshin debatet me të tjerët.

Për këtë arsye, për të mos ardhur deri në një situatë të palakmueshme, Ebu Bekri së bashku me Omerin dhe Ubejd ibn Xherrahun, shkuan tek vendndodhja e grupit të ensarëve. Këta u mirëpritën prej tyre dhe, gjatë bisedave midis tyre në vazhdim, nuk u vërejtën asnjë shenjë pakënaqësie. Pas pak kohësh, pas bisedimeve vël-lazërore, filluan t'i përmbyllnin fjalimet e tyre duke dalë me konkludime. Njëri nga ensarët ju tha të pranishmëve: "Të nderuar, ju e dini se ne ishim ata që e morëm në mbrojtje dhe e siguroam Muhammedin s.a.v.s. nga të gjitha rreziqet që mund t'i ndodhnin, dhe, gjithashtu, ne jemi më shumë në numër krahasuar me ju (muhaxhirët). Shikuar nga ky këndvështrim, ne jemi më meritoret për ta zëvendësuar pushtetin e Muhammedit s.a.v.s."

Pasi mbaroi përfaqësuesi i ensarëve, Ebu Bekri mori fjalën dhe tha: "Të nderuar dhe shumë të respektuar en-

sarë! Ju vërtet ishit ata që e pohuat. Ju vërtet e siguroat atë dhe ne, prandaj ju meritoni çdo lëvdatë ndër besimtarët dhe tek All-llahu i Lartëmadhëruar, por druaj se mos kjo do të na shkaktojë probleme në të ardhmen. Ju e dini fare mirë se në mesin tuaj, keni nga fisi Evs dhe nga fisi Hazrexh dhe lus All-llahun të mos keni pretendime fisnore të fronit dhe pastaj të ndodhin trazira sikur që ishte zakoni midis jush. Muhammedi s.a.v.s. ishte ai i cili ju kishte pajtuar, ndërsa tani s'ka kush t'ju pajtojë. Ju e dini fare mirë se kurejshitet janë të njohur në mbarë Gadishullin e më gjerë dhe të gjitha fiset arabe vijnë në kohën e pelegrinëve në Mekë. Ju, gjithashtu, e dini se para Muhammedit s.a.v.s. mekkasit ishin të respektuar nga të gjitha fiset e Gadishullit, prandaj qetësia do të mbretërojë në të gjithë ne." Pasi u vërejtën shenjat e miratimit të konk-ludimeve të tij, me anë të tundjeve të kokës si shenjë pohimi, Ebu Bekri vazhdoi: -Prandaj, ju propozoj se sikur të zgjidhej për kalif njëri prej këtyre dy personave kurejshit që janë prezent këtu, unë do të isha plotësisht dakord. Janë persona të cilët i duam të gjithë dhe e meritojnë këtë post të ndjeshëm". Njëri prej ensarëve tha: "Atëherë le të mbetet kështu, ju muhaxhirët të mbani postin e kalifit, ndërsa ne të qeverisë." Në këtë rast, përpara se të merrte sërish fjalën Ebu Bekri, Omeri filloi për t'iu kujtuar të pranishmëve se cili është Ebu Bekri.

Omeri përkujtoi shumë raste rreth besimit dhe mirësive të Ebu Bekrit dhe e përfundoi duke thënë: -Ai ishte personi që na falte namazin, derisa ishte i sëmurë i Dërguari All-llahut s.a.v.s., bile edhe Muhammedi është falur pas tij. Vallë, si mund të dalim ne, përpara këtij njeriu për të drejtuar ummetin? Pasi përfundoi këto fjalë tha: -Asnjëherë Omeri nuk mund të dalë përpara të tjerëve, nëse Ebu Bekri është i pranishëm dhe duke thënë këto fjalë ia zgjati dorën e besës. Nuk vonoi aspak edhe Ubejde ibn Xherrah ia shtriu dorën dhe ia dha besën. Pas tij të gjithë ensarët që ishin aty të pranishëm ia shtrinë dorën e besës. Me kaq mbaroi edhe ky takim që vulosi Ebu Bekrin për Kalif, por ky i fundit tha: -Vallahi do ta pranoja postin e kandidatit që më ofroni, por nuk do ta njoh veten si Kalif nëse nuk

ma japin besën të gjithë besimtarët. Aty u vendos që ditën e nesërme të dalin përpara xhamisë dhe të kërkohet besa e besimtarëve.

### Ebu Bekri masës

Ajo ditë në Beni Saide, mbaroi me një të propozuar për kalif. Po atë ditë, edhe pse muslimanët ishin të preokupuar me vdekjen e liderit të tyre, u përhap lajmi se kandidati për kalif ishte zgjedhur Ebu Bekri. Të nesërmen, pasi u vërtetua se askush nga besimtarët e tjerë nuk u paraqit për kundërkandidat, besimtarët dolën pranë xhamisë. Aty u bë një radhë e gjatë dhe të gjithë filluan t'ia shtrinë dorën duke ia dhënë besën. Historia tregon se jo të gjithë ishin të kënaqur me atë kandidat dhe kjo tregon për lirinë e shprehjes dhe votës. Vetëm pasi shumica dërmuese, për të mos thënë të gjithë të pranishmit, mbaruan me dhënien e besës, filluan ta varrosin Muhammedin s.a.v.s. në vendin të cilin kishte vdekur.

Atëbotë nuk kishte mundësi teknike të bëheshin zgjedhje të lira, por mua personalisht, më duket disi si më shumë se zgjedhje të lira, krahasuar me këto të cilat jemi duke i parë. Kandidati i propozuar del përpara popullit dhe kërkon prej tyre t'ia japin besën dhe secili në vete do t'ia zgjasë dorën e besës. Kjo është fantastike. Pa asnjë dyshim se ato i ngjasojnë zgjedhjeve të lira, edhe pse atë ditë nuk doli asnjë kundërkandidat tjetër. Kjo formë e dhënies së besës nuk mbaroi vetëm në qytetin e Medinës, por vazhdoi kështu edhe në qendrat e tjera më të mëdha të asaj kohe. Pasi shumica dërmuese e popullit kishte dalë për t'ia dhënë besën, Ebu Bekri mbajti një fjalim. Nga ai fjalim do të veçonim këto fjalë: "Beto hem për All-llahun se froni nuk ka qenë kurrë synimi im dhe asnjëherë nuk i jam lutur All-llahut të Lartëmadhëruar për të." Pastaj vazhdoi duke thënë: "Unë u zgjedha që t'ju udhëheq, por unë nuk jam më i miri nga ju. Nëse do të drejtoj mirë, atëherë kërkoni përkrahjen tuaj, e nëse gaboj më kundërshtoni. Dijeni se e vërteta është amanet, ndërsa gënjeshtria është tradhti..."

(Në numrin e ardhshëm: Të pakënaqurit me zgjedhjen e Ebu Bekrit r.a.)

# Ne dhe Ju le të puqemi në dashuri

“Dashuri për Zotin, Dashuri për Fqinjin”

**Sejjid Hossein Nasr**

**B**ismi'l-Lahi'r-Rahmani'r-Rahim  
Në Emër të Zotit, të Gjithëmëshirshmit, Plotmëshiruesit! Bekime e paqe pastë mbi Profetin Muhammed dhe të gjithë profetët dhe të dërguarit.

Shenjtëria Juaj, Eminenca, Shkëlqesi, Dijetarë të Shquar:

Në Fjalën e Zotit, që për ne muslimanët është Kur'ani Fisnik, pohohet “Dhe Zoti thërret për te Vendi i Paqes” dhe Krishti (paqe pastë mbi të), i cili është Fjala e Zotit në Krishterim dhe profet i rendit më të lartë në Islam, ka pohuar: “Të bekuar janë paqebërësit”. Synimi i arritjes së paqes, kësaj, është i përbashkët mes dy feve tona dhe ne jemi këtu pikërisht me shpresën e arritjes së paqes ndërmjet Krishterimit e Islamit. Vërtet, ç'mund të jetë më e rëndësishme dhe më themelvënëse në kërkimin e paqes sesa krijimi i paqes mes feve tona – pasi vetëm nëpërmjet kësaj paqeje do mund të vendoset paqja mes popujve e kombeve, më konkretisht botës islame dhe perëndimit. Të krishterë apo muslimanë qofshim, fetë tona na sinjalizojnë që të synojmë paqen. Si njerëz të fesë që takohemi këtu në qendrën e katolicizmit, le t'i kushtohemi, atëherë, mirëkuptimit të ndërsjellë, jo si diplomatë, por si dijetarë dhe autoritete fetare, të sinqertë përpara Zotit dhe përgjegjës tek Ai, përtej çdo autoriteti të kësaj bote.

Si muslimanë, jetët tona janë pikësuar, qysh me agimin e zbulesës kur'anore, nga përsëritja e dëshmisë islame të besimit, La ilahe il-la'Llah (Nuk ka hyjni veç Zotit), Zotit Një të shpallur edhe në Shema të Teuratit, të cilin të dyja fetë tona e pranojnë si shkrim të shpallur, ngase ne dhe ju jemi që të dy anëtarë të familjes së monoteizmit abrahamik. Jemi gjithashtu të ndërgjegjshëm se për afro dy mijëvjeçarë, të krishterët katolikë kanë recituar credo in unum Deum. Për ne, ashtu si dhe për ju, Zoti është


njëherësh transcendent dhe imanent, krijues e mbajtës i botës, alfa dhe omega e ekzistencës – Fuqiploti, Vullneti i të cilit mbizotëron në jetët tona, Dashuruesi, dashuria e të cilit rrok mbarë rendin e krijuar.

Ai është gjithashtu i drejtë, ndaj dhe ne e ju etemi për drejtësi në jetët tona individuale dhe shoqërore. Ne dhe ju besojmë në pavdekshmërinë e shpirtit, përmbajtjen etike të veprimeve njerëzore, përgjegjësitë tona përpara Zotit, nga ku burojnë edhe të drejtat tona. Për më tepër, të gjithë besimtarët, të krishterë e muslimanë, besojnë se një ditë do qëndrojmë përpara Zotit dhe do të gjykojemi prej Tij për veprimet tona këtu poshtë, ndërsa të dy palët, po ashtu, lusim Mëshirën e Tij. Ne dhe ju besojmë në realitetin e shenjtërisë dhe historitë tona dëshmojnë për jetët e shenjtoreve, që muslimanët i quajnë miq të Zotit (eulijā), burra dhe gra që kanë kundërmuar aromën e Afrisë Hyjnore. Ne të dy çmojmë besimin mbi gjithçka tjetër dhe i lutemi Zotit, të sigurt se Ai na dëgjon.

Kur shohim spektrin e plotë të traditave tona teologjike, vërejmë në to mënyra të ndryshme të të kuptuarit të marrëdhënies ndërmjet besimit e arsyes, çështjes së padepërtueshmërisë së Vullnetit Hyjnor apo njohjes së Tij, ose vullnetit të lirë e determinizmit, kuptimit të së keqes dhe shumë çështjeve të tjera teologjike vendimtare.

Spikat fakti se si qëndrimet teologjike në njëtrësi kanë përkuesin e tyre në tjetrën, mutatis mutandis. Të dyja fetë tona kanë krijuar qytetërime madhore, artet dhe shkencat e të cilave janë të ngjyera me praninë e së shenjtës, dhe ne gjithashtu që të dy pohojmë universalitetin për mesazhin tonë.

Dhe sigurisht, që të dyja historitë tona janë ndërthurur me periudha dhune, e kur feja ka qenë e fortë në shoqëritë tona, forca të ndryshme politike kanë ushtruar dhunë në emër të saj dhe në raste të caktuara kjo dhunë ka marrë legjitimizim nga autoritetet fetare. Me siguri, nuk mund të preten-



**Sejjid Husein Nasr**

Eksperti udhëheqës në botë mbi mendimin dhe përsipirtshmërinë islame, Sejjid Husein Nasr është profesor i Studimeve Islame në Universitetin e Xhorxh Uashingtonin. Ai ka shkruar mbi pesëdhjetë libra. I lindur në Teheran, i rritur në Shtetet e Bashkuara dhe i diplomuar në Institutin Teknologjik të Masaçusetsit (MIT) dhe Harvardit, Profesor Nasri është një figurë intelektuale e mirënjohur si në Perëndim, ashtu edhe në botën islame. Ai jeton në Uashington D.C.

dojmë se dhuna është monopol vetëm i njërës fe.

Me kaq shumë ngjashmëri të thella, përse atëherë kemi pasur një histori kaq të gjatë konfrontimi e kundërvënies? Përgjigjja është se ne sigurisht kemi edhe dallimet tona, të cilat i kanë mbajtur Krishterimin dhe Islamit të dallueshëm dhe të veçuar. Le të përmendim vetëm disa prej tyre. Ne theksojmë Unitetin Hyjnor dhe kundërshtojmë idenë e një Zoti të trefishtë, ndërsa ju theksoni Trinitetin duke besuar që Zoti është Një. Ne dhe ju kemi nderim për Krishtin, por në mënyra të ndryshme dhe ne s'e pranojmë rrefimin kristian për fundin e jetës së tij tokësore. E prapëseprapë, ne muslimanët, gjithashtu, e pranojmë Krishtin si Mesia (el-Mesih) dhe presim ardhjen e tij të dytë në fund të historisë së këtij njerëzimi. Ne theksojmë Ligjin Hyjnor (el-Sheri'ah) si të rrënjësor në shpalljen kur'anore, ndërsa Krishti pohoi ndarjen e tij me Ligjin, në emër të Frymës. Prandaj, të krishterët nuk kanë të njëjtin koncept të Ligjit Hyjnor, sikurse çifutët dhe muslimanët. E të krishterët nuk

# rinë për Zotin

kanë as një gjuhë të shenjtë sikurse Islami, por ata kanë përdorur, dhe disa akoma përdorin, disa gjuhë liturgjike.

Edhe ju edhe ne besojmë në lirinë fetare, por ne nuk lejojmë prozelitizim agresiv në mesin tonë, çka do na e shkatërronte besimin në emër të lirisë, ashtu siç nuk do ta lejonin kristianët po të ishin në vendin tonë. Përballja e Krishterimit me modernizmin, përfshirë humanizmin shekullar dhe racionalizmin që i shoqërohen Epokës së Iluminizmit, ka qenë gjithashtu shumë e ndryshme nga përvoja e asaj përballjeje me Islamit. Mbase, çdonjëri nga ne mund të mësojë diçka nga tjetri në këtë çështje tejet domethënëse. Ne duhet të bashkohemi në betejën ndaj desakralizimit dhe forcave antifetare në botën moderne, e bashkimi i përpjekjeve do na sillte më pranë njëri-tjetrit. Shekullarizmi nuk duhet asesi të jetë burim për krijimin e largësisë së mëtejshme midis nesh.

Me ndërjegje të plotë, qoftë rreth bindjeve të përbashkëta, qoftë dallimeve tona, si dhe në dritën e gjendjes së tashme të ndjekësve të feve tona, ne si muslimanë, nga vende e shkolla të ndryshme të mendimit islam, kemi ardhur këtu së bashku t'ju zgjasim dorën e miqësisë, duke kërkuar t'ju takojmë në dashurinë për Zotin, përtej të gjitha dallimeve teologjike dhe kujtimeve të konfrontimeve historike. Pa dyshim, ne, të cilët e respektojmë dhe e duam Krishtin sikurse ju, mund të piqemi e të bashkohemi me ju nën flamurin e atyre që ai i ka quajtur dy urdhëresat supreme: dashurinë për Zotin dhe dashurinë për fqinj. Ne mund të synojmë gjithashtu të tejzgjasi, shpesh në harmoni me njëri tjetrin, kufirin e nocionit të fqinj, për t'ju përfshirë jo vetëm juve, por mbarë njerëzimin, madje edhe përtej kësaj, krejt pjesën tjetër të krijimit të Zotit. Sikurse pohon Bibla e Shenjtë, "Te Zoti, gjithçka është e mundur." Ne i nënshtrohemi Atij e kërkojmë ndihmën dhe miratimin e Tij në kryerjen e kësaj detyre tejet të rëndësishme të takimit me ju në miqësi e paqe, nën flamurin e asaj Fjale të Përbashkët që na bashkon. S'mund të ketë veprim më të bekuar në kohët tona sesa krijimi i një puqjeje të thellë mes feve të Zotit, sidomos dy feve që kanë numrat më të mëdhenj të ndjekësve në botë, gjegjësisht Krishterimit dhe Islamit. Vërtet, Zoti thërret për te Vendi i Paqes dhe të bekuar janë paqebërësit.

Fjalim i mbajtur në Konferencën e Parë të Forumit Katoliko-Musliman, Vatikan, 4-6 nëntor 2008

**Përgatiti: Nexhat Ibrahim**

## Në përkujtim të mësuesit tim: Efendi Idriz Kakrukut Ai ishte aty ku nevojitej

**Zoti më bëri shqiptar, prandaj më duhet të shkoj atje që të jap kontributin tim, për kombin e vetmuar. Atje, në Jordani, kishte kuptuar se sistemi komunist po ua shuante dalëngadalë shqiptarëve ndjenjat kombëtare e fetare. Duke qenë se ishte një person që ia donte të mirën njerëzimit, ai para se të vdiste hapi një xhami në Çikagon e largët dhe, me të, shpërndau farën e paqes dhe të shpëtimit njerëzor**



### Muhamed Jusufi-Kajolli

**A**q e madhe sa është dashuria për njeriun kur ai është gjallë, po aq e madhe është edhe dhembja për vdekjen e tij. Lajmi për vdekjen e Mulla Idriz Kakrukut (Kosova), mbi tavolinën e kompjuterit në Çikago të SHBA-ve, më rrëqethi trupin. Nuk e kuptoja saktë se ç'po ndodhte me mua: lajmi i vdekjes së befasishme të tij, apo lakmia për të pasur një vdekje si të tijën.

Asnjëherë nuk e kam kuptuar këtë njeri nëse ishte i mërëzitur ose jo, mbase në momentet më kritike të jetës së tij, të cilat i kishte të shpeshta, ai gjithmonë gjente kohë për këshilla dhe për të na mësuar gjëra të panjohura. Duke qenë se, gjatë punës së tij, ai i kishte vizituar shqiptarët e Ballkanit, Turqisë, diasporës dhe të mbarë botës muslimane, atij i kishte ngelur pa njohur dhe pa vepruar për së afërmi edhe në SHBA.

Pas pavarësimit të Kosovës, ai kishte shprehur konsideratën e tij thellë vëllazërore për popullin amerikan, prandaj kishte vendosur që ta jepte kontributin e tij edhe atje. Duke qenë se ishte person

që ia donte të mirën njerëzimit, ai para se të vdiste hapi një xhami në Çikagon e largët dhe, me të, shpërndau farën e paqes dhe të shpëtimit njerëzor.

### Biografia

Mulla Idrizi u lind më 1941, në Dërnagllavë të Kaçanikut. Në moshën katërvjeçare i vdiq babai dhe mbeti jetim. Shkollën fillore e kreu në fshat, tek mësuesi Nezir. Që në fëmijërinë e tij dha shenjat e një djaloshi me inteligjencë të lartë. Vendi në të cilin kishte lindur ishte tepër i vogël për të, prandaj, ishte vërejtur se ai gjithmonë ishte në kërkim të asaj që i mungonte. Ai do të shkonte në xhaminë e Kaçanikut çdo të premtë, në përpjekje për të gjetur përgjigje e pyetjeve që i interesonin. Atje, përveç faljes së namazit të xhumasë, ai do të qëndronte për të mësuar edhe më shumë tek Mulla Selmani i Nikajve.

Për arsye të njohura për të gjithë shqiptarët e Kosovës, familja e tij u vendos me qëndrim të përhershëm në Shkup, në vitin 1961. Kushtet e vështira për jetë,


e detyruan Idrizin njëzetvjeçar të punësohet në një ndërmarrje elektriku. Meqenëse diturinë e kishte pasion, në qytet, mundësitë për të mësuar rreth Islamit ishin shumë më të mëdha, prandaj pas orarit të punës, Idrizi do të fillonte të mësonte të ushqej me dituri Islame tek efendi Hafiz Ibrahim.

### **Drejt vendeve ku do ta kënaqin përgjigjet**

Si duket edhe Shkupi nuk i përbushu nevojat e vizionit të tij. Ajo që e preokuponte akoma ishte enigmë për të. Mësimet tek ky hoxhë shumë i respektuar në qytetin e Shkupit ishin të nivelit të mirë, por, kërkesat e Idrizit ishin më të mëdha. Ai kishte dëgjuar për Hoxhë Kadri Prishtinën, Mulla Idriz Gilanin, Fari e Hasan efendilerët nga Gjakova, Atallah efendiun nga Shkupi, e për shumë patriotë të tjerë të njohur fetarokombëtarë, por mësimet që ai po i vijonte në atë medrese, nuk po i ofronin përgjigjet e duhura. Diçka nuk shkonte në mësimet fetare në atë kohë. Si shumë qytete të Kosovës edhe Shkupi sikur ishte në kundërshtim me ndjenjat kombëtare. Ai kishte besim të thellë, se kishte të bënte me një fe që ishte e përkryer, por, përse nuk po dëgjonte ligjëratat rrëqethëse për drejtësinë e fesë dhe kombit në asnjë xhami! Këtë nuk po e kuptonte djaloshti i etur.

Për të marrë këtë përgjigje, ai, në moshën njëzet e katërvjeçare, u regjistrua në shkollën e mesme të Damaskut, ku përfundoi fakultetin për Bazat e Fesë Islame, në Aman të Jordanisë, në 1973. Në prag të mbarimit të fakultetit, për shkak të inteligjencës dhe rezultatit të lartë në studime, atij iu ofrua punë në gjykatën e Amanit, por ai iu tha atyre: 'Zoti më bëri shqiptar, prandaj më duhet të shkoj atje që të jap kontributin tim, për kombin e vetmuar. Atje, kishte kuptuar se sistemi komunist po ua shuante dalëngadalë shqiptarëve ndjenjat kombëtare e fetare.

Atë vit ai u kthye në Shkup, por, si një Idriz krejt ndryshe nga ai që



e kishin njohur. Elita e atëhershme e Shkupit nuk i mirëpriti idetë e tij, por, struktura e xhematit në xhami filloi të ndryshojë. Hoxhallarët e viteve 60-70-ta, nuk ishin mësuar t'i shohin xhamitë e stërbushura. Në këtë kohë, shqiptarëve të robëruar nga sllavët në mënyrë të sofistikuar, po ju luftohej feja. Sipas ekspertëve komunistë, feja i bënte shqiptarët të fuqishëm dhe kjo ringjallte ndjenjat kombëtare. Për këtë arsye edhe prof. Aleks Buda nga Shqipëria-komuniste, kishte kërkuar nga patriotët shqiptarë që në Kosovë e Maqedoni të ndërtoheshin sa shumë xhami, se kështu do të shpëtonte kombi.

Për fatin e tij të keq, hoxhallarët, në vend se t'i ofronin vend pune në Bashkësinë Islame, ia rrezikuan atij qëndrimin në Shkup. Këtë burrë, që tani kishte dhënë shenjat e një revolucionari, do ta mbështeste një

patriot nga fshati Grushinë e Shkupit, bacë Bajrami. Për afro dy vjet, ef. Idriz Kakraku do të kontribuonte në këtë fshat. Duke qenë se kishte në mendje zgjimin e shqiptarëve, ai, për çdo ditë, do të shkonte në Shkup dhe atje, do të takohej me njerëzit më me ndikim. Por UDB-ja, çdo ditë e më shumë po ia ngushtonte veprimtarinë dhe, pasi u këshillua me shokët e tij më të ngushtë, ef. Idriz Kakraku do të migronte për në fshatin Drenoc të Deçanit.

Në këtë fshat u mirëprit dhe aty veproi mbi dhjetë vjet. Në tri vitet e fundit të qëndrimit të tij në këtë fshat, ai shpeshherë do të shkonte në Prishtinë. Familja që e përkrahu më së shumti në Prishtinë ishte ajo e Pajazit Islamit, nga fshati Lismir. Tani e tutje, rrethi i Prishtinës dhe i Besianës, do ta quanin ef. Idrizin – Bacë Idriz Kosova. Në kohën kur as-

një njeri nuk guxonte t'u vihej karshi serbëve, ai do të ligjëronte në Fushë Kosovë, gjatë muajit të Ramazanit të vitit 1985, në ato pak shtëpi që ishin dhe kështu u bë nismëtari i parë i hapjes së xhamisë në Fushë Kosovë.

Kjo enklavë serbe e Kosovës, ishte ndër vendet më me ndikim në mbarë lëvizjen serbe për 'bashkimin' e trojeve serbe të ish-Jugosllavisë. Në këtë qytezë, Millosheviqi mori bekimin e popullit të tij, ndërsa Bacë Idrizi mu në këtë vend, po i provokonte serbët, duke bërë përpjekje për hapjen e një xhamie. Fillimisht, do t'ia niste punës në një shtëpi të blerë prej një serbi, që më vonë do ta shndërronte në xhami.

### **Nismëtar i themelimit të këshillit të pajtimit të gjaqeve dhe ushtar i UÇK-së**

Duke parë zgjuarsinë, trimërinë dhe entuziazmin e tij, elita shqiptare e Prishtinës për ta pasur çdo ditë e më afër këtë njeri, i ofruan atij punë në arkivin e Kosovës. Gjatë qëndrimit të tij në këtë vend pune, ai u rrah për vdekje disa herë nga persona të panjohur për policët shqiptarë!

Bacë Idrizi ishte nismëtar i themelimit të këshillit të pajtimit të gjaqeve. Ai i priu këtij këshilli disa vjet me radhë, për të mos thënë deri në vdekjen e tij. Në saje të kontributit të tij të drejtpërdrejtë, janë pajtuar më shumë se treqind familje.

Gjatë ballafaqimit ushtarak të drejtpërdrejtë me serbët, Bacë Idrizi do të ishte një ushtar i rregullt i UÇK-së. Pas mbarimit të luftës, ai do t'i kthehej sërish normalitetit dhe kontributit të tij, por kësaj radhe e gjejmë si një shërbëtor të përkushtuar për të ndihmuar popullin e shkatërruar. Kësaj radhe, ai kontributin e tij të pashembullt do ta japë në ndihmë të skamnorëve, me anën e shoqatës më të madhe të Arabisë Saudite.

Pasi vërejti se nevojat e popullit filluan të pakësohen, ai u kthye sërish në arkivin e Kosovës. Ajo që e

brengoste më së shumti, ishte mungesa e bibliotekës të stërmadhe që kishte dhe, në veçanti, dorëshkrimet që kishte mbledhur gjatë jetës së tij. Serbët e Fushë Kosovës ia kishin djegur dhe shkrumbuar shtëpinë deri në themel. Derisa po e rindëronte shtëpinë, në kohën kur po banonte në një shtëpi të përkohshme, atij i vdes shoqja e jetës, Fatimeja, e cila i dha katër vajza e dy djem. Vdekja e saj e preku thellë në shpirt, sepse vuajtjet e saj prej nëne, ishin shumë më të mëdha se sa ato të vetë ef. Idrizit. Shpeshherë, kur i shkonim, ajo shqetësohej për mungesën e ushqimit, sepse nuk kishte aq sa ajo dëshironte ta shtronte në sofër. Por, ajo që më së shumti e shqetësoonte ishte frika se mos po mbetej me jetimë.

### **Disa karakteristika të ef. Idriz Kakrukut-Kosova**

Duke qenë se ishte pajisur me dituri bazë dhe të shëndoshë islame, ai do t'i kërkonte falje secilit njeri me të cilin kishte pasur debat, para shkuarjes së tij në Arabi. Ai nuk i frikësohej të vërtetës, prandaj edhe kur ndonjë student thoshte ndonjë fjali të cilën nuk e kishte dëgjuar më parë, ai do të ngrihej në këmbë dhe do t'ia puthte ballin.

Ndërsa në takimin e parë me ndonjë punëtor krahu, përsëndetja e tij ishte e veçantë, sepse, do t'ia puthte duart atij punëtori dhe shumë kujt prej tyre u thoshte me lot në sy: Nuk di nëse e kuptoni se çdo të thotë dora e punëtorit para Zotit, nuk di nëse e kuptoni se, nga kjo dorë dalin dijetarë e shkencëtarë shqiptarë. Kjo dorë punëtore sjell lirinë, ah, sikur ta kuptoni!

Atij që e ftonte në doli synetije nuk i shkonte, por i thoshte: 'Nuk ka dallim midis prerjes së thonjve dhe synetisë, prandaj mos harxhoni kot para për këtë obligim'. Për shkak të parimeve që kishte, ai nuk i shkoi në dasmë synetie as vëllait të tij në Shkup, duke i thënë: Të lutem vëlla, mos ma merr kohën kot...Parimet e tij ishin të shumta dhe shumë in-

teresante për masën. Me raste të veçanta do të shënohen edhe shumë të tjera.

### **Vendi tij në shoqërinë fetare**

Ef. Idriz Kosova, për fat të keq, nuk ishte kuptuar saktë nga elita fetare. Shumë prej tyre, gjatë okupimit sllav, i shmangeshin atij. Ai nuk ishte fajtor se ishte transparent dhe shumë i drejtpërdrejtë. Ai nuk i trembej ballafaqimit të argumenteve. Ishte enciklopedi e gjallë.

Në kohën kur populli i Kosovës mori drejtimin e duhur drejt pavarësisht të tij, ai filloi të shikojë shumë larg. Disa mendojnë se kishte lindur një shekull më herët, prandaj shkoi në Çikago të Amerikës, që të jepte edhe atje kontributin e tij mbarënjëzëror. Atje hapi një xhami dhe u emërua Imam i asaj xhamie. Pas një kontributi gati njëvjeçar, dikush nga xhema, i shqetësuar për hoxhën e tyre që nuk kishte dalë në xhami për në namazin e drekës e pastaj edhe të ikindisë, shkoi në banesën e tij. Pasi e verifikuan se nuk kishte qenë tek asnjë nga xhematlinjtë e tij, ata e thyen derën e hyrjes dhe, aty mbi tavolinën e kompjuterit, e gjetën të vdekur. Shkaku i vdekjes kishte qenë një hemorragji cerebrale. Para pesë vjetësh, ai ishte operuar nga aorta.

### **Varrimi**

Edhe pse e kishte lënë me gojë se, atje ku do t'i ndahej shpirti prej trupit, atje ta varrosnin, megjithatë, mërgata shqiptare e Amerikës vendosi që varrimi i fort të nderuarit dhe hoxhës shumë të respektuar të bëhej në Kosovë. Në praninë e disa mijëra vetë dhe, në praninë e elitës fetare, kombëtare, ushtarake dhe ndërkombëtare, pas një seri fjalimesh rreth kontributit të Idriz Kakrukut-Kosova, ai u varros në varrezat e Fushë Kosovës.

Ne e kemi njohur për shembullor. All-llahu e mëshiroftë dhe e pranoftë me shehidët e rangut më të lartë. Pranoje, o Zot!

# Martesa obligim jetësor

Martesa është një institucion që ka rëndësi shumë të madhe për shumë sfera jetësore si të dashurisë, lumturisë, ekonomisë, sigurisë etj. Ajo na mëson që të kalitemi më së miri për t'u përballur me të gjitha sfidat jetësore



Mirsad KUTELI

**M**artesa është një bashkim legal, shpirtëror, fetar e shoqëror i individëve. Shpeshherë individët nuk i analizojnë dhe aq komponentët e lartpërmendur, të cilët janë mjaft kompleksë dhe ngërthejnë fushat kryesore jetësore. Për faktin se vetë martesa si bashkim nënkupton unionin e dy qenieve njerëzore që Zoti i ka krijuar si palë për ta plotësuar dhe ndihmuar njërin-tjetrin, në mënyrë që ta kultivojnë, ruajnë dhe avancojnë zinxhirin e shoqërisë njerëzore. Një union i tillë, mes burrit dhe gruas, është lidhja më e ngushtë që mund të ekzistojë ndërmjet njerëzve. Ata janë shumë të hapur dhe të çiltër me njëri-tjetrin, rrëfihen edhe për më të fshehtat e zemrave të tyre, të cilat nuk do t'ia tregonin dikujt tjetër.

Martesa është një institucion që ka rëndësi shumë të madhe për shumë sfera jetësore si të dashurisë, lumturisë, ekonomisë, sigurisë etj. Kështu që ajo na mëson që të kalitemi më së miri për t'u përballur me të gjitha sfidat jetësore.

Për sa i përket aspektit të dashurisë, njeriu në jetën e tij përpiket dhe preokupohet gjithnjë rreth fatit të vet. Shpeshherë, mbase bën dhe gabime në kërkim të fatit. Madje, ka raste edhe kur kalon në dëshpërim. Mirëpo, njeriu gabohet dhe nganjëherë harron se me lindjen e tij, Zoti ja ka shkruar dhe fatin e tij jetësor. Pra, Ai ia ka caktuar bashkëshortin/en që në lindje. Pikërisht për këtë, populli ynë thotë "Kërkoje fatin" - që nënkuptohet se ai ekziston. Andaj, nuk duhet humbur shpresa se pavarësisht rrethanave në të cilat ndodhemi, fati do të vijë në drejtimin tonë me shpejtësinë që ne ecim drejt tij.

Një aspekt tjetër, pos dashurisë, është dhe lumturia. Të dyja këto janë të ndërlidhura në mes vete, por lumturia është një sferë më e gjerë. Përderisa po flasim për martesën, lumturia është faktor kyç për një martesë të suksesshme. Për ta arritur atë duhen kombinuar komponentët e përmendur. Normalisht që do të jetë e vështirë, por asnjë institucion nuk mund të funksionojë pa një hierarki strukturale dhe gërshetimin e faktorëve përbërës. Lumturia është një vazhdimësi e dashurisë së sinqertë, e cila kurorëzohet me martesë. Ajo është e nevojshme për të ekzistuar një lidhje konstante bashkëshortore dhe familjare.

Po ashtu, aspekti ekonomik konsiston në impaktin që ka në përditshmërinë jetësore. Para se të hyhet në martesë, burri dhe gruaja ballafaqohen me çështje ekonomike, që janë dhe predispozita për martesë të sigurt. Andaj, sfera e ekonomisë i përcjell bashkëshortët deri në fund të jetës.

Siguria është e drejtë bazike e individëve përbrenda një shoqërie si në aspektin lokal, ashtu edhe në aspektin global. Në këtë drejtim, martesa është institucioni ligjor që i mbron me juridiksion burrin dhe gruan. Një i ri apo e re, shpeshherë, ndihet i pasigurt para martesës. Të rinjtë janë përplot ekuivokë rreth dashurisë dhe marrjes së vendimeve për fatin e tyre. Andaj, gjetja e fatit dhe pajtimi me të, krijojnë një stabilitet përbrenda individëve.

## Shtyrja e vendimit për martesë, ka konsekuenca të mëvonshme

Ekzistojnë disa arsye për lidhjen e një martese. Ne përmendëm vetëm pak prej tyre. Organizimi i jetës në martesë ka rëndësi esenciale, për shkak se ai shëmbëllen me organizimin e jetës si tërësi. Struktura e jetës në familje funksionon si një njësi e familjes globale.

Brengosës është fakti se në shoqërinë tonë në Kosovë, të rinjtë gjithnjë e më shumë e shtyjnë vendimin për mar-

tesë, për arsye të ndryshme. Mirëpo, faktorët e mësipërm si dashuria, gjendja ekonomike, siguria, karriera dhe rrethanat e tjera familjare e shoqërore janë shumë sinjifikative në marrjen e vendimeve të tilla. Megjithatë, martesa nuk duhet vonuar, për shkak se vonesat kanë konsekuenca të ndryshme si në aspektin shëndetësor, po ashtu edhe në atë religjioz.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e bashkëshortëve janë të ndara në mënyrë të drejtë ku secili plotëson dobësinë e tjetrit, për faktin se edhe pse burri dhe gruaja konsiderohen të barabartë, ata kanë dallime në aftësitë dhe mundësitë e lindura. Ndaj, vetë kompozicioni 'marrëdhënie bashkëshortore' do të thotë: marrje dhe dhënie në të gjitha sferat e jetës ku nevojitet. Për forcimin e lidhjes martesore është shumë e rëndësishme shfaqja e emocioneve, që shërbejnë si ushqim shpirtëror. Krijimi i një lidhje konstante bashkëshortore, i sigurisë, harmonisë dhe qetësisë familjare është garanci e mirë e lidhjes me Zotin.

Si konkluzion i tërë kësaj, anëtarë pozitivë të martesës janë të shumta. Dashuria, harmonia, lumturia, qetësia, relaksimi, përkrahja e sigurimi, përkushtimi ndaj familjes dhe fëmijët, që të gjithë këta elementë janë një bazë stabile për realizimin e njerit prej qëllimeve kryesore në jetë, siç është martesa.

Ndërkaq, jeta në vetmi nuk ka kuptim. Në të kaluarën disa filozofë nuk janë martuar, duke e konsideruar vetveten 'perfekt', kinse i mjaftojnë vetvetes dhe nuk kanë nevojë për të tjerët. Por, Zoti e krijoi burrin dhe palën tjetër, gruan, që të jetojnë së bashku në qetësi dhe mbollin dashuri dhe mëshirë mes tyre, në mënyrë që ata ta ndihmojnë njëri-tjetrin. Ky është dhe një fakt tjetër që na bën të kuptojmë se martesa shërben dhe si ruajtës i llojit njerëzor, pa të cilën shoqëria njerëzore do të ishte zhdukur ose do të ishte degjeneruar në tërësi.

# Njeriu që iu përkushtua karikaturës mbi gjysmë shekulli

## Ramadan Zaplluzha (Therrë Murrizi)



**Ramadan Zaplluzha**, alias Therrë Murrizi, është i lindur më 1938, në qytetin e Prizrenit. Ka punuar 42 vite pa ndërprerë si mësues, ndërsa që dhjetë vite është në pension. E quan vetën fatbardhë që ka qenë nxënës i gjeneratës së parë të Shkollës Normale Shqipe në Prishtinë.

“Vizatimin si lëndë mësimore e kam dashur që nga bankat e shkollës fillore. Këtë dashuri e ushqej edhe sot e kësaj dite edhe pse i kam kaluar të shtatëdhjetat” - shprehet Ramadani, duke shtuar se ka vizatuar gjithçka që i ka parë syri. Në pyetjen tonë se që sa kohë merret me karikaturë, xha Ramadani përgjigjet: - Mbi gjysmë shekulli!





“Edhe karikatura është art. Karikatura është medium. Karikatura është formë e veçantë e përjetimit të botës. Ajo është mënyrë specifike e përjetimit të shprehjes artistike. Karikatura është mënyrë e observimit, është formë specifike e raportit që vë individit me aktualitetin...” - thotë mysafiri ynë i njohur me nofkën “Therrë Murrizi”, i cili tri të katërtat e jetës së vetë është marrë në mënyrë aktive me karikaturë.

Karikaturën e parë Ramadan Zaplluzha e ka botuar në vitin 1954 në revistën “Zani i Rinisë”, për të vazhduar pastaj në të përditshmen “Rilindja” dhe pothuajse nëpër të gjitha mediat e shkruara që botoheshin në Kosovë. Karikaturat e tij i ka botuar edhe në Shqipëri, Turqi, Itali, Maqedoni dhe vende të tjera.

Ramadan Zaplluzha kultivon me sukses edhe vizatimin e stripit të mirëfilltë shqiptar dhe është autor i shumë krijimeve të këtilla.

Në këtë prezantim po botojmë edhe disa nga karikaturat që mysafiri ynë i ka punuar enkas për revistën “Paqja”.

(D. Reshiti)



# Pse kufizohen studimet Master në UP?

**Feti Mehdiu**

**S**tudimet master në Universitetin e Prishtinës nuk po ecin si duhet. Kështu ndodh vetëm për arsyen se administrata e Universitetit të Prishtinës nuk ka disponim e durim ta interpretojë drejt dhe ta zbatojë rregulloren për studimet master sipas sistemit të reformuar të Bolonjës.

Kjo është shprehur në mbledhjen e radhës të Senatit të UP (shih 'Kosova Sot', dt.18.10.08, fq. 8). Senatori student A. Bajraktari, me plotë të drejtë kërkon "... që të mos ketë kufizime, sepse kështu po u bëhet e padrejtë studentëve". Ndërkaq, rektori Hasani me një krahasim jo të qëlluar: Maturë – Master, u përgjigj se "... nuk ka vend për të gjithë dhe nëse mund të quhet kjo padrejtësi, atëherë padrejtësi është edhe për ata që kanë kryer shkollën e mesme dhe nuk mund të shkojnë në universitet".

## Rregullorja përmban dy nene kontradiktore...

Vazhdimi i studimeve master në UP është preokupim i të gjitha njësive akademike dhe është diskutuar, besoj në të gjitha njësitë akademike, por nuk është analizuar në mënyrë meritore teksti i rregullores për studimet master. Në fakt, rregullorja përmban dy nene kontradiktore për të cilat duhet durim dhe kthjelltësi që të analizohen dhe, sipas bindjes time, të hiqet neni që kufizon numrin e kandidatëve duke u kërkuar kushte të veçanta për regjistrim.

Me sistemin e ri të studimeve duhet pas parasysh se studimet master nuk janë studime pasdiplomike sikur që kanë qenë më parë por janë "...Vazhdim i studimeve themelore..." (shih Rregulloren). Kjo u jep të drejtë studentëve të jenë të brengosur për shkeljen e të drejtës së tyre për të vazhduar shkollimin e mëtejshëm, përkundra faktit se ata me diplomën Bachelor janë kualifikuar për të vazhduar studimet master.

Kjo u garantohet me rregulloren ku thuhet se këto janë "vazhdim i studimeve themelore" që nënkupton të drejtën për të vazhduar studimet në vitin 4, gjegjësisht vitin e parë të studimeve master dhe pas këtyre studimeve merret grada Master – jo Magjistër. Nuk ka bazë të kërkohej kushte të tjera përveç diplomës Bachelor, njëlloj sikur nxënësi, i cili ka kryer klasën e tetë, që fiton të drejtën të regjistrohet në klasën e nëntë.

## Po u vazhdua kështu, pas disa vitesh një varg katedrash i pret dryni

Por, hyrja në universitet nuk është vazhdim i mësimet si në shkollën e mesme, po është fillim i studimeve kur rinia përcaktohet për lëmin e caktuar sipas dëshirës e afinitetit individual. Grada e Maturës nuk është e krahasueshme me gradën Bachelor. Me kryerjen e studimeve arrihet kualifikimi që me sistemin e vjetër të studimeve kandidatët e arrinin me katër vjet studime. Me kufizimin, gjegjësisht me mohimin e të drejtës për vazhdimin e studimeve master, bëhet ndërprerja e dhunshme e shkollimit të rinisë universitare.

Sipas kësaj del se veprimi që ngul këmbë ta zbatojë administrata e Universitetit të Prishtinës, duke ua kufizuar të drejtën Bachelorëve për vazhdim të studimeve, duke i kushtëzuar me sukses etj... nuk ka bazë ligjore dhe paraqet shkeljen e të drejtës

së individit që ka kryer studimet Bachelor dhe është i dëmshëm si për individin ashtu edhe për shoqërinë, sepse le të pakualifikuar një pjesë të madhe të rinisë tonë.

Organet kompetente të arsimit universitar të Kosovës duhet ta korrigjojnë rregulloren në frymën e stimulimit të kuadrove të reja për studime të mëtejshme e jo të nxjerrin pengesa për të ua mohuar vazhdimin e shkollimit në kohën më të mirë. Nëpër fakultete ka interpretime që lidhen me problemin financiar dhe, si pasojë, kërkohet një numër i madh studentësh për të organizuar studimet master. Kjo kërkesë në shumë njësi akademike nuk mund të plotësohet, por edhe për këtë, me një angazhim e një analizë të studiuar mirë, mund të gjendet zgjidhja në të mirë të vazhdimin të studimeve master. Mund të organizohen studime në çdo të dytin vjet, apo edhe në çdo të tretin, por ama duhet rregulluar që të mos e pësojnë studentët e njësive të caktuara ku ka pak studentë, nëse duam që Universiteti të mos plakët.

Për ndryshe, pas disa vitesh një varg katedrash i pret dryni. Kjo nuk shkon në dobi të shtetit të Kosovës, prandaj duhet menduar dhe vepruar për ardhmërinë e Kosovës jo vetëm për rrethanat aktuale.

*Autori është profesor në Fakultetin e Filologjisë, dega e Orientalistikës*



# Esenca e artit islam (2)

**Arti islam ka një synim të ngjashëm me atë të Kur'anit – të mësojë dhe përforcojë tek njerëzimi perceptimin e transcencës hyjnore. Kur'ani i Shenjtë siguron një burim të gatshëm dhe logjik të inspirimit për krijim estetik. Artet islame, si rrjedhim, mund të emërohen me plot të drejtë “arte kur'anore”**

## Mimoza Sinani

### Stilizimi – instrumenti mohues i natyralizmit

**M**odelet e pafundme të artit islam janë, para së gjithash, abstrakte.

Madje edhe kur përdoren figura nga natyra, ato i nënshtrohen çnatyralizmit dhe teknikave të stilizimit, që i bën ato më të përshtatshme për rolin e tyre si mohuese të natyralizmit, sesa si pasqyrimë besnike të fenomeneve natyrore.

Nëpërmjet stilizimit, artisti musliman e largoi çdo objekt aq shumë nga natyra sa që ai u bë pothuaj i panjohshëm. Në dorën e artistit, stilizimi ishte një instrument mohues, me anën e të cilit ai i tha: Jo! çdo gjëje natyrore.

Artisti musliman nuk u ndal aty. Shpërthimi i tij kreativ erdhi kur atij iu bë e qartë se të shprehësh Zotin në një figurë të natyrës është një gjë, dhe të shprehësh pashprehshmërinë e Tij në një figurë të tillë është gjë tjetër.

Kjo shpjegon arsyen se përse pjesa më e madhe e veprave të artit të krijuara nga muslimanët ishin abstrakte. Madje edhe atje ku përdorëshin figurat e bimëve, kafshëve dhe njerëzve, artisti i stilizonte ato në një mënyrë si për të mohuar krijueshmërinë e tyre, si për të mohuar se ndonjë esencë mbinatyrore është rezidente brenda tyre.

E pafundmja është në çdo kuptim e pashprehshme.

Arti i muslimanëve shpesh është përcaktuar si art i modelit të pafundmë apo si “art i pafundësisë.” Kjo shprehje estetike, gjithashtu, është quajtur “arabeskë”, një dizajn jozhvillimor që shtrihet në të gjitha drejtimet ad infinitum. Arabeska e transfiguron objektin e natyrës që ajo dekoron – qoftë tekstil, metal, vazo, mur, tavan, shtyllë, dritare apo faqe e një libri – në një formë të papeshë, transparente, pluskuese që

shtrihet pambarimisht në të gjitha drejtimet. Nga ana estetike, objekti i natyrës bëhet nën përpunimin e arabeskës një dritare në pafundësi.

Arabeska krijon tek shikuesi intuitën e cilësisë së pafundësisë, të asaj që është përtej kohë-hapësirës. Nëpërmjet soditjes së këtyre modeleve të pafundme, mendja e marrësit kthehet drejt Hyjnores dhe arti bëhet një përforcim dhe një rikujtim i besimit fetar.

### Kaligrafia – arti i të shkruarit bukur

Synimi i artit për muslimanin është që t'i drejtojë qeniet njerëzore, si zëvendës të një Zoti transcendent, drejt përsiatjes dhe kujtimit të Tij. Në drejtim të këtij synimi nuk mund të gjendet asnjë element më i përshtatshëm sesa fragmentet poetikisht frymëzuese të Kur'anit të shenjtë.

Përfshirja e fragmenteve kur'anore nuk kryhej kurrë pa kujdes, pa nderim dhe pa perfeksionim. Si pasojë, arti i të shkruarit bukur, apo kaligrafia, u zhvillua ndërmjet muslimanëve të hershëm me imagjinatë dhe

shpejtësi të mahnitshme.

Pasazhet kur'anore janë përdorur si motive dekorative jo vetëm në elemente të rëndësishme nga pikëpamja fetare, por gjithashtu në pëlhura, veshje, enë dhe tabaka, kuti dhe orëndi, mure dhe ndërtesa, madje poçe gatimi, në çdo shekull të historisë islame dhe në çdo skaj të botës muslimane.


Eleganca në të shkruar dhe zbulurimi që gjendet në kopjet e Kur'anit, që u shkruan në shekujt në vijim, është i pakapërcyeshëm. Çdo sundimtar, çdo dinasti, çdo patron i pasur konkurronte për autorizimin apo shkrimin e Kur'anit më të bukur të kohës. Kaligrafistët ishin një shtresë e çmuar për çdo oborr mbretëror dhe çdo person i ditur përpiqej të arrinte mjeshtërinë më të madhe të mundshme të artit. Interesimi për kaligrafinë u përhap nga zbatimi i saj tek Kur'ani në përdorimin për zbulurimin e objekteve të bëra prej metali, xhami, fildishi, tekstili, druri, guri, stukoje dhe qeramike.

Çdo material dhe objekt i mundshëm u zbulurua me shirita, medaljone, motive, apo dizajno të bazuara në përgjithësi në artin e të shkruarit.

Secili prej shkrimeve të ndryshme këndore dhe shkrimeve të rrumbullakuara dëshmoi një stil të veçantë dhe një emër të dalluar (Thuluth, Neski, Muhakkek, Rika'i, Rejhani, Tevki, etj.).

### Funksioni i ornamentimit në krijimin estetik islamik

Fatkeqësisht, shumë studiues perëndimorë i kanë keqkuptuar disa prej premisave më thelbësore të ornamentimit në krijimin estetik islamik. Meqë ornamentimi është për ta vetëm një shtesë sipërfaqësore në një entitet estetik, shumëfishimin e ornamentit në artin islam ata e kanë gjykuar të jetë ose tregues i hedonizmit të popujve muslimanë, ose një horror vacui kulturor (një urrejtje për hapësirën e zbrazët). Duke mos kuptuar funksionin unik dhe rëndësinë e ornamentimit në krijimin estetik



islamik, ata nuk i kanë vlerësuar kontributet pozitive të këtij aspekti të veprave të artit të muslimanëve dhe i kanë ngarkuar atij vetëm një rol negativ dhe denigrues.


Në artin islam, ornamentimi nuk është vetëm diçka që i shtohet sipërfaqësisht veprës së përfunduar të artit me qëllim që ta zbukurojë atë në një mënyrë joesenciale. Ai nuk është, gjithashtu, një mjet për kënaqjen e oreksit të një populli që kërkon kënaqësi. Ai nuk duhet të vlerësohet si një mbushje e thjeshtë e hapësirës për të shmangur vbrazëtinë. Në vend të kësaj, dizajnet e bukur dhe të ndërlikuar që njeriu gjen në objektet e artit në çdo rajon dhe në çdo shekull të historisë islame, përmbushin disa funksione të rëndësishme. Modelet e bukurisë, të gjetura në artet islame, janë konkretizime të përpjekjes estetike të kudogjendshme të popujve muslimanë, për të krijuar prodhime artistike që e çojnë shikuesin drejt intuitës së transcendencës hyjnore. Ornamentimi i veprave të artit është rezultati dhe vetë substanca e kësaj përpjekjeje.

Ornamentimi është një mbrojtje nga bigëzimi i jetës në një sferë religjioze, në të cilën tevhibi ka fuqi dhe influencë, dhe në një sferë shekullare, në të cilën ideologjia ka pak apo aspak relevancë. Pra, ornamentimi nuk është një komponent joesencial që i shtohet sipërfaqësisht një veprë arti pas përfundimit të saj, por është thelbi i ngritjes spiritualizuese të krijimit artistik islamik.

Një prej llojeve të ornamentimit islam, emërohet si arabeskë “e zgjeruar” mbasi ajo jep përshtypjen e dizajni shpërthyes. Bërthama e saj qendrore modulare siguron një “pamje” brenda modelimit të pafundmë, por në asnjë mënyrë vetëm një. Bordurë pas bordurë dhe figurë pas figure i shtohen në mënyrë të njëpasnjëshme kësaj bërthame qendrore, qoftë nga artistit gjatë krijimit, qoftë nga shikuesi gjatë perceptimit. Çdo shtim furnizon një përbërje të re dhe një vizion të ri të arabeskës. Së fundi, bordura e faqes, skajet e pjatancës, ekstremitetet e panelit të murit, fasada e ndërtesës mbërrihen, dhe modeli duhet të ndërpritet, pa kompletim apo finalizim. Kjo papërfundueshmëri nuk është për t'u fshehur apo shmangur; në fakt, është prej esencës së modelit islam që, nëpërmjet kësaj papërfundueshmërie, dizajni të kërkojë vazhdim përtej kufijve të tij empirikë me anën e imagjinatës së shikuesit. Mendja, më së fundi, është e paaftë për ta vazhduar këtë proces dhe perceptuesi arrin të kuptojë se ekziston një Realitet i pashpjegueshëm, i cili është përtej kohë-hapësirës. (fund)



## Vitrina e librit



## Arben Atashi: RES PUBLIKA (Proza e Musa Ramadanit)

Këto ditë ka dalë nga shtypi libri kritik RES PUBLIKA (Proza e Musa Ramadanit), i studiuesit Arben Atashi. Në këtë libër, objekt studimi janë veprat në prozë të Musa Ramadanit të botuara deri më tash, përkatësisht poetika e tyre, që përfshin hetimin e esencave të prozës, mënyrën e strukturimit të saj, si dhe vendin që zë ky krijues në hierarkinë e vlerave të letërsisë shqipe.

Libri është i ndarë në gjashtë kapituj: Biografia e autorit, Raportet në letërsinë e kohës, Kodet e prozës së Musa Ramadanit, Modelet e prozës, Vlerësimet e bashkëkohësve, si dhe Përmbyllja. Veprat e shqyrtuara të Musa Ramadanit janë: Romani pa Kornizë, Fluroma, Zezona, Ligatina, Satana ma vodhi gurin e urtisë, Vrapuesja e Prizrenit, Antiprocioni, dhe Inamor: 55.

Musa Ramadani është njëri ndër krijuesit e mirëfilltë të Letërsisë Bashkëkohore, krijimtaria e të cilit bart vulën e kaheve të zhvillimit të letërsisë shqipe në Kosovë.

Studiuesi Atashi është përpjekur t'i hetojë kodet dhe modelet e prozës së Ramadanit, ka shqyrtuar biografinë e autorit, të nxjerrë nga struktura e veprave të tij letrare, si dhe ka shqyrtuar raportet në letërsi, në kohën kur ky autor boton veprat e para. Po ashtu, nuk janë lënë anash as studimet dhe leximet e ndryshme që i janë bërë veprës së këtij krijuesi.

Mes të tjerash, autori vëren se proza e botuar e Musa Ramadanit, duke përfshirë një periudhë të gjatë kohore të krijimtarisë - rreth 30 vjet, ka shënuar ndryshime dhe kthesa të theksuara pothuajse në të gjitha rrafshet, si në rrafshin stilistik, ashtu edhe në rrafshin tematik, ideor etj.

Përveç të tjerash, Atashi ka shqyrtuar edhe pikëpamjet e studiuesve dhe lexuesve të tjerë të prozës së Musa Ramadanit, si Ibrahim Rugovës, Sabri Hamitit, Mensur Raifit, Sali Bashotës, Ali Aliut, Agim Vincës, Ramadan Musliut, Adem Gashit, Mehmet Krajës, Eqrem Bashës etj.

“Res publika” është botuar nga Ndërmarrja Botuese “Gjon Buzuku” dhe ka rreth 200 faqe. (F.M)

Këndvështrim mbi poezinë

# Neutraliteti i poezisë

**Bota e poezisë duhet kuptuar përmes integralitetit të përhershëm dhe të fuqishëm që ajo përmban në jetën e njeriut, në universalitetin e përhershëm**



**Flamur MALOKU**

Dihet se poezia është diskurs i një subjektiviteti të përhershëm autentik. Kjo autentike, që artikullohet nga ndjeshmëria e thellë, përplot emocione-figura e me kontekste të ndryshme shpirtërore, njeh para së gjithash kohën zero të diskursit. Derisa njeh zeron e shkrimit, diskursi i poezisë bëhet jetësor-universal. Kjo është edhe arsyeja pse poezia pranohet si pjesë shpirtërore-individuele në përgjithësi. Andaj, fenomeni universal-metafizik i saj, universale e cila realizohet padyshim përmes një kategorialiteti estetik në kohë dhe hapësirë, e bën poezinë përherë e më shumë që të jetë më pranë lexuesit. Kjo ka bërë që lexuesi ta njohë dhe ta gjejë veten në diskursivitetin e saj. Duke e njohur veten dhe botën e tij, ai edhe identifikohet-mishërohet më të. Duhet mos harruar se njoha e vetvetes në poezi, nga ana e lexuesit, ka ardhur si shkak i një bote të tërë, botë e cila zbulohet ngadalë gjatë leximit-interpretimit të diskursivitetit të saj. Andaj, bota e poezisë duhet kuptuar përmes integralitetit të përhershëm dhe të fuqishëm që përmban ajo në jetën e njeriut, në universalitetin e përhershëm, mbi botëkuptimin/jetën/shpresën/vdekjen e tij. Nga kjo që u shënjuar, del se poezia është e lidhur ngushtë me ndjenjën, me botën e njeriut në përgjithësi, duke qenë edhe misionare në kuptimin njerëzor-individual, por çdoherë në përhershmerinë neutrale-tekstore. Kjo ka bërë që diskursiviteti i saj të jetojë, dhe do të vazhdojë të jetojë aq sa të ekzistojë kjo botë.

## Neutralja si koncept dhe dëshmi

Universalja në shkrimin e Naim Frashërit artikullohet fuqishëm. Shenjat personale marrin gjuhën e figurshme-universale, pra personalja theksohet, ndërsa universalja skicohet përballë mi-



sionit jetësor. Neutralja si koncept dhe si dëshmi e subjektivitetit lirik arrin të formësohet në paraqitje, duke shprehur një botë të brendshme, e cila shqiptohet kuptimisht në figurshmërinë universale. Andaj, mbi këtë figurë formulohen qëndrime, pikëpamje karshi identifikimit. Pra, shenjat personale kalojnë në kuptimin e asaj që jeta (subjekti) ka qenë njësh me ta, siç është poezia "Fjalët e qiririt". Gjendja subjektive e shoqëruar me urtësinë/filozofinë/humanitetin, e bën Naimin të artikulojë dhe të definojë shumë gjëra të prekshme jetësore, me një ligjërim, sa emocional, po aq edhe universal mbi atë, se çfarë është identifikimi dhe cilat janë arsyet e këtij përjetimi në shpirtin e subjektivitetit, çdoherë në përhershmerinë neutrale. Ky është Naimi në shkrimin personal-universal. Ndërsa Gj. Fishta shkruan poezinë Nji lule vjeshtet, krejtësisht personale, madje më përfaqësuese në kuptimin e subjektivitetit përballë medimit të vdekjes personale. Vetë vdekja është temë universale. Poeti mendon për vdekjen e tij. Duke menduar për vdekjen tema bëhet universale. Këtu personalja

është në metafizikën e përhershme si gjakim shpirtëror-individual. Kurse në poezinë e Lasgushi Poradecit personalja theksohet dukshëm në të gjitha nivelet e shkrimit. Personalja njeh vetminë karshi poezisë. Mirëpo, ky identifikim vjen e zmadhohet, duke krijuar edhe dhembjen-vetminë që në gjuhën e figurës universalizohet së bashku me metaforën. Metafora bëhet strukturë, pozicionim në ligjërimin e Lasgushit, duke qenë kështu para së gjithash edhe një pranim i arsyes lasgushiane. Migjeni shkruan poezinë me temë sociale e personale në kohë. Socialja bëhet dëshpërim-rebelim në diskursivitetin e përhershëm. Ndërsa personalja figurohet e universalizohet. Universalizimi shihet nga idetë-figurat që Migjeni i kërkon vazhdimisht për hapje të përgjithshme ideore. Vetë kërkimi për shtrirje-hapje-thyerje, e bën diskursin e Migjenit figurë neutrale, edhe atëherë kur tema është sociale e personale. Ndërsa Fan Noli shkruan poezinë okasionale, duke zgjedhur tema e figura të mëdha. Zgjedhja e temave dhe e figurave bëhet për të universalizuar personalen.

## E përtejshmja në botën e letrave

Ali Podrimja dhembjen personale të Lumit (djalit) e universalizon, çdoherë në gjuhën e figurës, për t'u bërë edhe pikënisje e temave të tjera, të shtrira në diskursin e tekstit. Shtrirja e temave argumentohet. Argumentimi i lë vend dëshmisë së figuruar-diskursive. Ndërsa poezia e Milazim Krasniqit, në filozofinë e kërkimit, shprehet përmes figurshmërisë. Bota e brendshme subjektive çdoherë kërkon dritën shpirtërore-universale. Poezia e M. Krasniqit ka një strukturë shumështrësore, me shenja autobiografike. Shenjat autobiografike bëhen temë në strukturën e tekstit, duke rinjohur dritën shpirtërore. Parashenjat për përcaktimin e kategorisë, të cilat dalin më shumë si kërkim, gjithmonë mbi parimet e një sistemi moral, artikuloohen në relacion me jetën e autorit. Jeta autoriale, herë nëpërmjet diskursit semiotik, e kodit figurativ, prek situatat të cilat tani ristrukturohen përmes diskursit meditativ universal. Duhet ditur se leximi i shenjave të tekstit bëhet për të definuar njëkohësisht edhe statusin kategorial të vet tekstit, ndërtimin dhe kodin tematik-universal. Mirëpo, duke pasur parasysh se situatat e jashtme reflektohen dhe krijojnë sistemin universal, kalojnë në ide, çka edhe e definojnë tekstin sipas statusit të shkrimit. Kësisoj, plotësohet bota-jeta e subjektit, karshi universale duke theksuar fuqishëm në shtresën tekstore përjetimin e kohërave të dikurshme. Kështu, në universalen e përhershme shkruhet edhe poezia e Musa Ramadanit, varësisht reale. Kërkohet një jetë, përtej kornizave të kësaj bote. E përtejshmja, tani në botën e letrave, shtrihet-kërkohet, sepse vetë shpirti do të jetojë në hapësirën e përgjithshme. Të jetosh në kohën reale dhe të kërkosh hapësirën e pakufishme të të jetuarit, nënkupton të mos vdesësh kurrë në botën e shkrimit-letërsisë. Prandaj, poezia e Musa Ramadanit në diskursin e saj, do të shprehë autentiken e përhershme në hapësirë, që koha dhe hapësira thyhen në diskursin e përgjithshëm-universal. Simbolika-figura e shkrimit të poezia e Ibrahim Kadriut shkon tutje, duke prekur momente të ndryshme, gjithnjë duke ikur nga tragjikja personale dhe fati i mëtutjeshëm i subjektit. Mundësia e ikjes subjektive gjatë komentimit-ndërtimit universalizohet. Ndërsa poezia e Basri Çapriqit shkrin brenda vetes idenë e njohjes dhe të rinjohjes subjektive, duke mos lënë anash gjykimin e botës së njeriut, çështje kjo që bëhet brengë edhe e vetë autorit, në universalitetin e përhershëm. Kjo është bota e poezisë, sa personale, aq edhe universale.

## Qasje

# Vetë elita prodhon mall të lirë për shitje

Naile Demiri

**P**ër kulturën janë dhënë me dhjetëra definicione. Shkrimtari gjerman Herderi e ka definuar kulturën si "natyra e dytë" e njeriut, çka do të thotë se me konceptin kulturë përfshihet e tërë ajo që ka krijuar njeriu për vete, duke përfshirë anën materiale, shpirtërore dhe shoqërore të tij. Kurse etimologjia e fjalës Kulturë rrjedhë nga latinishtja "cultus" ose kultura që në shqipe do të thotë kultivim, përpunim i tokës. Cultus do të thotë edhe përpunim, fisnikërim i shpirtit, pastrim i shpirtit nga egoja e pavetëdijshme dhe pasurim i shpirtit me unin e vetëdijshëm.

## Një mall që u drejtohej shqisave

Kultura masive në Kosovë ka filluar të paraqitet paksa më dukshëm menjëherë pas luftës të vitit 1999. Që nga viti 1989 një pjesë e popullatës rurale u shpërngul, për t'u vendosur pastaj në qendra urbane e gjysmë urbane. Popullsia e shpërngulur nga trojet e tyre nga ushtria e policia serbe, gjatë viteve 1989-1999, përjetoi një fat të keq dhe si e tillë u shndërrua në grup nomad. Duke bredhur nga një vend në tjetrin, ajo u gjend në civilizime të ndryshme, bile edhe në nënkultura. Në një pamundësi për të përvetësuar një tërësi komplekse kulturore, ajo humbi edhe ato pak vlera autentike që kishte trashëguar nga tradita (pozitive) që kishte. Popullsia e shpërngulur nga fshatrat dhe qytete gjysme urbane të Kosovës ishte vetëm formalisht në vendbanime të përkohshme në vende të ndryshme. Kjo popullsi e shpërngulur, që kishte statusin e refugjatit e të mysafirit, bënte përpjekje për ta ruajtur kulturën e saj tradicionale. Me përfundimin e luftës dhe kthimin e tyre në Kosovë, shumica e tyre i lanë fshatrat dhe u vendosën në qendra gjysme urbane, që nuk dallonin shumë prej vendbanimeve të tyre rurale. Kjo popullatë,

që u vendos në qendra gjysmë urbane, ishte kryesisht me një shkollim të ulët dhe vazhdoi t'i kultivonte vetëm ato vlera që ishin të kapshme për të. Të kuptuarit, përshtatshmëria, dëfrimi, argëtimi, shpenzimi i kohës së lirë, etj, ishin disa nga karakteristikat kryesore të kulturës masive që e përshkonin këtë popullatë, popullatë kjo që ishte në skaj të varfërisë, çka bënte që vetëm malli i lirë dhe argëtues të bëhej i kërkuar për të. Një mall që u drejtohej shqisave, përjetimeve. Ngaqë koha e lirë është standarde, tërhiqte shumë çka pas vete. Këtë mall argëtues si duket e subvencionoi edhe "elita" e kulturës shqiptare. Me qëllim, apo pa dashje, ky mall është prezent edhe sot e kësaj dite në tregjet shqiptare, si pronë e komercialistëve perfid dhe suitës së tyre. Përgjithësisht, sot, krijimet paraqesin surrogatet më tipike të falsifikimit në kulturën shqiptare.

## Logjika zero

Në vend që të kemi një kulturë të mirëfilltë, ne vazhdimisht paraqesim antiteza, përherë nga logjika zero. Në vend që të merren masa të kultivohen filma, teatro, gazeta, tribuna, panaire librash etj. me përmbajtje fisnikëruese dhe për kultivimin e njerëzores, që shpien në mundësinë e të jetuarit e jetës, në tokat shqiptare organizohen promovime të njerëzve, e jo të veprave. Organizohen përkujtime për njerëz që nuk kanë vend në histori, organizohen përvjetorë të diktatorëve. Sot kultura masive, me gjitha karakteristikat e saj, manifestohet me një intensitet të shtuar, ndërsa elita e kulturës udhëhiqet nga bipolariteti i politikës ditore dhe bën sehir. Vetë elita prodhon mall të lirë për shitje. Kjo praktikë kulturore, si duket, është falsifikim esencial i njerëzores. Edhe kjo që shënova është një lloj kulture, por qëllimi është të sensibilizohet elita kulturore e shqiptarëve që të ndërmarrin të gjitha masat drejt një zhvillimi të përgjithshëm shoqëror.

Poezi

# Shigjetat e zjarrta t'i kthej në kah



## Vlora Bytyçi

### **I njoh ata sy**

Ta njoha shikimin  
Më kot largove dritën e tyre  
Lëmshë shikimi kërkoj unë  
Pashë dritën,  
shkëlqimin,  
gjuhën e tyre e njoha  
I pashë,  
e ju fola  
syve të tu.

### **Më lë**

Nëse do të shkosh diku,  
Të paktën më lë kujtimin e syve tu,  
më lë ngrohtësinë e ledhatimeve  
Nëse do të shkosh,  
m'i lë të gjitha  
Shko vetëm me fjalë.

### **Ndjesi e matur**

Peshores së ndjesisë  
nuk i vë faj  
Gërshetat iluzioniste më shprishën  
Do të qaj të ardhmen,  
thua të të dua dhe mos ta pohoj  
Vështirë llogaritjet po mundem t'i  
bëj,  
S'di në ç'krahë do më vijë dielli,  
lutjet ditët po m'i begatojnë.

### **Atë natë me shi**

Rruga më s'lëvizte  
Buzëqeshja jote ishte zbratur,  
portat e shpresës ishin mbyllur  
me drynin mijëvjeçar  
Flatrat e pëllumbit të lagura me lot  
Veç mbyllim sytë e ëndërrojmë  
trishtimin e asaj nate me shi.

### **Kam harruar**

Diçka në shpirt më rëndon,  
një barrë e madhe më mbërthen  
Uli kokën dhe vështroj poshtë,  
eshtrat e reve të thyera për tokë  
E unë s'kuptoj ç'po ndodh!  
Jam tretur diku në thellësi,  
e s'po mundem të flas gjë,  
se janë shqyer perdet e gjakut,  
e dhimbjes sime s'i mjaftojnë plagët  
Harrova dhimbjes t'i mbyll dritaret,  
shigjetat e zjarrta t'i kthej në kah  
tjetër,  
sytë t'i mbyll me dry të vjetër,  
t'i shtoj pëllumbit bukurinë,  
peshqve të gjakut t'ua shtoj brigjet  
Kam harruar se numri im s'më sjell  
fat,  
shkronjat e emrit tim ikin me shpe-  
jtësi  
E bukuria juaj hidhet larg,  
janë thyer flatrat për t'i zënë zogjtë,  
e unë e mjera, kam harruar  
në zemër jam gjallë apo e tretur.

### **Ndjenjës vetmitare**

Loti i kristaltë,  
nuk dëshiron të njohë kohë  
Koekzistencë motesh sikur s'dalin  
fitimtare  
Hyjnë në pore, imitojnë ndjesitë e  
mia  
Kapërcejnë limitet tona,  
për të jetësuar heshtjen  
Nuk kam aftësi për të parashikuar  
motet  
Ndiej dozë dhembje dhe mall,  
dhe risitë më dalin krahëhapur.

Ndahen shpërblimet e Akademisë Evropiane të Filmit

## “Gomorra” rrëmben çmimet kryesore

Drama për mafian italiane u kthye në atdhe me pesë çmime, përfshirë këtu edhe shpërblimin për filmin më të mirë, regjisorin më të mirë dhe aktorin më të mirë. Ndërkaq, çmimin për aktoren më të mirë, kategori kjo ku ishte nominuar edhe aktorja nga Kosova, Arta Dobroschi, e rrëmbeu aktorja britanike Kristin Scott Thomas



Genta Hoxha

**N**i ë mijë e tetëqind anëtarët e Akademisë Evropiane të Filmit, e shpërblyen me 5 çmime filmin italian “Gomorra”, në ceremoninë e 21-të të ndarjes së këtyre shpërblimeve, që u mbajt të shtunën mbrëma, në Kopenhagë të Danimarkës. Drama, që flet për mafian italiane, mori ndër të tjerë tre çmimet më kryesore, atë për filmin më të mirë, regjisorin më të mirë dhe aktorin më të mirë. Filmi “Gomorra”, i bazuar në librin e Roberto Saviano-s, i cili ka jetuar në mbrojtje të policisë për dy vite nga kërcënimet e shumta për vdekje që ka marrë nga gangsterët, flet për krimin e organizuar në Napoli të Italisë. Ky film, po ashtu, ka fituar shpërblimin “Grand Prix”, në Cannes, këtë vit.



Ndërkaq, aktorja kosovare Arta Dobroschi, humbi në kategorinë e aktoreve më të mirë. Këtë çmim e fitoi aktorja britanike Kristin Scott Thomas për rolin e saj në filmin “I’ve Loved You So Long”.

Aktorja kosovare ishte nominuar për interpretimin e saj në filmin “Heshtja e Lorna’s”, të vëllezërve belgë Jean-Pierre dhe Luc Dardenne, film ky fitues i shpërblimit për skenarin më të mirë në Cannes, ku edhe është dhënë premiera. Ndërkaq, kohëve të fundit, ka fituar edhe shpërblimin “Lux” për filmin më të mirë evropian, shpërblim i ndarë nga Parlamenti Evropian. Shpërblimin për aktorin më të mirë, Akademia Evropiane e Filmit ia dha aktorit italian Toni Servillo, për rolet në filmat “Gomorra” dhe në filmin “Il Divo”, në të cilin luan rolin e ish kryeministrit italian, Giulio Andreotti. Ndërkaq, çmimin për regjisorin më të mirë e mori regjisorin i filmit “Gomorra”, Matteo Garrone.

Shpërblimi i nderit iu nda aktoreve britanike Judi Dench dhe themeluesve të lëvizjes filmike “Dogma”, artistëve nga Danimarka Soren Kragh-Jacobsen, Kristian Levring, Lars von Trier dhe Thomas Vinterberg. Shpër-

blimin e kostumeve e mori Magdalena Biedrzycka për kostumet në filmin “Katyn”, ndërsa kompozitori më i mirë u zgjodh Max Richer për muzikën e filmit “Waltz With Bashir”. Filmi “Hunger” i regjisorit Steve McQueen është shpërblyer si filmi më i mirë i punuar nga artistë të rinj, ndërkaq “Harry Potter And The Order Of The Phoenix” është zgjedhur filmi më i mirë nga publiku.

Akademia Evropiane e filmit ka prezantuar 15 kategori, në mesin e të cilave edhe për aktorin më të mirë evropian, filmin më të mirë evropian dhe regjisorin më të mirë evropian. Gjatë kësaj ceremonie shpërblehen filmat më të arritshëm të kinematografisë evropiane. Që nga viti 1988, kur është themeluar ky shpërblim, çdo të dytin vit ceremonia mbahet në Berlin, ndërsa përveç këtij qyteti është mbajtur edhe në Londër, Paris, Romë dhe Barcelonë. Akademia Evropiane e Filmit është themeluar në vitin 1989 për të promovuar filmat evropianë, me president të parë regjisorin suedez Ingmar Bergman. Edhe pse vlerësohen lart nga industria e filmit, këto shpërblime ende nuk e kanë prestigjin që e kanë festivalet në Cannes, Venecia dhe në Berlin.

Vitin e ardhshëm këto shpërblime do të ndahen në Essen të Gjermanisë.

# PREJARDHIJA E ALFABETIT LATIN

“Ndonëse ne e quajmë Alfabeti Latin, kurse alfabeti e ka emrin grek, ndërsa alfabeti ka një prejardhje tjetër, shumë më të vjetër.” - Allen Butler

Mexhid YVEJSI

**P**ër nder të “Kongresit të Manastirit”, me rastin e 100 vjetorit (1908-2008), ku u vendos, u përcaktua, Alfabeti Latin për gjuhën shqipe, u organizuan manifestime, kremtime, tryeza, tribuna, konferenca shkencore, turlifare, në të gjitha trojet shqiptare...

Organizimet më të veçanta ishin në Tiranë, Shkup dhe Prishtinë, ku shumë, referues, disa politikuaq të lartë, thanë se: “Shqiptarët u përcaktuan për Alfabetin Latin sepse ky alfabet është evropian...”

Për Alfabetin Latin ata thanë gjithçka... Gjithçka është asgjë...! Asgjëja sështë e vërtetë – për këtë alfabet...Pse? Sepse: ALFABETI LATIN – EURO - PERËNDIMOR, ËSHTË ALFABET AZIATIK – LINDOR...!

## Prejardhja e fjalës alfabet

Fjala ‘alfabet’ rrjedh nga greqishtja. Ajo vjen nga dy shkronjat e para të alfabetit të tyre, të cilat janë: Alfa dhe Beta. Pra, nga dy shkronjat e para të alfabetit të gjuhës greke është formuar fjala alfabet...

Por, me gjithë këtë, fjala alfabet nuk është fjalë burimore greke. Pse? Sepse dy shkronjat e para të alfabetit grek, Alfa dhe Beta, janë dy shkronjat e para të Alfabetit Fenikas, të përvetësuar nga Alfabeti i Semitëve të Egjiptit të lashtë, që përdoret edhe sot në gjuhët e popujve semitë, siç janë: arabishtja, hebraishtja dhe aramishtja, të cilat i ka përvetësuar greqishtja...

Në gjuhën arabe shkronja e parë quhet: Elif, kurse në gjuhën hebreje: Alef, shkronja e dytë quhet: Be, në arabisht, kurse Beth në hebraisht, kështu shkruhen edhe në aramisht, gjuha amtare e Jezu Krishtit ose e Hazreti Isait, paqja e Zotit qoftë mbi te...

## Prejardhja e alfabetit latin

Alfabeti Latin ka prejardhje greke. Ai është përvetësuar nga alfabeti grek në shekullit e shtatë para Krishtit, (Hazreti Isait, a.s.), nga vendbanimi Cumae, një koloni greke, në Italinë Jugore.

Etruskët ishin ata që e përvetësuan alfabetin grek, të cilin e plotësuan me disa shkronja. Prej tyre e përvetësuan latinët, të cilët e adaptuan si alfabet të vetin me 21 shkronja

dhe e quajtën alfabeti latin...

Pra, alfabeti latin vjen prej etruskëve, të cilët e përvetësuan nga grekët, por që e adaptuan latinët dhe e përhapën tek romakët...

Romakët krijuan Perandori. Perandori me afër 1000 vjet histori, e cila në kulmin e fuqisë shtrihej nga Spanja në Mesopotami, nga Afrika në Angli. Me shtrirjen dhe zgjerimin e Perandorisë Romake u përhap edhe alfabeti latin dhe gjuha latine, e cila ishte gjuhë zyrtare e Perandorisë...

## Prejardhja e Alfabetit Grek

Alfabeti Grek, me të cilin shkruhet gjuha greke, është përvetësuar nga alfabeti i fenikasve, para 2800 vjetëve...

Në fillim, në shekujt e parë, alfabeti grek shkruhej nga e djathta në të majtë, siç shkruhen edhe sot e kësaj dite në gjuhët semitike: siç janë hebraishtja, aramishtja dhe arabishtja, gjuhë në të cilat janë shpallur Librat Hyjnor, Bibla dhe Kur’ani...

Me kalimin e kohës, alfabeti grek pësoi ndryshime dhe u bë si një “nënë në vetë”. Prej kësaj “nënë në vetë” lindin këto alfabet: alfabeti latin, glagolik, gotik, cirilik, koptik...

## Alfabeti Fenikas

Të gjitha alfabetet e lartpërmendura rrjedhin nga alfabeti fenikas. Kurse, vetë alfabeti fenikas rrodhi, u formua dhe u zhvillua nga alfabeti proto-kaanaitë, rreth 3500 vite më parë...

Në fillim, fenikasit shkruanin me sistemin kuneiform... Kuneiform është një shprehje latine që do të thotë “Pykë”. Ky ishte shkrimi i parë, me anën e pykës, që e shpikën sumerët në Mesopotami...

Alfabeti fenikas kishte 21 shkronja, në forma të ndryshme. Të gjitha shkronjat e alfabetit fenikas ishin bashkëtingëllore, të cilat ishin përvetësuar nga hieroglifët e semitëve të Egjiptit të Lashtë...

Gjuha e fenikasve ishte gjuhë semite, e cila ishte përhapur për rreth Mesdheut, që nga Libani, Siria, Palestina, Izraeli, Tunizia, deri në Maltë...Kjo gjuhë, prej së cilës rrjedhin alfabetet e përmendura, flitej deri në shekullin e parë...

*Egjipti dhe Sumeria –  
Dy djepet të civilizimit,  
Ku lindi historia e shkrimit...*

Egjipti i Lashtë është një nga dy djepet e civilizimit ku lindi Historia e Shkrimit...

Historia e Shkrimit fillon në Egjiptin e Lashtë, para 4700 vjetësh...Semitët, banorët e atëhershëm në Egjipt, ishin ata që e shpikën shkrimin. Shkrimi i tyre, prej të cilit rrjedhin të gjitha alfabetet e lartpërmendura, nuk kishte shkronja të alfabetit, por hieroglifë...

Hieroglifët ishin shenja, të cilat përfaqësonin shkronjat, që ishin gjithsej 22, të gjitha bashkëtingëllore, që shkruheshin nga e djathta në të majtë...

*Sumeria ose Mesopotamia –  
Djepi ku lindi dituria...*

Sumeria është atdheu i sumerëve, një popull i lashtë që jetonte në Mesopotami, ndërmjet dy lumenjve, Tigër dhe Euftrat, në mes të Irakut të sotëm, në Lindjen e Mesme...

Sumerët janë ata që e shpikën formën e parë të shkrimit, që e nje historia e njerëzimit, para 5200 vjetësh.

Shkrimi i sumerëve nuk kishte shkronja, por shenja, të cilat i përfaqësonin shkronjat, që ishin 550 shenja...

Ky “alfabet” me 550 “shkronja” njihet si forma e parë e shkrimit në historinë e njerëzimit, në historinë e civilizimit...

Ky sistem i shkrimit në Perëndim njihet me termin “Kuneiform”, që vjen nga gjuha latine, që do të thotë: “Pykë”. Pyka ishte “pena” “lapsi”. Sot, në gjuhë, kompjuteri i bie tastiera, ku “shtypeshin” “shkronjat” në rrasa argjile ose balte të pjekur...

Nga ky lloj sistemi shkrimi, filloj “alfabeti” me 550 shkronja, i cili u përhap në tërë Lindjen e Mesme, duke u përdorur me mijëra vite, prej të cilit u formuan të gjitha alfabetet e lartpërmendura...

Përveç shpikjes së shkrimit, sumerët shpikën dhe zhvilluan edhe sistemin e numrave, shpikën kalendarin, ditët e javës, orën, të cilën e ndanë në 60 minuta, shpikën rrethin që e ndanë në 360 gradë dhe shumë shpikje të tjera, që për themel kanë shkrimin, i cili e çoi njerëzimin përpara...

Pra, si përfundim, siç e kanë thënë ditëtarët në Perëndim, Alfabeti Latin – Euro-Perëndimor është Alfabet Aziatik-Lindor...

*(Autori është studiues i religjioneve)*

# HIV/AIDS epidemia

Sipas OBSH-së, sot në botë ekzistojnë mbi 33.2 milion njerëz të prekur nga virusi HIV, prej të cilëve 15.4 milion janë femra, 17.8 milion janë meshkuj, ndërsa 2.5 milion janë fëmijë nën moshën 15 vjeçare. Në Kosovë, që nga viti 1986 e deri tani, janë të regjistruara vetëm 75 raste me HIV/AIDS, edhe pse dyshohet se numri i të infektuarve është më i madh



Artan N. BEJTA

Me virusin HIV, brenda ditës, infektohen mesatarisht 6800 persona, kurse nga ky virus vdesin 5700 persona.



**Sh**umë faktorë kanë bërë që numri i të infektuarve nga HIV/AIDS-in në Kosovë të rritet dhe Kosova ta futet në vendet me rrezikshmëri të lartë për këtë sëmundje. Migrimet e mëdha të popullsisë, numri i madh i shtëpive publike, numri gjithnjë e më i madh i injektuesve të drogave të ndryshme, si dhe numri i madh i ndërkombëtarëve që punojnë në Kosovë, të cilët vijnë nga vende me shkallë më të lartë të HIV/AIDS-it se sa Kosova – janë ndër faktorët kryesorë që e kanë futur Kosovën në grupin e vendeve me rrezikshmëri të lartë për përhapjen e kësaj sëmundjeje fatkeqe, edhe pse Kosova, momentalisht, bën pjesë në grupin e vendeve që kanë prevalencë të ulët të kësaj sëmundjeje.

Kësaj i kontribuon, gjithashtu, edhe fakti se numri më i madh i popullsisë është i moshës rinore dhe informata që ata kanë për këtë sëmundje (HIV/AIDS-in), gjithashtu, është e mangët. Kjo informatë e mangët arsyetohet me atë se tek ne ende nuk ekziston një edukim i mirëfilltë shëndetësor në shkollat fillore apo të mesme.

Afër 5% të rinjve në botë kanë marrëdhënie seksuale para moshës pesëmbëdhjetë vjeçare. Tek ne, informatat që ata kanë për përhapjen e kësaj sëmundjeje janë të mangëta.

Ky, pa dyshim, është faktori kryesor i përhapjes së kësaj sëmundjeje në vendin tonë, për shkak se rruga më e madhe e përhapjes së këtij virusi është ajo përmes kontaktit seksual.



Faktor tjetër me rrezikshmëri të lartë është, pa dyshim, rritja gjithnjë e më e madhe e dukurive negative në vendin tonë, siç është marrja e drogës përmes injeksioneve, e po ashtu edhe bërja e tatuazheve.

Këto dukuri, tanimë shumë të shprehura në Kosovën e pasluftës, padyshim rrezikojnë dhe mundësojnë që përhapja e virusit HIV të jetë më e madhe.

Sipas OBSH-së, sot në botë ekzistojnë mbi 33.2 milion njerëz të prekur nga virusi HIV, prej të cilëve 15.4 milion janë femra, 17.8 milion janë meshkuj, ndërsa 2.5 milion janë fëmijë nën moshën 15 vjeçare. Vetëm në vitin 2007, me këtë virus kanë qenë të infektuar 2.7 milion njerëz, prej këtyre 0.37 milion fëmijë, ndërsa nga kjo sëmundje kanë vdekur 2.0 milion njerëz, prej tyre 0.27 milion fëmijë.

**Vetëm në vitin 2007, me këtë virus kanë qenë të infektuar 2.7 milion njerëz, prej këtyre 0.37 milion fëmijë, ndërsa nga kjo sëmundje kanë vdekur 2.0 milion njerëz, prej tyre 0.27 milion fëmijë.**

**Çfarë është në të vërtetë HIV/AIDS-i?**

AIDS-i është një grup sëmundjesh që shkaktohet si rezultat i shkatërrimit të forcave

mbrojtëse të organizmit, si pasojë e infeksionit me virusin e quajtur HIV. Pra kur HIV-i është prezent në gjakun dhe lëngjet trupore (spermë, lëng vaginal, apo qumësht të nënës) atëherë personi është HIV+. Te personat HIV pozitivë, shenjat e infeksionit mund të mos shfaqen për më tepër se 10 vite, por në të njëjtën kohë, ai ose ajo mund t'i infektojë të tjerët pa qenë i/e vetëdijshme për këtë.

**Cilat janë simptomat tek personi HIV-pozitiv?**

Personi, pas HIV infeksionit, mbetet HIV pozitiv dhe si i tillë mbetet gjatë gjithë jetës. Sëmundja zakonisht ndahet në disa faza, por praktikisht nuk ka kufij të qartë midis fazave të sëmundjes.



# që po trondit botën

Tre deri në gjashtë javë pas infeksionit paraqitet faza e parë, e cila quhet faza akute e HIV infeksionit. Te shumica e këtyre personave, paraqitet temperaturë e ngritur dhe gjendje e ngjashme me gjendje gripoze.

Shenjat themelore të sëmundjes janë ethet, rritja e gjëndrave limfatike, dhembje fyti, ekzantemë, dhembje në muskuj dhe nyja.

Pas kësaj faze asimptomatike shfaqet faza me simptome që ndahet në simptomat e hershme, simptomat në fazën e përparuar dhe simptomat e vona. Në fazën e hershme, numri i limfociteve CD4, zvogëlohet në 100-500/mm<sup>3</sup> gjak. Rritja e nyjave limfatike zakonisht është e padhembshme.

Në fazën e përparuar, e cila ngjan tek 50 % të të sëmurëve, 10 vjet pas infektimit, paraqiten sëmundjet më të rënda, siç janë: Pneumonia ose pezmatimi i mushkërive me Pneumocistis carini ose diarre, si pasojë e Criptosporidium-it. Shfaqet toksoplazmoza e trurit, meningjiti kriptokoksik, ose format atipike të tuberkulozit. Në këtë fazë të sëmundjes janë të shpeshta anemia dhe simptomat

Sipas OBSH-së, sot në botë ekzistojnë mbi 33.2 milion njerëz të prekur nga virusi HIV, prej të cilëve 15.4 milion janë femra, 17.8 milion janë meshkuj, ndërsa 2.5 milion janë fëmijë nën moshën 15 vjeçare.

si: ethet, dobësimi, plogështia etj.

## Cilat janë rrugët e përhapjes së HIV-it?

Janë tri rrugë kryesore të përhapjes së infeksionit: përmes marrëdhënieve seksuale (heteroseksuale dhe homoseksuale) të pambrojtura, përmes gjakut dhe gjatë shtatzënisë nga nënat tek fëmijët dhe gjatë të ushqyerit me qumësht gjiri.

## Përhapja përmes marrëdhënieve seksuale

Tek ne rruga më e shpeshtë e përhapjes është ajo përmes marrëdhënieve seksuale, andaj do ta trajtojmë më shumë.

Virusi HIV gjendet në gjak, spermë, sekrecione vaginale dhe në qumështin e gjirit. Ky virus gjendet edhe në pështymë, urinë dhe lot, por si duket jo në sasi të mjaftueshme për të shkaktuar infektion, apo së paku nuk ka të dhëna deri më tani për bartje të infeksionit përmes këtyre lëngjeve.

Në shumicën e rasteve, virusi HIV kalon nga një person në tjetrin përmes marrëdhënieve seksuale (heteroseksuale dhe homoseksuale) të pambrojtura, gjatë të cilave sperma, lëngu vaginal ose gjaku i personit të infektuar hyn në trupin e personit tjetër.

Rreziku nga marrja e infeksionit HIV përmes marrëdhënieve seksuale mund të zvogëlohet nëse njerëzit nuk kanë marrëdhënie seksuale (abstenenca), nëse reduktojnë ose zvogëlojnë ndërrimin e partnerëve seksualë, nëse personat e pa infektuar kanë marrëdhënie seksuale vetëm më njeri-tjetrin.

## Përhapja përmes gjakut

Përdoruesit e drogave janë ata të cilët infektohen më së shpeshti përmes kësaj rruge, duke përdorur shiringat dhe gjilpërat e përbashkëta. Përdorimi i mjeteve që presin ose shpojnë lëkurën mundësojnë përhapjen e infeksionit HIV.

Mosha mesatare e kontaktit të parë seksual është mosha tetëmbëdhjetëvjeçare. 5 % e të rinjve kanë marrëdhënie seksuale para moshës pesëmbëdhjetëvjeçare.



















Mundësia e bartjes së infeksionit përmes transfuzionit të gjakut gati është eliminuar në vendet ku bëhet testimi paraprak i gjakut të personave që dhurojnë gjak. Gjithashtu, mundësia e bartjes së infeksionit përmes transplantimit të organeve është e vogël duke qenë se personat që dhurojnë organe testohen paraprakisht për virusin HIV.

## Me cilat rrugë nuk përhapet HIV-i?

Infeksioni me HIV nuk përhapet: me shtrëngim dore, me përqaftim dhe kontakte të tjera të zakonshme, përmes kabinave telefonike, parave, përmes dorëzave për t'u mbajtur në autobus apo tramvaj, përmes tualeteve publike, përmes pishinave, saunave, përmes enëve për ushqim, gotave, peshqirëve, çarçafëve, me anë të teshtitjes apo kollitjes, përmes kafshëve shtëpiake (qeni, macja) si dhe insekteve, nga bashkëjetesa, mësimi apo puna me personin i cili është i infektuar me HIV/AIDS, gjatë kujdesit të zakonshëm për të sëmurin me HIV/AIDS.



Autor: ENDRITI	POETI YNË NË FOTO	APROVUAR	ABONUES	PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.)		FUTBOLLISTI YNË CANA NATRIUM, KALIUM	SËMUNDJE E TOKES, EPILEPSI (shq.)	<b>PAQJA</b> 	"RIMINI"	ISH BOKSIERI YNË SALIHU	ENË E THELLË PREJ QELQI (sh.shq.)	ANITA (perkdh.)	MINDERI I ULËT (vjet.)
LUM I MADH NË AMERIKËN LATINE (shq.)								STUHI E FORTË ME ERË DHE SHI					
QË ËSHTË I LIRË NË MENDIME								OYTET I LASHTË NË ILIRI (shq.)					
QESËNDISËSE								BËRJE SI TJETRI SAHATI					
TMERR, LEMERI E ZË GJUMI DUKE NDENJUR						AKTORI I FAMSHËM HANKS NOTË MUZIKORE			ZAMBIA, ANGOLA JEVG			IPSVICH E PALËVIZSHME	
					ADMIR (perkdh.) YLL FILIMI (ang.)				BASHKËT- INGËLLORE XHAKATAR, VRASËS MIZOR	TREVISO, SIENA "NOHMASKS"			FJALË E RËNDË, E PAHLISHME (turq.)
"DUNST"				SILICI VEPËR E KRYER (shq.)			REPER I NJOHUR AMERIKAN					TEDI ALVARES ELEMENT KIMIK	
KËSTËT BANKARE PËR PAÇIMIN E KREDISË						AKTORJA ME FAME BOTËRORE ... REID	<b>PAQJA</b>	I PANDERSHËM E FRIKËSUAR					
INDIA, RUANDA			SHTRESË, FISH AKTORJA JONË ISLAMILI				ELIZABETH TAYLOR KAFSHË SHTËPIAKE (shq.)		KËNGËTARJA JONË ORINDA SHKRONJA e 31-të				
BASHKËT- INGËLLORE		ZBAVITËS, TERHEQËS TENISTJA KUNIKOVA								FUTBOLLISTI GJERMAN BOROWSKI AUTOTARGA E TETOVËS			
RILINDËSI YNË VRETO					FUTBOLLISTI GONZALEZ (Real Madrid) UJEVARE E MADHE NË AMERIKË						KUNDREJT ÇIFTE BASHKËT- INGËLLORE		
MIRË DE				LARTË PARIMI I PËRCAKTUAR MIRË					PARAJSË (mysl.) BRINJET QË FORMOJNË KENDIN E DREJTË TË TREKËNDËSHIT				
<b>PAQJA</b>						INDIANA UNIVERSITY KOKOMO AKTORJA E VJETËR HOLLIVUDIANE MORENO							
		BUJK MËRIA, ZILIA					RESHAT ARBANA RIFAT AVDIU						
VARIOLË			INSTITUTE GLOBALISAT. INTERNATIO. REGULATION EMËR YNI MASHKULLI						TROYES PILOTI I "FORMULA 1" RAIKONEN				
KËNGËTARE E VJETËR SHQIPTARE													
MJET XHIRIMI								IGLI TARE ISLANDA, DANIMARKA					
E THAVA						PËREMËR PRONOR ZANORE							
TITANI, REOMIRI, INTENSITËTI					ALBANOLO- GIA E SHQUAR DURHAM								

